



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

TË KUPTUARIT E DREJTË TË ISLAMIT

Mevdudi

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

KAPITULLI I	7
PSE ISLAMI QUHET KËSHTU?.....	7
DOMETHËNIA E FJALËS “ISLAM”	8
NATYRA E ISLAMIT	8
NATYRA E KUFRIT	11
BEGATITË E ISLAMIT	15
KAPITULI II	22
FEJA DHE NËNSHTRIMI	22
ÇKA DO TË THOTË FJALA “FE”?.....	25
SI TA ARRIJMË NJOHJEN E ZOTIT?.....	28
KAPITULLI III	31
PEJGAMBERLLËKU	31
PEJGAMBERLLËKU: NATYRA DHE OBLIGIMET E TIJ	32
HISTORIA E SHKURTËR E PEJGAMBERLLËKUT.....	39
PEJGAMBERLLËKU I MUHAMMEDIT (A.S.)	46
ARABIA - GREMINË E ERRËSIRËS	49
SHPËTIMTARI U LIND.....	51
GUR I ÇMUESHËM NË GRUMBULLIN E GURËVE.....	52
REVOLUCIONI AFROHET.....	54

PËRSE TËRË KJO ARMIQËSI?	56
NJERIU I NDRYSHUAR NË MOSHËN DYZETVJECARE TË JETËS. PËRSE?	57
MESAZHI I TIJ UNIVERSAL.....	59
KONTRIBUTI I TIJ PËR MENDIMIN NJERËZOR	62
REVOLUCIONARI MË I MADH	65
DËSHMITË PËRFUNDIMTARE.....	69
PËRFUNDIMI I PEJGAMBERLLËKUT.....	71
KAPITULLI IV	76
NENET E FESË.....	76
<i>TEVHIDI</i> - BESIMI NË NJË ZOT	78
DOMETHËNIA E KELIMESË.....	79
NDIKIMI I <i>TEVHIDIT</i> NË JETËN E NJERIUT.....	88
BESIMI NË MELEKËT E ZOTIT	93
BESIMI NË LIBRAT E ZOTIT XH.SH.....	95
BESIMI NË PEJGAMBERËT E ZOTIT XH.SH.....	100
BESIMI NË JETËN PAS VDEKJES	103
PËRSE ËSHTË I NEVOJSHËM KY BESIM?	104
JETA PAS VDEKJES: JUSTIFIKIM RACIONAL.....	109
KAPITULLI V	115

LUTJA DHE ADHURIMI.....	115
SHPIRTI I IBADETIT OSE ADHURIMIT.....	116
NAMAZI (SALATI)	118
AGJËRIMI	121
ZEKATI	123
HAXHXHI	124
MBROJTJA E ISLAMIT	126
XHIHADI	126
KAPITULLI VI.....	127
DINI DHE SHERIATI	127
DALLIMI NË MES <i>DINIT</i> DHE <i>SHERIATIT</i>	128
BURIMET E <i>SHERIATIT</i>	129
FIKHU	129
TESAVVUFI	131
KAPITULLI VII.....	132
PARIMET E SHERIATIT.....	132
<i>SHERIATI</i> : NATYRA DHE QËLLIMI I TIJ	132
<i>SHERIATI</i> : TË DREJTAT DHE OBLIGIMET	137
OBLIGIMET NDAJ ZOTIT XH.SH.....	138

TË DREJTAT PERSONALE	142
TË DREJTAT E TË TJERËVE.....	144
MARRËDHËNIET ME JOMUSLIMANËT	153
TË DREJTAT E TË GJITHA KRIJESAVE	154
<i>SHERIATI</i> : LIGJI UNIVERSAL DHE I PËRHERSHËM.....	156

KAPITULLI I

Domethënia e fjalës “Islam”; Natyra e Islamit; Natyra e kufrit; Dëmi prej kufrit; Përparësitë e Islamit

PSE ISLAMI QUHET KËSHTU?

Çdo religjion në këtë botë quhet sipas emrit të themeluesit të tij, apo popullit në të cilin është paraqitur. P.sh. Krishterimi është emërtuar sipas emrit të të dërguarit Krishtit; Budizmi sipas emrit të themeluesit të tij Budës; Zoroasterizmi, sipas Zaratustrës; Judaizmi, religjioni i hebrenjve, sipas emrit të fisit Juda (prej vendit Judeja), ku edhe është paraqitur. I ngjashëm është rasti edhe me religjionet tjera. Por krejt tjetër është rasti me Islamin, i cili ka diçka unikate, që nuk është i lidhur me asnjë person a vend të posaçëm. Fjala “Islam” nuk përmban marrëdhënie të këtij lloji sepse ai nuk i përket njeriut, popullit apo vendit të posaçëm. Ai nuk është prodhim i mendjes së njeriut, ai nuk kufizohet me ndonjë bashkësi të posaçme. Ai është religjion universal, i cili ka për qëllim të krijojë dhe të kultivojë cilësitë dhe qëndrimin islamik.

Në të vërtetë, Islami është atribut (cilësor). Çdonjëri, pa marrë parasysh i cilës racë, vendi apo bashkësi është, e që ka këtë atribut, është musliman. Sipas Kur'anit, në mes të gjithë popujve, në çdo kohë, ka pasur njerëz të mirë dhe të ndershëm, të cilët e kanë poseduar këtë atribut; ata janë muslimanë.

Kjo, natyrisht nxit pyetjen: ç' do të thotë fjala "Islam"? Kush është musliman?

DOMETHËNIA E FJALËS "ISLAM"

"Islam" është fjalë arabe që do të thotë përlulesi (nënshtrim), dëgjueshmëri. Si religion, Islami përfaqëson përlulesi (nënshtrim), dhe dëgjueshmëri të plotë ndaj All-llahut, pikërisht për këtë edhe quhet Islam.

NATYRA E ISLAMIT

Çdokush mund të dëshmojë se gjithësia jonë është gjithësi në të cilën ka rend, ku çdo gjë sillet sipas ligjeve dhe rregullave. Çdo gjë ka vendin e caktuar në tërësinë madhështore e cila funksionon shkëlqyeshëm. Dielli, Hëna, yjet, të gjithë trupat qiellorë i përkasin të njëjtit sistem dhe ndjekin kahun e përhershme sipas ligjeve të pandryshueshme. Toka rrotullohet rreth boshtit të vet si dhe rrotullohet e saj ndaj Diellit ndjekin shtegun e caktuar. Çdo gjë në gjithësi, prej

elektronit më të vogël e deri në mjegullirën më të madhe u nënshtrohet ligjeve sipas të cilave materia, energjia dhe jeta, paraqiten, ndërrohen ose zhduken. Saqë edhe në botën njerëzore, ligjet e natyrës janë plotësisht evidente. Lindja, rritja, jeta, ekzistenca e njeriut në natyrë, e gjithë kjo është e rregulluar në sistemin e ligjeve biologjike. Ato orientohen me funksionimin e organeve të tij prej qelizave më të imëta deri në zemrën dhe trurin. Shkurt, gjithësia jonë është gjithësi e nënshtuar një ligji dhe gjithë çka i përket asaj i përmbahet drejtimit, i cili i është përcaktuar.

Kjo vepër kozmike, e cila sundon me gjithësinë prej thërrmisë më të imët deri në galaktikë, është ligji i Zotit, Krijuesit dhe Sunduesit të gjithësisë. Meqë çdo gjë e krijuar i nënshtrohet ligjit të Zotit, mund të thuhet se e tërë gjithësia ndjek Fenë Islame pikë për pikë. Meqë Islami nuk do të thotë asgjë tjetër, përveç përlësisë dhe dëgjueshmërisë ndaj All-llahut xh.sh., Sunduesit të gjithësisë, Dielli, Hëna, Toka dhe gjithë trupat tjerë qiellorë, domethënë, janë “muslimanë”. Po kështu qëndron puna edhe me ajrin, ujin, të nxehtin, mineralet, florën dhe faunën. Çdo gjë në gjithësi është me përkatësi muslimane, sepse i nënshtrohet Zotit duke iu nënshtuar ligjeve të Tij. Edhe vetë gjuha e njeriut, e cila prej padijes e mohon ekzistimin e Zotit, ose adhuron dikë tjetër, përveç All-llahut, sipas natyrës së saj është muslimane. Koka e tij, të cilën e përulë para të tjerëve përveç All-llahut, instinktivisht është muslimane. Zemra e tij, e cila në mungesë diturisë së vërtetë, don dhe adhuron zota të tjerë, instinktivisht është muslimane, sepse të gjitha ato i janë nënshtuar ligjit të Zotit, funksionet dhe lëvizjet e tyre janë të rregulluara në bazë të urdhrave të atij ligji të vetëm.

Kjo është shkurtimisht, pozita e vërtetë e njeriut dhe kozmosit. Tani ta vëzhgojmë këtë problem nga kënde të ndryshme. Njeriu posedon natyrë të dyfishtë, jeta e tij zhvillohet në dy mënyra. Në njërin anë, si edhe të gjitha krijesat tjera, ai tërësisht është i varur prej ligjeve natyrore dhe nuk

mund t'u ikë atyre. Por, në anën tjetër, njeriu është i dhuruar e i pajisur me arsye të shëndoshë (intelekt). Ai ka aftësi mendimi dhe gjykimi, ka mundësi të zgjedhë ose refuzojë, të lejojë ose të dënojë. Ai është i lirë të zgjedhë fenë e vet, mënyrën e vet të jetesës dhe ta orientojë jetën e vet sipas ideologjive të cilat ai i zgjedh. Mund ta trasojë kodin e vet personal të sjelljes ose ta pranojë të huajin. Është i dhuruar me vullnet të lirë të vendosë për sjelljen e tij personale. Në këtë plan të dytë, përkundër krijesave tjera ai fitoi lirinë e të menduarit, lirinë e zgjedhjes dhe të veprimit. Këto dy aspekte pa dyshim koekzistojnë në jetën e njeriut.

Në rastin e parë, njeriu, ashtu si edhe të gjitha qeniet tjera, është i bindur se do të mbetet musliman, ndaj automatikisht ndjek urdhrat e Zotit. Në rastin e dytë, ai ka lirinë e zgjedhjes, të bëhet ose mos të bëhet musliman, dhe mënyra e shfrytëzimit të kësaj lirie i ndanë njerëzit në dy grupe: në besimtarë dhe jobesimtarë. Ai i cili vendosë të pranojë Krijuesin e tij, ta pranojë për të Vetmin Sundues të vetin, me plot vetëdije t'u nënshtrohet urdhrave të Tij, të ndjek ligjin të cilin Ai ia zbuloi njeriut për jetën e tij individuale dhe shoqërore, me atë bëhet musliman i plotë. Ai ka arritur Islamin e plotë, duke vendosur që vullnetarisht dhe vetëdijshëm t'i nënshtrohet Zotit xh.sh., në lëmin në të cilin është i dhuruar me liri zgjedhjeje. Tash tërë jeta e tij është jetë e nënshtroar Zotit dhe nuk ka konflikt me personalitetin e tij. Ai është musliman i përsosur dhe Islami i tij është i plotë sepse nënshttrimi i tërë qenies së tij ndaj dëshirës së All-llahut xh.sh. është Islami dhe asgjë tjetër përveç se Islami.

Ai tash me vetëdije i nënshtrohet Atij, të cilit i është nënshtroar pa vetëdije. Të njohurit e tij tash është real, sepse pranoi Qenien, e cila ia dha aftësinë të mendojë dhe të gjykojë. Gjuha e tij flet të vërtetën, sepse lavdëron Zotin, i cili i dha aftësinë e të folurit. Tash tërë jeta e tij është mishërim i së vërtetës, sepse dy natyrat e tij, instinkti dhe dëshira e tij, u nënshtrohen ligjeve të Zotit të

vetëm, Sunduesit të Gjithësisë. Ai është në paqe me tërë gjithësinë, sepse ai adhuron Atë, të cilin e adhuron e tërë gjithësia. Ai njeri është mëkëmbës i Zotit në Tokë, Bota i takon atij, kurse ai i takon Zotit xh.sh.

Përkundër besimtarit ekziston njeriu, i cili edhe pse sipas natyrës është musliman, ai mbetet gjatë tërë jetës pa vetëdije, duke mos i shfrytëzuar mendjen dhe intuitën si dhunti për pranimin e Zotit dhe Krijuesit të vet, njëkohësisht edhe keqpërdor lirinë e zgjedhjes që mos ta pranojë. Ky njeri është jobesimtar ose, në gjuhën e Islamit, kafir.

NATYRA E KUFRIT

”Kufri” tekstualisht do të thotë “fshehje, tinëzim”. Njeriu, i cili nuk pranon Zotin quhet kafir, “fshehës”, sepse me mosbesimin e tij fsheh atë që është e pandarë prej natyrës dhe shpirtit të tij - meqë natyra e tij instinktivisht është e orientuar kah Islami. I tërë trupi i tij, secila kordhë dhe qime, funksionon duke e dëgjuar këtë instinkt (shtytje). Çdo grimcë e gjallë kryen funksionin në pajtueshmëri me ligjin islamik duke e kryer rolin, i cili i është caktuar. Por vizioni i këtij njeriu është i mjegulluar, mendja e tij është e errësuar, ndaj ai nuk është i aftë që të shohë qartë. Ai nuk mund ta njohë natyrën e tij personale, mendon dhe vepron në mospajtim të plotë me të. E vërteta i tjetërsohet, e ai përplas këmbët në errësi. Ashtu është natyra e kufrit.

Kufri është forma e paditurisë, ose, më mirë të themi, ai është padituri me plotkuptimin e fjalës. A ekziston në të vërtetë, padituri më e madhe prej injorimit të Zotit, Krijuesit, Sunduesit të

gjithësisë? Njeriu vëren panoramën e pamatur të natyrës, mekanizmin e saj të jashtëzakonshëm dhe të pandryshueshëm, projektin madhështor, i cili shkëlqen në të gjitha llojet e krijimit; vëzhgon këtë makinë gjigante, por nuk e di se kush është Krijuesi dhe Drejtuesi i saj. Shikon trupin e vet, atë organizëm të jashtëzakonshëm, i cili funksionon në mënyrë të jashtëzakonshme, dhe e shfrytëzon për arritjen e qëllimeve të tij personale, kurse nuk është i aftë të njohë Fuqinë, e cila e ka krijuar, Inxhinierin i cili e projektoi këtë makinë dhe e prodhoi atë, Krijuesin i cili krijoi këtë qenie të vetme: njeriun, prej materies jo të gjallë: thëngjillit, kalciumit, natriumit... Ai shikon planin e jashtëzakonshëm të gjithësisë, por nuk është në gjendje ta njohë Atë, i cili e ka paramenduar. E fascinon funksionimi harmonik por jo edhe Krijuesi i të gjitha këtyre. Në gjithësi rreth vetes, mund të shohë argumentet më të mira të mjeshtërisë në shkencë, në filozofi, në matematikë, ose në teknikë, por nuk sheh Qenien, e cila e krijoi tërë këtë gjithësi të gjerë dhe të pakuptueshme. Si mundet që njeriu i paaftë për ta vërejtur këtë realitet të vendosshëm, të arrijë një perspektivë të vërtetë në shkencë? Si mundet njeriu, i cili ka zgjedhur rrugë të gabuar, të qëllojë pikarritjen e vërtetë? Asnjëherë nuk do të mundet të sqarojë Realitetin, Rrugën e vërtetë do ta ketë të mbyllur për çdoherë, çfarëdo që do të marrë në lëmin e shkencës ose artit asnjëherë nuk do të mund ta përjetojë dritën e së vërtetës dhe të urtisë. Do të vazhdojë të përplasë këmbët dhe të thellohet në errësirën e paditurisë.

Dhe jo vetëm ajo: Kufri është tirani (dhunë), bile tirania më e keqe. E çka mund të jetë tirania, përveçse shfrytëzim mizor dhe jo i drejtë i fuqisë dhe pushtetit? Nëse detyrohet diçka ose dikush që të punojë kundër së drejtës ose natyrës së saj, dhe dëshirës personale, ajo është tirani.

Pamë se çdo gjë në gjithësi i është nënshtuar Zotit, Krijuesit. Është e natyrshme t'i nënshtrohesh, të jetosh në pajtueshmëri me dëshirën dhe ligjin e Tij (gjegjesisht: të jesh musli-

man). Zoti xh.sh. i dha njeriut pushtet mbi të gjitha gjërat, natyra e të cilave kërkon të përdoren për plotësimin e dëshirës së Tij, ekskluzivisht për të. Ai, i cili nuk i nënshtrohet Zotit, ai i cili është kafir, bën padrejtësi tejet të madhe sepse shfrytëzon aftësitë e trupit dhe mendjes së vet që të ngrihet kundër rrjedhës së natyrës, dhe ashtu kundër dëshirës së vet, bëhet instrument i dramës së mosnështrimit. Ai e çon kokën e tij që të përkulet para zotave tjerë, e jo para Zotit të Vërtetë, kultivon në zemrën e vet dashuri, respekt dhe frikë ndaj ndonjë autoriteti tjetër, që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me instinktet natyrore të këtyre organeve. Ai shfrytëzon pushtetin me të cilin disponon, kundër dëshirës kategorike të Zotit dhe ashtu vendos pushtetin e tij tiranik. A mund të ketë padrejtësi, tirani dhe mizori më të madhe prej asaj që ky njeri ia imponon tjetrit dhe papërfillje e obligon ta ndjek drejtimin përkundër natyrës dhe drejtësisë.

Kufri nuk është vetëm tirani; ai shprehur më butë është kryengritje, pamiradi dhe tradhti. Pas krejt kësaj, çka është në të vërtetë njeriu? Si është fuqia dhe autoriteti i tij? A e ka krijuar ai mendjen, zemrën, shpirtin, trupin e vet personal ose atë e ka krijuar Zoti xh.sh.? Zoti ose ai e krijoi gjithësinë? Kush bën që krejt fuqitë e natyrës t'i shërbejnë njeriut- njeriu ose Zoti? Nëse tërë këtë e ka krijuar Zoti, dhe vetëm Zoti, kujt i takon atëherë ajo? Kush është pronar i vërtetë i tyre? Zoti dhe vetëm Zoti. E nëse Zoti është Krijues, Sundues, Sovran, a ka atëherë renegat më të madh se njeriu, i cili shfrytëzon veprat e Zotit kundër urdhrave të Tij - i cili kthen zemrën dhe mendjen e tij kundër Zotit, dhe shfrytëzon tërë aftësitë e veta kundër dëshirës së Sunduesit. Shërbëtori, i cili tradhton zotëriun e vet, oficeri i cili kthehet kundër vendit të vet, ai i cili mashtron bamirësin e vet,- të gjithë këta janë tradhtarë. Por çka të themi për tradhtinë, për pamiradinë e pabesimtarit, kafirit? Tekefundit kush është lëvizës i vërtetë i çdo fuqie dhe autoritet? Kush e ngriti njeriun në pozitë të lartë? Krejt ajo që e ka njeriu dhe krejt ajo që e përd-

rë në të mirë të të tjerëve, është dhunti e Zotit. Njeriu ndaj prindërve në këtë botë ka obligime të mëdha: Por kush e ka krijuar në zemrën e prindërve këtë dashuri ndaj fëmijëve të tyre, dhe i inspiroi që të bëjnë krejt çka u vjen për dore për të mirën e fëmijëve? Kush i dhuroi nënës dashurinë dhe mundësinë t'i ushqejë fëmijët e vet? Pa dyshim, ai është Zoti, Bamirës më i madh i njeriut. Ai është Krijues, Ushqyes si dhe Sundues i vërtetë dhe Sovran. Ashtu është pozita e Zotit përkundër njeriut, dhe nuk ka tradhti dhe pamiradi më të madhe se kufri, i cili e çon njeriun që të mohojë Zotin e tij të vërtetë.

Do të ishte mjaft qesharake sikur të mendonim se njeriu duke e pranuar kufrin do ta dëmtojë Zotin e Gjithëfuqishëm. Aspak. Çfarë dëmi do të mund t'i sillte njeriu, i cili është si një grimcë e pavlefshme pluhuri në sipërfaqen e një planeti të vogël, i cili rrotullohet në gjithësinë e pakufizuar, Sunduesit të botës, mbretëria e të Cilit është aq e gjerë saqë nuk jemi në gjendje t'i shohim kufijtë e saj edhe me ndihmën e teleskopëve më të fortë. Fuqia e të Cilit është aq e madhe saqë trupa qiellorë të panumërt si Toka, Hëna, Dielli dhe yjet i nënshtrohen urdhrin të Tij. Kush kujdeset për tërë nevojat e tij dhe nuk i nevojitet askush që të kujdeset për Të. Revolta e njeriut ndaj Zotit nuk mund t'i sjell asnjëfarë dëmi Zotit, përkundrazi, njeriu me mosnënshtrimin e tij shkon në rrugën e humbjes dhe të pamëshirës.

Pasoja e paevitueshme e këtij kundërshtimi dhe refuzimi të Realitetit është mossa e idealeve jetësore. Kryengritësi nuk do të gjejë asnjëherë rrugën e njohjes (gnosës) së vërtetë, sepse dituria, e cila nuk është në gjendje të zbulojë Krijuesin e vet, nuk mund të zbulojë kurrfarë të vërtete. Shpirti dhe mendja njeriun e tillë gjithmonë do ta devijojnë. Si do t'i shpjegojë sekretet e jetës, mendja e cila nuk mund ta njohë Krijuesin e vet? Ai njeri do të ketë vetëm mossa në të gjitha lëmenjtë. Jeta e tij morale, qytetare, shoqërore dhe familjare, lufta e tij që të sigurojë

ekzistimin e vet tërë kjo do të jetë e çrregulluar. Ai në botë do të shkaktojë vetëm trazira dhe kaos. Duke mos e brejtur aspak ndërjegjja, ai do të derdhë gjak, do t'i shkelë të drejtat e të tjerëve, do të jetë i ashpër ndaj tyre, do të bëjë trazira dhe ndarje në botë. Mendimet dhe ambiciet (synimet) e tij të orientuara gabimisht, vegimi (vizioni) i tij i turbullt, shkalla e çrregulluar e shkathësisë dhe aktivitetet e tij dhëlpërake do të jenë të kobshme si për atë ashtu edhe për mesin në të cilin jeton. Ai njeri mund të rrënojë paqen dhe ekuilibrin e jetës në tokë. Ai njëkohësisht do të jetë fajtor në botën tjetër për të këqijat që ia bëri vetvetes. Çdo organ i trupit të tij: truri, sytë, hunda, duart, këmbët e tij do të ankohen kundër padrejtësisë dhe ashpërsisë, të cilat i bëri ndaj tyre. Çdo qelizë e trupit të tij do ta mallkojë para Zotit, me burime të sakta të drejtësisë, i Cili do t'ia japë dënimin të cilin e meriton. Kjo është pasoja e turpshme e kufrit. Ai shpie në mossakses total si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër.

BEGATITË E ISLAMIT

Pasi i vërejtëm pasojat e tmerrshme të kufrit, të shohim tani se çka fitojmë nëse e përvetësojmë qëndrimin islamik.

Në botën, e cila ju rrethon, ju edhe në veten tuaj mund të shihni manifestime të panumërta të fuqisë së Zotit. Kjo gjithësi gjigante, e cila vazhdimisht funksionon me një orar (rregull) të vetëm, sipas ligjit të pandryshueshëm, dëshmon vetvetiu se Ai, i cili e krijoi, është Qenie e Gjithëfuqishme, me dije dhe fuqi të pakufizuar, urtia e të cilit është e përsosur dhe të Cilit askush

në gjithësi nuk guxon të mos i nënshtrohet. Natyra e vetë njeriut si dhe e të gjitha sendeve në gjithësi është që t'i nënshtrohen Atij. Në realitet, njeriu prej dite në ditë, pa vetëdije i nënshtrohet ligjit të Tij, sepse nëse nuk i nënshtrohet atëherë i kanoset vdekja ose shkatërrimi. Ai është ligji i natyrës ndaj të cilit gjithmonë duhet të kemi kujdes.

Zoti i dha njeriut mundësinë që të fitojë dituri, të mendojë dhe të meditojë, të dallojë të mirën prej të keqes; por përveç asaj Zoti ia dha lirinë relative të dëshirës dhe të veprimit. Në këtë liri është edhe sprovimi i njeriut: dituria, urtia, gjykimi, liria, dëshira dhe veprimi i tij, i janë të nënshttruara testit dhe sprovës. Këtu njeriu nuk është i detyruar të përvetësojë rrugë të posaçme sepse ky detyrim mund të prishë tërë kuptimin e sprovës. Nëse gjatë të të pyeturit jeni të detyruar të jepni përgjigje të caktuar, të pyeturit është e tepërt. Merita juaj mund të vlerësohet drejt vetëm nëse ju mundeni lirisht të përgjigjeni në pyetjet sipas dijes dhe kuptimit tuaj personal. Nëse përgjigjja juaj është e saktë, atëherë ia keni arritur qëllimit dhe do të mund të vazhdoni të përparoni. Nëse përgjigjja juaj është negative, mossauesi juaj do t'ua ndërprejë përparimin e mëtutjeshëm; i njëjti rast është edhe me njeriun në botë. Zoti i ka dhënë lirinë e dëshirës dhe aksionit, ashtu që lirisht mund të zgjedhë mënyrën e jetesës- Islam ose kufër.

Domethënë, në njërën anë haset njeriu, i cili nuk e kupton natyrën e vet personale e as natyrën e gjithësisë. Ai nuk di kush është Sunduesi i Vërtetë i tij, si janë cilësitë e Tij, ndaj keqpërdorë lirinë e vet, duke ndjekur rrugën e mosnënshtimit dhe kryengritjes. Ky njeri ka rënë në provimin e ditorisë së vet, të inteligjencës dhe të ndjenjës së obligimit të vet, ai nuk meriton fat më të mirë nga ai për të cilin folëm pak më parë.

Në anën tjetër mund të haset njeriu, i cili del fitues në këtë provim. Duke e shfrytëzuar drejt diturinë dhe inteligjencën e vet, ai pranon Krijuesin e vet, beson në të dhe pa kurrfarë dhune e zgjedh rrugën e nënshtrimit ndaj tij. Ai di të dallojë të mirën prej të keqes, edhe pse është plotësisht i lirë që atë ta bëjë, ai zgjedh Të Mirën. Ai kupton natyrën e vet personale, u nënshtrohet ligjeve dhe realiteteve të saja si dhe përvetëson rrugën e nënshtrimit dhe besnikërisë ndaj Zotit, Krijuesit të vet, edhe pse është i lirë të ndjekë cilën rrugë të dojë, ai e kaloi sprovën sepse me mirësjellje shfrytëzoi mendjen dhe tërë aftësitë e veta; shfrytëzoi sytë - që të shohë Realitetin, veshët - të dëgjojë të vërtetën, mendjen - të formojë mendim të drejtë dhe me zemër e me shpirt të ndjekë rrugën e drejtë të cilën e zgjodhi.

Ai zgjedh të vërtetën, sheh realitetin, i nënshtrohet me gëzim Zotit të vet. Ai është inteligjent, i sinqertë, i vetëdijshëm, ai ka zgjedhur dritën në vend të errësirës dhe me entuziazëm e pranoi thirrjen. Në këtë mënyrë me sjelljen e tij argumenton se ai nuk është vetëm ai, i cili e kërkon të vërtetën, por ai është, i cili di të njohë dhe të respektojë. Ky njeri do të korrë sukses edhe në këtë botë, por edhe në botën tjetër, sepse ai është në rrugën e drejtë dhe do ta ndjekë atë në të gjitha lëmenjtë e të njohurit dhe të vepruarit. Ai i cili njeh Zotin me të gjitha cilësitë e Tij, ai njëkohësisht njeh edhe çdo gjë më të rëndësishme të Realitetit. Ai nuk mundet të devijojë sepse hapi i tij i parë është në rrugë të mirë dhe ai është i sigurt në përdorimin e rrugës së tij jetësore.

Në lëmin e filozofisë ai do të mendojë për sekretet e gjithësisë dhe do të mundohet të kuptojë misteret (dramën hyjnore) e natyrës, por përkundër filozofit-pabesimtar, ai nuk do të humbet në labirintin e dyshimit dhe skepticizmit. Drita Hyjnore do ta ndriçojë rrugën e tij dhe do t'i orientojë hapat e tij në drejtim të mirë.

Në lëmin shkencor, ai do të mundohet të njohë ligjet e natyrës, të zbulojë thesaret e fshehta të tokës, dhe të drejtojë tërë fuqinë, bile edhe të panjohurat- shpirtin dhe materien - krejt për të mirën e njerëzimit. Do të provojë të analizojë të gjitha rrugët e diturisë dhe të forcës, dhe të shfrytëzojë gjithë çka ekziston në botë e në qiell në dobi të njeriut.

Në secilën shkallë të hulumtimit të tij, vetëdija e tij mbi Zotin do ta pengojë atë që ta keqpërdorë shkencën dhe metodat shkencore.

Ai nuk do të mendojë, bile se është zotëri i të gjitha këtyre sendeve, pushtues i natyrës, duke ia përvetësuar ashtu vetes prerogativet (privilegjet) hyjnore, ai nuk do të kultivojë ambicie rrënuese mbi gjithësinë, nuk do ta nënshtrojë gjininë njerëzore, duke e forcuar pushtetin e vet, duke mos ngurruar edhe prej mjeteve më të këqija. Ky qëndrim revolte dhe provokimi nuk mund të përvetësohet nga ana e shkencëtarëve muslimanë, vetëm shkencëtari kafir mund të jetë viktimë e atyre iluzioneve, dhe duke iu nënshtruar atyre, ta vejë tërë gjininë njerëzore në rrezik, ku i kanoset edhe shkatërrimi i plotë. Përkundrazi, shkencëtari musliman do të silltet krejtësisht ndryshe. Sa më thellë që do ta kuptojë botën shkencore, feja e tij në Zotin do të jetë aq më e fortë. Ai para Zotit do ta përkul kokën prej falënderimit. Meqë Zoti i tij e ka gëzuar, duke i dhënë më shumë dituri, ai patjetër duhet të punojë për të mirën e vet personale dhe për të mirën e njerëzimit. Në vend që të jetë kryelartë, ai do të jetë modest, në vend që të mburret me fuqinë e tij personale, ai do të realizojë gjëra të mëdha për të mirën kolektive. Liria e tij nuk do të jetë e pafrenuar. Ai do të jetë i udhëhequr prej parimeve të moralit dhe prej Shpalljes së Zotit. Sipas asaj, dituria në duart e tij, në vend që të bëhet instrument i shkatërrimit, do të bëhet mjet i koekzistencës së njerëzve dhe rindërtimit të moralit. Dhe në këtë mënyrë do të shprehë falënderimin e tij ndaj Zotit të vet për dhuntitë dhe begatitë, të cilat ia dha njeriut.

Po ashtu edhe në histori, në ekonomi, në politikë, në drejtësi dhe në të gjitha degët tjera të artit dhe të shkencës: muslimani nuk do të lejojë që t'ia tejkalojë kafiri, por shikimet e tyre e sipas asaj edhe “modus operandi” i tyre, do të dallohet shumë. Muslimani do të studiojë çdo degë të shkencës në perspektivën e saj të drejtë, do të orvatet të arrijë cakun e vërtetë dhe do të vijë deri në konkludime të sakta. Në histori, ai do të marrë mësimë prej përvojave të kaluara të njerëzve, dhe do të zbulojë shkaqet e vërteta të ngritjes dhe të shkatërrimit të civilizimeve. Do të mundohet që të nxjerr dobi prej krejt asaj çka qenë e mirë dhe e drejtë në të kaluarën dhe do të largohet me plot vetëdije prej krejt asaj që ka sjell deri në rënien morale të popujve. Në politikë, caku i tij i vetëm do të jetë themelimi i rendit të paqes, drejtësisë, vëllazërimit dhe bamirësisë, ku njeriu është vëlla i njeriut dhe respekton cilësitë e tij njerëzore, ku nuk mbretëron kurrfarë forme eksploatimi ose robërie, ku janë të respektuara të drejtat e individëve dhe ku pushteti shtetëror është amanet i shenjtë i Zotit, i cili duhet të shfrytëzohet për koekzistimin universal. Për sa i përket drejtësisë, muslimani do të orvatet ta bëjë atë instrument të vërtetë të drejtësisë për mbrojtjen e të drejtës së secilit, posaçërisht të të pafuqishëmve. Ai do të shohë që secili të marrë pjesën që i takon, dhe që askujt mos t'i bëhet padrejtësi ose shtypje. Do ta respektojë ligjin, duke kërkuar që edhe të tjerët ta bëjnë atë, dhe do të kujdeset që drejtësia të ndahet drejt.

Jeta shpirtërore e muslimanit gjithmonë do të jetë e mbushur me devotshmëri, drejtësi dhe besnikëri. Ai do të jetojë në këtë botë me bindje se vetëm Zoti është Sunduesi ynë, dhe se krejt atë që posedon ai dhe njerëzit tjerë e ka dhënë Zoti, se pushteti me të cilin ai disponon është amanet hyjnor, se lirinë e cila i është dhënë, duhet ta shfrytëzojë me mend, në interes të tij do të ishte sikur ta shfrytëzonte në pajtim me Dëshirën e Zotit. Ai gjithmonë do të ketë parasysh se një ditë patjetër duhet t'i kthehet Sunduesit dhe do të japë llogari për tërë jetën e tij. Ndjenja e

përgjegjesisë do të mbesë gjithmonë e mbjellur qëndrueshëm në shpirtin e tij dhe ai asnjëherë nuk do të sillet me papërgjegjësi dhe pakujdesi.

Paramendoni moralin e përsosur të njeriut, i cili jeton në këtë pozitë. Jeta e tij do të jetë jetë e pastërtisë, e devotshmërisë, e dashurisë, e altruizmit. Ai do të jetë bekim për tërë njerëzimin. Shpirti i tij nuk do të jetë i shqetësuar me mendime të këqija dhe me dëshira të çudishme. Ai nuk do të shikojë të keqen, nuk do të dëgjojë dhe nuk do të bëjë të keqen. Ai do të sundojë me gjuhën e tij dhe asnjëherë nuk do të gënjejë. Ai do të fitojë në mënyrë të ndershme dhe të drejtë, më mirë do të mbetet i uritur sesa të ushqehet me ushqimin, i cili është arritur me uzurpim ose me padrejtësi. Ai asnjëherë nuk do të jetë bashkëpunëtor në shtypjen ose rrënimin e jetës dhe të nderit të njeriut në çfarëdo mënyrë. Asnjëherë nuk do t'i nënshtrohet të keqes pa marrë parasysh sa do të jetë çmimi që për të duhet të paguajë. Ai do të jetë mirësi dhe fisnikëri e gjallë, do të mbrojë të drejtën dhe të vërtetën nëse duhet edhe me jetën e tij. Do të neveritet prej të gjitha formave të padrejtësisë dhe do të qëndrojë i vendosur në mbrojtjen e së vërtetës, duke mos iu frikësuar torturës dhe mundimit. Ky njeri do të jetë forcë për të cilën duhet të kemi llogari. Ai i vetmi mund të korrë sukses, sepse asgjë në botë nuk do të mund ta kthejë ose ta pengojë në rrugën e tij.

Ai do të jetë njeriu më i respektuar, ndaj askush nuk do të mund t'ia kalojë në atë lëmi. Si mundet poshtërsia ta godasë njeriun, i cili nuk është gati që ta përkulë kokën e as që ta shtrijë dorën para askujt tjetër, përveç para Zotit të Gjithëfuqishëm, Sunduesin e botëve.

Ai do të jetë më i forti dhe më i suksesshmi. Askush nuk mund të jetë më i fortë se ai, sepse ai nuk i frikësohet askujt tjetër, përveç Zotit, ndaj kërkon bekim vetëm prej Tij. Çfarë fuqie do të

mundte ta largojë atë nga Rruga e Drejtë? Çfarë thesari do të mundte ta blejë fenë e tij? Çfarë fuqie do të mundte të ndikojë në sjelljen e tij?

Ai do të jetë njeriu më i pasur. Asnjëri në botë nuk mund të jetë më i pasur dhe më i pavarur se ai, sepse ai do të jetojë një jetë të matur dhe të lumtur. Ai nuk do të jetë epshar, tolerant ose lakmues. Do të kënaqet me atë që e arrinë ndershëm, e nëse edhe grumbuj thesarësh të fituar në mënyrë të pandershme të qëndrojnë para tij, ai me përbuzje do t'i shtynte ato. Ai do të ketë qetësi dhe lumturi në zemër, e çka mund të jetë më e madhe se ajo?

Ai do të jetë më i respektuari, më i dashuri dhe njeriu më i popullarizuar. Askush nuk mund të jetë më i përzemërt se ai, sepse ai jeton një jetë të mbushur me dashuri ndaj Zotit dhe njerëzve. Ai do të sillet drejt ndaj çdonjërit, obligimet e veta do t'i plotësojë ndershëm dhe do të punojë sinqerisht për të mirën e të gjithëve. Kuptohet, do t'i tërheq zemrat e njerëzve dhe secili do ta nderojë dhe do ta respektojë. Secili do ta marrë parasysht dhe do të ketë besim në të. Askush nuk do të jetë më i denjë se ai, sepse ai nuk është feprishës, por përkundrazi, model i ndershmërisë, njeri i fjalës, i ndershëm në punë. Do të jetë i mirë dhe i drejtë në të gjitha punët e tij, sepse ai e di se Zoti është kudo i pranishëm dhe i zgjuar. Nuk ka fjalë që të përshkruhen meritat dhe fama, të cilat i posedon ai njeri. Si mund të ketë merita ai që nuk i beson? Ashtu është jeta e muslimanit të vërtetë.

Nëse keni kuptuar natyrën e muslimanit të vërtetë, ju do të bindeni se ai nuk mund të jetojë në poshtërsi dhe nënshtrim. Ai është i caktuar të bëhet sundues, dhe asnjë fuqi botërore nuk mund që ta pengojë dhe ta përfitojë. Sepse Islami e frymëzon me cilësi, të cilat nuk mund të zbehen me asçfarë fjalësh magjike dhe fjalë mashtrimi.

Dhe meqë ka jetuar ndershëm në këtë jetë, ai do t'i kthehet Sunduesit të vet, i Cili do ta stërbush me begatitë e Tij, sepse detyrën e vet e ka kryer ndershëm, e ka plotësuar me sukses misionin e tij dhe është kthyer prej provimit si fitues. Ka korrë sukses në këtë botë, kurse në të ardhshmen do të jetojë në paqe, në gëzim dhe fat të përhershëm.

Ky është Islami, feja e natyrshme e njeriut, fe e cila nuk është e lidhur me asnjë person, popull, periudhë ose vend. Ai është rrugë natyrore, fe e njeriut. Në çdo kohë, në çdo vend dhe te të gjithë popujt, të gjithë ata që e kanë pranuar Zotin dhe e kanë dashur të vërtetën, kanë besuar në këtë fe dhe i janë përshtatur asaj. Të gjithë ata kanë qenë muslimanë pa marrë parasysh se a e quajtën këtë mënyrë të jetesës Islam ose diçka tjetër. Sidoqoftë, emri i tij ka qenë Islami dhe vetëm Islami.

KAPITULI II

FEJA DHE NËNSHTRIMI

Islami do të thotë nënshttrim ndaj Zotit xh.sh. Kuptohet se ky nënshttrim do të jetë në masë të plotë vetëm nëse njeriu i njeh faktet themelore dhe është i bindur fortë në to. Cilat janë parimet, të cilat duhet t'i njohë njeriu që ta orientojë jetën e vet në pajtim me udhëzimet e Zotit? Propozoj që këtë ta sqarojmë në kapitullin që vijon.

Para së gjithash, duhet të ketë besim të paluhatshëm në ekzistimin e Zotit. Si do të ishte njeriu i nënshttruar Zotit, nëse nuk është i bindur thellë në ekzistimin e Tij?

Pastaj duhet njohur cilësitë e Zotit. Të njohurit e këtyre cilësive i mundëson njeriut të kultivojë vlera fisnike, dhe të jetojë si njeri i moralshëm dhe i devotshëm. Nëse njeriu nuk e di se Zoti ekziston, se ai është i vetmi, Krijues dhe Sundues i gjithësisë, dhe se me askë nuk ndan pushtetin e vet, atëherë, ai mund të bëhet sakrificë e besimeve të rrejshme dhe t'u nënshtrohet atyre duke pritur mëshirën e tyre. Por nëse njeriu i njeh cilësitë e Zotit “Tevhidin” (Njëshmërinë e Zotit), nuk ekziston as mundësia më e vogël që ai të bëhet viktimë e këtyre iluzioneve. Po ashtu nëse njeriu e di se Zoti është kudo prezent dhe i Gjithëdijsëm, se Ai sheh, dëgjon, dhe di krejt çka punojmë haptas dhe fshehtas, bile edhe mendimet tona të paformuara, si do të mund atëherë t'i besojë vetes që mos t'i nënshtrohet Zotit. Ai do të ketë parasysh se çdoherë është nën kontroll dhe do të sillet njerëzishëm. Por ai, i cili nuk i di këto cilësi të Zotit, mund të devijojë në rrugën e mosnënshtrimit.

I njëjti rast është edhe me të gjitha cilësitë tjera të Zotit. Fakt është se cilësitë, që njeriu duhet t'i posedojë nëse don të ndjekë rrugën e Islamit, mund t'i kultivojë dhe t'i zhvillojë vetëm duke i falënderuar njohjes së thellë të cilësive të Zotit. Njohja e këtyre cilësive pastron shpirtin dhe mendjen e njeriut, besimin e tij, moralin dhe veprat e tij. Njohja sipërfaqësore, ose vetëm teorike, e këtyre cilësive nuk është e mjaftueshme për detyrën, e cila e pret njeriun që të jetë i mbrojtur prej dyshimeve dhe devijimeve që i propozohen me dinakëri, duhet të ketë bindje të fortë, bindje me rrënjë të thella në zemër dhe në shpirt.

Pos asaj, duhet të njohë detajisht mënyrën e jetës, e cila është në pajtim me dëshirën e Zotit. Nëse njeriu nuk di se çka don ose nuk don All-llahu, si mundet të zgjedhë njërën e të refuzojë tjetrën? Nëse nuk njeh ligjin e Zotit si mund ta ndjekë Atë? Domethënë, njohja e ligjit të Zotit dhe Shpallja e librit po ashtu janë të pashmangshme në këtë kapitull.

Mirëpo nuk mjafton vetëm njohja. Njeriu duhet të ketë besim dhe bindje të plotë se ai është ligji i Zotit, dhe se shpëtimi i tij varet nga zbatimi i këtij ligji. Sepse njohja pa bindje nuk do ta shtyjë njeriun kah rruga e drejtë, ndaj ai rrezikohet me këtë, saqë mund të humbet në qorrrokakun e padëgjueshmërisë.

Së fundi, duhet të njohë pasojat e besimit dhe të nënshtrimit, dhe pasojat e mosbesimit dhe të mosnënshtrimit. Njeriu duhet të dijë se nëse e zgjedh Rrugën e Zotit dhe nëse jeton një jetë të pastër dhe të moralshme, me çfarë begati do të jetë i shndritur. Ai po ashtu duhet të dijë, çfarë do të jenë pasojat e kobshme nëse përvetëson jetën e mosnënshtrimit dhe të rezistencës. Këtu është e pashmangshme njohja e botës së ardhshme, e cila na pret pas vdekjes. Njeriu gjithmonë duhet të ketë besim në faktin se vdekja nuk do të thotë fund i jetës: se do të ketë ringjallje, se do të dalë para gjyqit më të lartë në të cilin komandon All-llahu xh.sh. personalisht; se në Ditën e Gjykimit do të fitojë e vërteta; se për veprat e mira fitohen shpërblime e për të këqijat dënime. Askush nuk do të mund të ikë, çdokush do të pranojë atë që ka merituar. Kjo patjetër duhet të ndodhë. Kjo ndjenjë përgjegjësie është e domosdoshme për nënshtrimin e plotë ndaj Ligjit të Zotit.

Njeriu, që nuk ka kurrfarë parafytyrimi për botën e ardhshme, mund të mendojë se nënshtrimi dhe mosnënshtrimi nuk kanë kurrfarë vlefte. Mund të mendojë se edhe ai që nënshtrohet edhe ai i cili nuk nënshtrohet do të kenë përfundim të njëjtë: sipas tij, pas vdekjes që të dy ata do të shndërrohen në pluhur. Si mund të presim prej njeriut me kësaj mendimi që t'u nënshtrohet fatkeqësive dhe kufizimeve, të cilat ekzistojnë në jetën e nënshtruar aktive, dhe t'u ikë atyre mëkateve, të cilat në shikim të parë nuk i sjellin kurrfarë humbje materiale ose morale në këtë botë? Me kësaj mendimi njeriu nuk pajtohet që t'i nënshtrohet Ligjit të Zotit. E as që mundet njeriu, i cili nuk është i bindur thellë në ekzistimin e jetës së ardhshme dhe Ligjit të Zotit të

mbetet i fortë dhe i vendosur në ujërat e shqetësuarra të jetës, në mes krejt asaj që e dërgon në mëkat dhe në krim: sepse dyshimi dhe hamendja e largojnë njeriun nga dëshira e tij për veprim. Ju mundeni të mbeteni të fortë në sjelljen tuaj vetëm nëse jeni të fortë në bindjet tuaja; kjo rrugë mund të ndiqet rrënjësisht vetëm nëse njeriu është i sigurt në begatitë e tij dhe nëse e di se me çfarë dëmsh do të ballafaqohet në rast se nuk u nënshtrohet. Domethënë, nevojitet njohja e plotë për pasojat e besimit dhe të mosbesimit në botën e ardhshme, që të jetohej një jetë e plotë me nënshttrim ndaj Zotit xh.sh..

Këto janë fakte esenciale, të cilat duhet t'i njohim nëse dëshirojmë të jetojmë një jetë të nënshttruar, që domethënë jetë islamike.

ÇKA DO TË THOTË FJALA “FE”?

“Fe” është krejt ajo që e përshkruam në diskursin e mëparshëm si “njohuri”, “bindje”. Fjala arabe “iman”, të cilën e përkthejmë si fe, tekstualisht do të thotë: besim, njohje, të qenurit i bindur pa kurrfarë dyshimi. Feja domethënë është siguri, i cili buron nga të njohurit dhe bindja. Njeriu, i cili di dhe i cili është fort i bindur në njësinë e Zotit, në atributet e Tij, në ligjin e Tij të shpallur, në rregullat hyjnore mbi shpërblimin dhe dënimin, ai njeri quhet “Mu’min” (besimtar). Kjo fe e udhëzon njeriun në jetë nënshttrimi dhe dëgjueshmërie ndaj dëshirës së Zotit. Kurse ai, i cili jeton jetë të nënshttruar quhet musliman.

Kjo argumenton qartë faktin se pa fe (iman) askush nuk mund të jetë musliman i drejtë. Kjo është nevojë e domosdoshme, ose më mirë të themi, kjo është pikënisje. Marrëdhënia ndërmjet Islamit dhe Imanit është e njëjtë si marrëdhënia e drurit dhe farës së tij. Ashtu siç nuk mund të rritet druri pa farë po ashtu nuk është e mundur që njeriu, i cili nuk ka fe të bëhet musliman. Por, siç ndodh ndonjëherë që edhe pas mbjelljes së farës druri nuk mbinë, edhe atë për shumë shkaqe, ose nëse mbinë, rritja e tij është e vogël dhe e dobët, po ashtu mund të gjendet njeriu, i cili ka fe, por për shkak të dobësive të posaçme nuk mund të bëhet musliman i drejtë dhe i fortë. Pra, shohim se feja është pikënisje dhe se e udhëzon njeriun në jetë të nënshtruar ndaj Zotit dhe se nuk mund të bëhet askush musliman pa besim. Përkundrazi, njeriu mund të ketë fe, por për shkak të dëshirës së tij të dobët, sjelljes së keqe ose shoqërisë së keqe, ai nuk mund të jetojë si musliman i vërtetë. Sipas qëndrimit të Islamit dhe Imanit, të gjithë njerëzit mund të përmbliken në katër grupe:

a) Ata, të cilët kanë fe të fortë, fe e cila i bën që plotësisht dhe përgjithësisht t'i nënshtrohen Zotit. Ata ndjekin rrugën e Zotit dhe kërkojnë me zemër e me shpirt kënaqësinë e Tij duke punuar gjithë atë që dëshiron Ai dhe duke iu larguar krejt asaj që nuk e dëshiron Ai. Në besnikërinë e tyre ata janë më të zellshëm se njeriu i thjeshtë, i cili lakmohet pas pasurisë dhe famës. Këta njerëz janë muslimanë të vërtetë.

b) Ata, të cilët kanë fe, të cilët besojnë në Zotin, në Ligjin e Tij, në Ditën e Gjukurimit, por feja e të cilëve nuk është mjaft e fortë dhe e thellë që t'i bëjë të nënshtruar plotësisht ndaj Zotit. Ata janë larg prej muslimanëve të vërtetë dhe ata do të meritojnë dënim për gabimet e veta dhe të metat e veta, por ata ende janë muslimanë. Ata janë fajtorë dhe mëkatarë, por nuk janë kryengritës. Ata pranojnë Sunduesin dhe Ligjin e Tij, edhe pse e thejnë atë diku, nuk ngrenë krye

kundër Tij. Ata pranojnë pushtetin e Tij suprem dhe pranojnë fajin e vet. Pra ata janë fajtorë dhe meritojnë dënim, por mbeten muslimanë.

c) Ata, të cilët nuk kanë fe. Këta njerëz refuzojnë të pranojnë pushtetin suprem të Zotit dhe ata janë kryengritës. Bile edhe nëse kanë sjellje të mirë dhe nëse nuk përhapin korrupsion dhe tirani, ata mbeten kryengritës, ndaj në shikim të parë veprat e tyre të mira kanë pak vlerë. Ata janë renegatë prej ligjit. Edhe nëse renegati bën vepra të posaçme në pajtim me ligjet e vendit, ai nuk mund të bëhet qytetar lojal dhe i nënshtuar, i njëjti rast është si me veprat e mira të atyre që luftojnë kundër Zotit, të cilat nuk mund të vijnë në baraspeshë me fajet, kryengritjet dhe mosnënshtimin e tyre.

ç) Ata, të cilët nuk posedojnë fe e as që bëjnë vepra të mira. Ata përhapin kaos në botë dhe i bëjnë krejt format e tiranisë dhe të shtypjes. Ato janë krijesat më të këqija sepse janë kryengritës, kundërvajtës dhe kriminelë.

Ky klasifikim i njerëzve tregon qartë se sukcesi i vërtetë dhe shpëtimi i njeriut varet prej Imanit (besimit). Feja e nënshtimit (Islami) lind prej kokrrës së imanit. Ky Islam mund të jetë i plotë dhe jo i plotë. Por pa iman nuk ka Islam. Aty ku nuk ka Islam ka kufër. Forma dhe natyra e tij mund të jenë të ndryshme, por, në çdo rast, ai do të jetë kufër dhe asgjë tjetër përveçse kufër.

Kjo tregon rëndësinë e imanit në jetën e mbushur plot me nënshtime ndaj Zotit xh.sh..

SI TA ARRIJMË NJOHJEN E ZOTIT?

Tash parashtrohet pyetja: Si ta arrijmë njohjen dhe fenë në Zotin, në cilësitë e Tij, në Ligjin e Tij dhe në Ditën e Gjykimit?

Më parë aluduar në manifestimet e panumërta hyjnore rreth nesh dhe në ne. Ato vërtetojnë se ekziston Një dhe vetëm Një Krijues, i cili komandon dhe sundon me gjithësinë. Këto argumente pasqyrojnë cilësitë hyjnore të Krijuesit. Urtinë e Tij të madhe, diturinë e Tij të gjithmbarshme, fuqinë e Tij të përgjithshme, mëshirën e Tij, forcën e Tij, shkurt krejt aftësitë e Tij kudo janë në njëzim (mashtrim) prej vërejtjes dhe përshtatjes së fortë të këtyre sendeve, të cilat në të vërtetë janë të qarta dhe të dukshme, edhe pse sytë e tij janë të hapura të lexojnë atë që është shkruar në Gjithësi. Mirëpo njerëzit këtu kanë gabuar. Disa kanë deklaruar se ekzistojnë dy Hyjni (zotëra), të dytët besojnë në trini, kurse të tretët kanë rënë në paganizëm. Disa filluan të adhurojnë fuqitë natyrore, kurse kanë ndarë hyjninë (zotin) në: Zotin e shiut, ajrit, zjarrit, jetës, vdekjes... Edhe pse manifestimet e Zotit janë plotësisht të dukshme, logjika e njeriut shumë herë ka rrëshqitur dhe nuk ka arritur të shohë realitetin në perspektivën e tij të vërtetë. E përjetonte atë me zemërim dhe ka arritur vetëm deri në hutim shpirtëror. Këtu nuk ka nevojë më gjerësisht të flasim për njëzimet e gjykimeve të njerëzve.

Po ashtu, për sa i përket jetës pas vdekjes, njerëzit kanë ndërruar shumë mendime të gabuara; p.sh. se njeriu do të bëhet pluhur dhe asnjëherë më nuk do të ringjallet; ose se njeriu i është nënshtruar procesit të ripërtëritjes së pandërprerë në këtë botë dhe se dënohet ose shpërblehet në periudhat e jetës së ardhshme.

Rëndësia është edhe më e madhe kur bëjmë fjalë për çështjen e mënyrës së jetës. Të formosh ligj të plotë dhe të baraspeshuar të jetës, i cili do të jetë sipas dëshirës së Zotit xh.sh. vetëm me ndihmën e logjikës së njeriut, është detyrë mjaft e rëndë. Bile edhe nëse njeriu është i dhuruar me aftësi më të larta të logjikës dhe shpirtit, duke poseduar urti dhe përvojë të mendimit shumëvjeçar, shikimet e tij që të shpreh saktë caqet e vërteta të jetës janë shumë të vogla. Mirëpo edhe nëse pas meditimit mjaft të gjatë, ia arrinë qëllimit, asnjëherë nuk do të jetë i sigurt se ka zbuluar të vërtetën dhe se ka përvetësuar rrugën e drejtë.

Duke parafytyruar, se testin më të pikëlluar të urtisë, logjikës dhe vetëdijes njerëzore, t'ia lëshojë aftësive të tij personale pa kurrfarë udhëzimi nga jashtë, që vetë të zbulojë rrugën e drejtë në jetën e kësaj bote, atëherë ata të cilët mundohen që me hulumtimet e veta personale dhe me përvojën e tyre të zbulojnë të vërtetën dhe shkathtësinë, kanë shpëtuar, kurse të tjerët të cilët nuk janë në gjendje të arrijnë këtë, plotësisht janë të humbur. Mirëpo, Zoti i ka shpëtuar krijesat e veta prej kësaj sprove të rëndë. Me mëshirën dhe mirësinë e Tij i dhuroi njerëzimit njerëz të zgjedhur, të cilëve ua njoftoi cilësitë dhe ligjin e Vet, u tregoi për domethënien dhe qëllimin e kësaj jete dhe jetës së ardhshme, dhe ashtu ua tregoi rrugën, e cila shpie në fat dhe në sukses të përhershëm. Këta njerëz të zgjedhur janë të dërguarit e Zotit xh.sh. All-llahu xh.sh. transmetoi diturinë dhe urtinë nëpërmjet të vahjit (shpalljes), kurse libri që përmban Informata Hyjnore quhet Libri i Zotit (Hyjnor), ose Fjala e Zotit. Testi i urtisë së njeriut dhe i gjykimit të tij flen në këtë siç vijon. Të pranojë Të dërguarin e Zotit pasi me kujdes ka vërejtur jetën e pastër dhe të devotshme të tij dhe mësimet e tij plot fisnikëri. Ai i cili posedon logjikë të shëndoshë dhe urti të vërtetë, do ta njohë të vërtetën dhe do të pranojë instruksionet, të cilat i ka dhënë Pejgamberi. Nëse nuk pranon Pejgamberin e Zotit dhe mësimet e tij, refuzimi i tij tregon se plotësisht është i paaftë që

të zbulojë të vërtetën dhe drejtësinë. Mu për këtë braktisje ai do të bie në provim. Ky njeri asnjëherë nuk do të jetë i aftë të zbulojë të vërtetën për Zotin, për ligjin e Tij dhe për jetën pas vdekjes.

Ajo është përvojë e çdoditshme, që kur nuk dini diçka kërkonit atë, i cili atë e di, i besoni dhe e dëgjoni atë. Kur do të sëmureni dhe nuk mund të shëroheni lehtë ju e kërkonit mjekun, pranoni dhe i ndiqni këshillat e tij pa kundërshtim, përse? Sepse ai është i kualifikuar të japë këshilla medicinale, posedon përvojë, është përkujdesur dhe ka shëruar numër të caktuar të të sëmurëve. Sipas kësaj, ju u përmbaheni këshillave të tij, e bëni atë që ua propozon ai, dhe u largoheni krejt atyre gjërave që ua ndalon ai. Po ashtu në procesin gjyqësor ju keni besim në avokatin tuaj, dhe punoni sipas direktivave të tij. I njëjti rast është edhe me profesorin tuaj për sa i përket arsimit. Kur dëshironi të shkoni në ndojnë vend dhe nuk e dini rrugën, ju e pyetni dikë, i cili e di këtë rrugë, ndaj e ndiqni drejtimin, të cilin ua tregon ai. Shkurt, sa u përket gjërave që nuk i njihni është e logjikshme të pyetni atë që di, të pranoni këshillën e tij dhe të punoni në pajtim me të. Meqë dija juaj personale është e pamjaftueshme, ju me kujdes e kërkonit atë i cili është më mirë i udhëzuar, dhe përvetësoni fjalët e tij. Ju mundoheni të zgjedhni personin sa më kompetent: por kur e keni zgjedhur njëherë ju pranoni këshillat e tij pa diskutim. Ky lloj i të besuarit quhet “besim në të panjohurën”, sepse ju këtu i keni besuar dikujt i cili di për sendet, të cilat ju nuk i dini. Kjo më saktë është Iman bil gajb.

Iman bil gajb d.m. th. që ju të arrini dituri për atë që nuk e dini nëpërmjet dikujt që e di. Ju nuk njihni Zotin dhe cilësitë e vërteta të Tij. Ju nuk e dini se melekët e Tij, sipas urdhrat të Tij, komandojnë me mekanizmin e kozmosit dhe se ata juve ju rrethojnë nga të gjitha anët. Ju nuk e dini saktë si është mënyra e jetesës së përshtatshme me pëlqimin e Krijuesit: se dhe juve ju

mungon dituria për jetën e ardhshme. Dituria për këto gjëra ju është afruar nëpërmjet pejgamberëve, të cilët kanë qenë të lidhur drejtpërdrejt me Qenien e Zotit dhe të dhuruar me dituri të pakufishme. Ata janë të singertë, të ndershëm, të devotshëm, besnikë dhe jeta e tyre e pastër në përgjithësi është dëshmitar i parevokueshëm i fuqisë së fjalëve të tyre. Dhe mbi të gjitha këto, urtia dhe fuqia e mësimit të tyre ju detyron të pranoni se ata flasin të vërtetën, dhe krejt atë që ata ua mësojnë meriton të ndiqet dhe të besohet. Kjo bindje jonë është Iman bil gajb. Një qëndrim i tillë, i aftë që të pranojë të vërtetën (ajo është Iman bil gajb) është mjaft i rëndësishëm për nënshtrim ndaj Zotit dhe për veprim në pajtim me kënaqësinë e Tij, sepse ju nuk keni tjetër ndërmjetës, përveç Pejgamberit të Zotit që të arrini dituri të vërtetë, e pa të nuk mundeni assesi të ecni në rrugën e Islamit.

KAPITULLI III

PEJGAMBERLLËKU

Shqyrtimi ynë nxori në pah pikat që vijojnë:

a) Është e drejtë se njeriu jeton jetë të nënshtruar në Zotin e për atë absolutisht nevojitet dituri dhe fe; nevojitet të njohurit e Zotit dhe cilësive të Tij, të asaj që Ai e do dhe asaj që Ai nuk e do; Rrugës së Tij dhe Ditës së Gjykimit; ndërsa besimi i paluhatshëm në saktësinë e kësaj njohjeje është Imani.

b) Zoti nuk e la njeriun që të arrijë këtë njohuri vetëm me mundin e vet. Ai nuk e vuri njeriun para kësaj sprove të rëndë, por ia zbuloi këtë dituri. Duke u urdhëruar pejgamberëve të zgjedhur që ndërmjet njerëzve të transmetojnë dëshirën e Tij dhe t'ua tregojnë Krugën e Drejtë. Kjo e shpëtoi njeriun prej fatkeqësive të tmerrshme.

c) Së fundi, obligim i meshkujve dhe i femrave është ta pranojnë pejgamberin dhe pasi të jenë bindur se me të vërtetë është pejgamber i Zotit, të besojnë në të dhe në mësimet e tij, t'i nënshtrohen me vetëdije të plotë dhe të ecin pas hapave të tij. Ajo është rruga e shpëtimit.

Në këtë kapitull do të bëjmë fjalë për natyrën, historinë dhe llojet e tjera të pejgamberllëkut.

PEJGAMBERLLËKU: NATYRA DHE OBLIGIMET E TIJ

Mund të shihni se Zoti xh.sh. me mjaft simpati i ofroi njeriut krejt atë që i nevojitet në botë. Foshnja lindet me sy që të shohë, me veshë që të dëgjojë, me hundë që të nuhasë dhe të marrë frymë, me duar që të prekë, me këmbë që të ecë, me mendje që të mendojë. Të gjitha këto dhunti dhe potenciale janë të vendosura shkëlqyeshëm në trupin e saj të vogël. Të gjitha janë të parapara; asgjë nuk është harruar.

I njëjti rast është edhe në gjithësi ku ai jeton. Krejt çka është e nevojshme për jetën e tij i është dhënë në masë të plotë: ajri, drita, nxehësia, uji e kështu me radhë. Me të çelurit e syve foshnja gjen ushqimin në krahërorin e nënës. Prindërit e tij instinktivisht e duan, dhe në zemër është

mbjellur një instinkt mbrojtës, i cili i nxit që të kujdesen dhe të sakrifikojnë komoditetin e vet për fatin e tij. Ky fëmijë i mbrojtur kështu, mbërrinë pjekurinë dhe në çdo aktivitet të jetës së vet gjen në natyrë tërë atë që i nevojitet. I janë të dhëna të gjitha kushtet e të mbijetuarit dhe të rritjes dhe ai zbulon se e tërë gjithësia është në shërbim të tij dhe se i shërben në çdo moment.

Përveç asaj, njeriu ka mundësi të disponojë me të gjitha këto kapacitete dhe aftësi: fizike, shpirtërore, morale, të cilat i kërkon në luftën e tij për jetë. Këtu All-llahu xh.sh. ka bërë orar të përsosur. Ai nuk ua ka ndarë këto dhunti të gjithëve njëjloj. Sikur të vepronte kështu, atëherë njerëzit do të bëheshin plotësisht të pavarur njëri prej tjetrit, dhe ashtu do të shkatërrohej koncepti i bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë. Domethënë, edhe pse njerëzimi në përgjithësi posedon krejt atë çka duhet, prapëseprapë aftësitë ndërmjet njerëzve nuk janë të ndara njëjloj, por janë të kufizuara. Disa posedojnë fuqi të madhe fizike, të tjerët dallohen me aftësi intelektuale. Disa janë të bindur me prirje të madhe artistike, poetike, filozofike, të tjerët kanë aftësi oratorike, ose jetë strategu, aftësi për tregti, talent për matematikë, për kuriozitate shkencore, përvojë letrare, prirje për filozofi etj. Këto dhunti speciale e karakterizojnë çdo njeri dhe i mundësojnë të kuptojë specifikat, të cilat u mungojnë vdektarëve të rëndomtë. Këto njohuri, aftësi dhe talente janë dhunti të Zotit. Ato gjenden në natyrën e atyre, të cilët Zoti i ka caktuar të bëhen të dalluar. Këto dhunti kryesisht janë të lindura dhe nuk mund të arrihen vetëm me edukim dhe ushtrim.

Nëse mendohet për ndarjen e dhuntive të Zotit, do të zbulojmë se ajo ka përmbajtje të përsosur. Ato dhunti, të cilat janë të rëndësishme për ruajtjen e kulturës së përgjithshme njerëzore, i janë dhënë njeriut mesatar, ndërsa talentet e jashtëzakonshme, të cilat nevojiten në masë më të vogël, i janë dhënë një numri të vogël të njerëzve. Ekziston numër i madh i ushtarëve, fshatarëve,

zejtarëve, punëtorëve; por generalët, shkencëtarët, burrështetasit dhe intelektualët, relativisht janë në numër të vogël. I njëjti rast është me të gjitha profesionet. Rregulli i përgjithshëm si duket, do të ishte si vijon: Sa kapaciteti dhe gjenialiteti është më i madh, numër më i vogël i njerëzve e posedon atë. Gjenitë e mëdhenj, të cilët lënë vulë të pashlyer në historinë njerëzore, veprat e të cilëve me shekuj ia hapin rrugën njerëzimit, ende janë në numër të vogël.

Këtu parashtrohet qështja tjetër: njerëzimi a ka nevojë vetëm për ekspertë dhe specialistë në lëmin e drejtësisë, të politikës, shkencës, matematikës, teknikës, mekanikës, të financave, ekonomisë ose duhen edhe njerëz, të cilët mund t'ia tregojnë Rrugën e Drejtë - rrugën e Zotit, rrugën e shpëtimit? Ekspertët tjerë e njoftojnë njeriun me krejt atë që ekziston në gjithësi, si dhe për mjetet dhe metodat e shfrytëzimit të tyre. Pa dyshim, dikush duhet t'i shpjegojë njeriut qëllimin e krijimit dhe kuptimin e jetës, çka është njeriu, përse është krijuar, kush ia dha fuqinë dhe mjetet me të cilat disponon, dhe përse, cili është qëllimi i fundit i jetës dhe si arrihet ai, cilat janë vlerat e vërteta dhe si të arrijmë deri te ato. Ja çka është nevoja e klasës së parë për njeriun dhe nëse këtë nuk e di, asnjëherë nuk do të gjejë bazë të fortë e as që do të korrë sukses në këtë dhe në botën e ardhshme.

Logjika jonë mbështetet në besimin se Zoti, i cili çdo gjë ka paraparë për njeriun, deri në nevojat më të imëta të tij, ka lënë pas dore që të kujdeset për këtë nevojë më të madhe dhe më vitale. Jo, ajo asnjëherë nuk mund të jetë kështu. Dhe ajo nuk është ashtu. Zoti ka krijuar njerëz të dalluar në arte dhe në shkencë, por ai ka krijuar edhe njerëz me intuitë të thellë, me shikim të mprehtë dhe të aftë që të njohin dhe të kuptojnë. Ai vetë atyre ua zbuloi rrugën e devotshmërisë dhe të shkathësisë dhe ua besoi detyrën që t'ua transmetojnë të tjerëve Shpalljen e Zotit dhe t'ua tregojnë Rrugën e Drejtë. Këta njerëz janë Lajmërues, Pejgamberë të Zotit.

Në shoqërinë njerëzore Pejgamberët dallohen me aftësitë e tyre të posaçme, me kapacitetet e tyre të jashtëzakonshme dhe me prirjet e tyre natyrore. Gjeniu vetvetiu popullarizohet dhe automatikisht i bind të tjerët. P.sh. kur dëgjojmë poetin e vërtetë, menjëherë pranojmë gjenialitetin e tij jo të rëndomtë. Ata, të cilët nuk e posedojnë këtë dhunti në natyrën e tyre, nuk do ta arrijnë këtë karakteristikë, bile edhe nëse i përveshin tërë fuqitë e veta. I njëjti rast është edhe me oratorët, shkrimtarët, udhëheqësit dhe hulumtuesit e lindur. Çdo talent i tillë dallohet me fuqinë e tij dhe me rezultatet e jashtëzakonshme. Të tjerët nuk mund të barazohen me të. Ashtu është edhe me Pejgamberin. Logjika e tij i zgjidh problemet, të cilat janë të pazgjidhshme për logjikën e të tjerëve; ai flet dhe sqaron sendet për të cilat askush tjetër nuk mund të flasë; intuïta e tij sqaron pyetje aq të ndjeshme dhe të ndërlikuara saqë shumëkush tjetër, edhe pas mendimit shumëvjeçar nuk mund ta arrijë atë. Logjika aprovon krejt atë që tregon ai; zemra ndjen se ajo është e vërtetë; përvoja dhe vërejtja e dukurive në botë vërtetojnë saktësinë e fjalëve të tij. Megjithatë, nëse ne vetë provojmë që të bëjmë vepër të njëjtë ose të ngjashme, përrjetojmë vetëm mossakses. Natyra dhe planet e tij janë aq të mira dhe të pastra saqë qëndrimi i tij është gjithmonë i besueshëm, i sinqertë dhe fisnik. Nuk bën gjë të keqe e as që flet fjalë të këqija. Gjithmonë mbjell trimëri dhe atë që ua thotë të tjerëve e bën edhe vetë. Asnjë rast në jetën e tij nuk tregon se jeta e tij nuk është në pajtim me idealet e tij. As fjalët as veprat e tij nuk janë të diktuar prej interesit personal. Ai duron për të mirën e të tjerëve, e asnjëherë nuk lejon që të tjerët të vuajnë për të mirën e tij. E tërë jeta e tij është shembull i sinqeritetit, i natyrës së pastër, i mendimeve të jashtëzakonshme, i formës më të lartë të humanitetit. Karakteri i tij është i shkëlqyeshëm, ndërsa jeta e tij është pa të meta. Të gjitha këto fakte, të gjitha këto attribute vërtetojnë se ai është Pejgamber i Zotit, ndaj mund të besojmë në te.

Kur bëhet e njohur se ky person është Pejgamber i Zotit, është e logjikshme të dëgjohen fjalët e tij dhe të ndiqen udhëzimet e tij, të zbatohen urdhrat e tij. Do të ishte krejtësisht e palogjikshme që ta pranojmë një njeri si Pejgamber të Zotit, e pastaj të mos besojmë në atë që thotë ose mos të ndjekim atë që ai urdhëron; sepse vetë pranimi i këtij njeriu si Pejgamber i Zotit do të thotë se pranojmë që fjalët e tij vijnë prej Zotit, dhe se krejt çka punon ai është në pajtim me dëshirën dhe me kënaqësinë e Zotit xh.sh. Të mosnënshtruarit atij domethënë të mos i nënshtrohemi Zotit, kurse mosnënshtrimi ndaj Zotit shpie vetëm në shkatërrim. Prandaj, vetë pranimi i Pejgamberit ju obligon që t'u nënshtroheni urdhrave të tij dhe t'i pranoni pa kurrfarë kundërshtimi. Ndoshta ju nuk do të mund të kuptoni dobinë e këtij ose atij urdhri, por vetë fakti se urdhri vjen prej Pejgamberit është garanci e mjaftueshme e saktësisë së saj, prandaj aty nuk mund të ketë vend për dyshim. Nëse ju nuk e kuptoni atë, nuk do të thotë se ai ka gabuar, sepse të kuptuarit e njeriut të thjeshtë nuk është i përsosur. Ajo ka kufijtë e saj, të cilat nuk mund të injorohen. Është e qartë se ai, i cili nuk njeh thelbësisht ndonjë art, nuk mund të kuptojë hollësitë e tij, por do të ishte marrëzi sikur të refuzohej ajo që thotë eksperti, vetëm për atë se ne nuk e kuptojmë plotësisht. Duhet ta kemi afër mendjes se në të gjitha punët më kryesore në botë na nevojiten këshillat e ekspertëve, dhe kur i kthehemi atij, i kthehemi duke i treguar besim të plotë në këshillat e tij. Ju më shumë dëshironi të ndiqni këshillat e tij sesa të gjykoni vetë. Kur jeni të bindur se ai person është më i kualifikuar për problemin, i cili ju intereson juve, ju i mbron këshillat dhe udhëzimet e tij dhe e ndiqni atë. Nuk do të ishte aspak e arsyeshme sikur ta ndërprejmë në çdo moment dhe t'i themi: Më sqaroni këtë para se të shkoni më tutje. Kur ju e angazhoni avokatin në një proces gjyqësor, nuk përziheni në çdo procedurë të tij. Më e dobishme është të keni besim në të dhe t'i ndiqni këshillat e tij. Për mjekim e kërkon mjekun dhe u përmbaheni udhëzimeve të tij. Ju nuk do të përziheni në çështjet medicinale e as që do të provoni që me shkathtësinë tuaj logjike të

diskutoni me mjekun. Ky është qëndrimi që duhet të përvetësohet në jetë. Njësoj duhet të jetë edhe me religionin. Juve ju nevojitet dituri për Zotin dhe të gjeni mënyrën e jetës, e cila i pëlqen Atij, kurse ju nuk keni mjete që të arrini këtë dituri. Jeni të obliguar sipas kësaj të kërkonti Pejgamberin e vërtetë të Zotit, kërkesë së cilës duhet t'i kushtoni vëmendje, arsyetim dhe mendjemprehtësi të plotë, sepse nëse e zgjedhni ndonjërin, i cili nuk është pejgamber në të vërtetë, ai do t'ju shpie në rrugë të gabuar. Megjithatë, pasi të keni menduar në mënyrë të matur së fundi konkludoni se një person i caktuar është në të vërtetë Pejgamber i Zotit, atëherë duhet të keni besim të plotë në të, dhe besnikërisht t'u nënshtroheni të gjitha urdhrave të tij.

Tash është e qartë se Rruga e Drejtë është vetëm ajo për të cilën Pejgamberi pohon se vjen prej Zotit. Prej kësaj kuptohet lehtë se feja dhe nënshtrimi ndaj Pejgamberit absolutisht i nevojiten tërë botës dhe se njeriu, i cili refuzon udhëzimet e tij dhe provon që të trasojë rrugën e vet, është shmangur nga Rruga e Drejtë dhe sigurisht ka devijuar.

Në këtë gjë njerëzit janë fajtorë për devijimet e çuditshme. Disa pranojnë se Pejgamberi është i ndershëm dhe besnik, por nuk kanë iman (besim) në atë, e as që i ndjekin këshillat e tij në jetën e vet. Njerëzit e tillë nuk janë vetëm kafira, por edhe sillen në mënyrë të palogjikshme dhe jo të natyrshme; sepse nëse nuk e dëgjonin Pejgamberin pasi që e keni pranuar si të tillë, domethënë se vullnetarisht bëni devijim. A ka marri më të madhe?

Disa thonë: "Neve nuk na duhet pejgamber që të na udhëheqë, ne vetë mund të gjejmë rrugën e drejtë". Po ashtu ky qëndrim është i gabuar. Ju sigurisht keni mësuar gjeometrinë, dhe dini se në mes dy pikave mund të ketë vetëm një vijë të drejtë, ndërsa të tjerat janë ose të lakuara, ose nuk i prekin të dy pikat në të njëjtën kohë. Është e njëjtë me rrugën e drejtë, e cila në gjuhën e Islamit

quhet, Sirati-Mustekim (rruga e drejtë). Kjo rrugë fillon prej njeriut dhe shkon drejt kah Zoti dhe normalisht kjo rrugë mund të jetë një dhe vetëm një; të gjitha rrugët tjera janë të shtrembëta. Këtë rrugë e ka trasuar Pejgamberi dhe nuk ekziston e as që mund të ketë rrugë tjetër të drejtë, përveç kësaj. Njeriu, i cili injoron këtë rrugë dhe kërkon rrugë të tjera është viktimë e imagjinatës së vet personale. Ai zgjedh rrugën dhe mendon se është e vërtetë, por së shpejti humbet në kthesat dhe labirintet e përsiatjes së tij. Çka mendoni për personin, i cili ka devijuar dhe kur njeriu i mirë i tregon rrugën, plotësisht e kundërshton këshillën duke i thënë:”Unë nuk dua të ndjek udhëzimin tuaj e as që pranoj rrugën që ma treguat, por vetë do të endem nëpër këtë vend të panjohur dhe do të orvatem të mbërrijë deri në pikarritjen time në mënyrën time personale”. Kjo do të ishte me të vërtetë marrëzi, kur disponojmë me udhëzimet e qarta të Pejgamberit. Nëse secili mundohet të startojë prej zeros, do të ishte humbje e madhe e kohës dhe energjisë. Këtë nuk e bëjmë asnjëherë në lëmin e shkencës dhe artit; e përse ta bëjmë në lëmin e fesë?

Kjo është njimtim i rëndomtë dhe nëse pak mendojmë do të shohim se sa e gabueshme është ajo. Por nëse mendojmë më thellë për te, do të vërejmë se ai, i cili refuzon të besojë në Pejgamberin e vërtetë nuk do të zbulojë rrugën e vërtetë, e cila shpie drejt Zotit, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi. Kjo është kështu sepse ai i cili refuzon të ndjek këshillat e njeriut vërtetëdashës, me vetë atë përvetëson qëndrim ekstravagant, ashtu që horizontet e së vërtetës do të jenë të huaja për të dhe ai bëhet viktimë e kokëfortësisë, kryelartësisë, paragjytimeve dhe ekstravagancës së vet. Shpesh ky refuzim rrjedh prej egoizmit, prej konservatorizmit të verbër dhe dhënies së tepërt pas traditave të stërgjyshërve ose prej skllavërisë ndaj motiveve, të cilat nëse u nënshtrohemi udhëzimeve të Pejgamberit, është e pamundur t’i kënaqim. Nëse njeriu gjendet në kësaj gjendje, rruga e të vërtetës do të jetë e mbyllur për të. Ai nuk do të zbulojë kurrfarë rruge drejt shpëtimit.

Nga ana tjetër, nëse njeriu është i sinqertë, e don të vërtetën, dhe nëse nuk është rob i asnjërit prej komplekseve të lartpërmendura, para tij do të hapet rruga e realitetit ndaj ai nuk ka kurrfarë shkakut të mos pranojë fjalët e Pejgamberit. Përkundrazi, ai në mësimet e Pejgamberit zbulon jehonën e shpirtit të vet personal dhe duke e zbuluar Pejgamberin zbulon vetveten.

Dhe sipas krejt kësaj, Pejgamberin e vërtetë e ka vendosur vetë Zoti xh.sh. Ai e ka dërguar mesazhin e Tij t'ia transmetojë popullit. Zoti na ka urdhëruar të besojmë në Pejgamberin dhe ta ndjekim atë. Pra, ai i cili refuzon të besojë në të, në realitet nuk pranon urdhrat e Zotit dhe bëhet renegat. I pashmangshëm është fakti se ai, i cili nuk pranon pushtetin e përfaqësuesit të sunduesit, nuk pranon edhe vetë sunduesin. Ky mosnënshtrim e shndërron në kryengritës. All-llahu xh.sh. është Zot i gjithësisë, Sovran i vërtetë; Mbret i mbretërve, ndaj detyrë obliguese e çdo besimtari është të pranojë autoritetin e pejgamberëve të Tij dhe t'u nënshtrohet atyre, duke i konsideruar si pejgamberë të Tij. Ai, i cili kthen kryet prej Pejgamberit të Zotit sigurisht është kafir, pa marrë parasysh se a beson në Zotin apo jo.

HISTORIA E SHKURTËR E PEJGAMBERLLËKUT

Të shqyrtojmë tash historinë e pejgamberllëkut. Të shohim si kanë qenë hallkat e para të zinxhirit të dytë të pejgamberëve, i cili zgjatet deri në pejgamberllëkun e Pejgamberit të fundit Muhammedit (a.s.).

Gjinia njerëzore ka filluar prej një njeriu: Ademit. Duke filluar prej tij dhe gjenealogjisë se tij u rrit dhe u shtua familja njerëzore. Të gjithë njerëzit në këtë botë janë pasardhës të këtij çifti të parë (fillestar): Ademit dhe Havës. Historia e religjioneve pajtohet në këtë pikë. Hulumtimet shkencore për prejardhjen asnjëherë nuk kanë mund të tregojnë se në fillim janë paraqitur njerëz të ndryshëm, njëkohësisht ose në momente të ndryshme, në pjesë të ndryshme të tokës. Shumica e shkencëtarëve parafytyrojnë se së pari ka mund të ekzistojë njeriu i parë dhe se e tërë gjinia njerëzore ka mund të rrjedh mu prej këtij njeriu.

Ademi, njeriu i parë në tokë, po ashtu ishte peygamber i parë i Zotit në tokë. Zoti ia shpalli fenë, Islamin, dhe e udhëzoi që t'ua transmetojë pasardhësve të vet: T'i mësojë se All-llahu është Një, Krijues, Mirëmbajtës i botës; se është Sundues i gjithësisë dhe se vetëm Atë duhet ta adhurojmë, dhe vetëm Atij duhet t'i nënshtrohemi; se një ditë do t'i kthehem Atij; se vetëm prej Tij duhet të kërkojmë ndihmë, se duhet të jetojmë jetë të drejtë, të mirë dhe të devotshme në pajtim me kënaqësinë e Zotit. Nëse jetojmë ashtu do të jemi të bekuar dhe të shpërblyer prej Zotit, kurse nëse nisemi në rrugë të shtrembër, dhe nuk i nënshtrohemi Zotit do të jenë në humbje edhe në këtë edhe në botën tjetër dhe do të jemi të dënuar ashpër për këtë mosbesim dhe mosnënshttrim.

Ata pasardhës të Ademit, të cilët ishin të mirë, ndoqën rrugën e drejtë të cilën ai ua tregoi, kurse ata të cilët ishin të këqij i lanë pas dore udhëzimet e tij dhe u nisën rrugës së shtrembër. Disa filluan ta adhurojnë diellin, hënën, yjet, të tjerët adhuronin drunjtë, kafshët dhe lumenjtë. Disa besonin se ajri, uji, zjarri, shëndeti dhe krejt bamirësitë e fuqitë e natyrës ishin nën kontrollin e hyjnive të ndryshme dhe se të gjithë duhet t'i adhurojnë që të arrihet mëshira e tyre. Në këtë mënyrë injoranca krijonte forma të shumta të shirkut ose politeizmit dhe idhujtarisë si dhe numri i religjioneve shtoej. Kjo ishte periudha kur pasardhësit e Ademit u shpërndanë në masë të

madhe në rruzullin tokësor dhe u formuan raca dhe popuj të ndryshëm. Çdo popull arsimonte popullin e vet, me lutjet e veta personale. Zoti - i vetmi Sundues dhe Krijues i njerëzve dhe gjithësisë, plotësisht u harrua. Dhe jo vetëm kjo. Pasardhësit e Ademit e harruan edhe mënyrën e jetesës të cilën ua obligoi All-llahu xh.sh. dhe të cilën ua tregoi rendi i tyre. Ata ndiqnin prirjet e tyre personale. Kështu shtoheshin vetitë e këqija dhe idetë e gabuara. Njerëzit më nuk e dallonin të mirën prej të keqes; shumë gjëra të këqija konsideroheshin si të mira, kurse shumë gjëra të mira jo vetëm që janë injoruar, por janë konsideruar si të këqija.¹

Në këtë periudhë Zoti xh.sh. filloi të dërgojë në mesin e njerëzve peygamberë, të cilët e kanë predikuar Islamin. Secili prej tyre i tregonte popullit të vet për instruksionet, të cilat i kishin harruar. I mësonin të adhurojnë Zotin, të ndërprejnë idhujtarinë dhe shirkun (shoqërimin e zotave tjerë Zotit), të lirohen prej të gjitha traditave, të cilat rrjedhin prej injorancës, i propozonin mënyrën e jetës, e cila i pëlqen Zotit, dhe u jepnin dispozita të cilat do t'i përdornin në shoqëri.

¹ Ky koncepton i historisë së religjionit është diametralisht kundër të ashtuquajturit “koncepton evolucionist i religjionit”, i cili adhurimin e natyrës e konsideron si fazë të parë. Këta njerëz ndalen në adhurimin e manifestimeve të natyrës tek popujt e lashtë, adhurim i cili është vetëm formë e shtrembëruar e adhurimeve më të hershme, të cilat as që pranojnë t'i hulumtojnë. Studimet më të reja shkencore vërtetojnë idenë se Tevhidi (adhurimi i vetëm një Zoti) ishte forma më e vjetër e adhurimit dhe se krejt format tjera janë largime të mëvonshme nga ky religjion universal. Ata të cilët duan të depërtojnë më thellë në këtë lëndë, mund të kërkojnë veprën e njohur të profesor W. Schmidt “*The Origin and growth of Religions*” (Origjina dhe zhvillimi i religjioneve).

Pejgamberët e Zotit paraqiteshin në të gjitha vendet, në gjirin e të gjithë popujve. Të gjithë kanë predikuar fenë e njëjtë- Islamit.²

Pa dyshim, metodat e të mësuarit dhe dispozitat ligjore të pejgamberëve të ndryshëm janë dalluar sipas nevojës dhe nivelit të kulturës së popujve, të cilëve u ishin dërguar. Mësimet e posaçme të çdo pejgamberi ishin të kushtëzuara me llojin e së keqes me të cilën ballafaqoheshin ata dhe të cilat orvateshin që t'i çrrënjosnin. Metodatat e trajtësimit dalloheshin, që të mbrohen më mirë disa ide. Nëse populli ishte në fazën primitive të civilizimit dhe të zhvillimit të tij intelektual, ligjet dhe dispozitat e Pejgamberit ishin të thjeshta; ato ndërroheshin dhe përmirësoheshin me zhvillimin e shoqërisë. Megjithatë këto dallime ishin vetëm në shikim të parë dhe sipërfaqësore. Mësimet themelore të çdo religjioni ishin të njëjta: Besimi në njësinë e Zotit, lidhshmëria ndaj jetës së devotshme, morale dhe paqedashëse, besimi në jetën pas vdekjes, në sistemin e drejtë të dënimit dhe shpërblimit.

Qëndrimi i njeriut ndaj pejgamberëve të Zotit ishte mjaft i çuditshëm. Para së gjithash, ai i ka maltretuar dhe nuk ka dashtë që t'i dëgjojë dhe ndjekë instruksionet e tyre. Pejgamberë të caktuar ishin të persekutuar, të tjerët - të mbytyr; disa edhe pas indiferencës së popullit vazhdonin t'ua tërhiqnin vëmendjen gjatë tërë jetës, që të fitojnë vetëm disa ithtarë. Në mes pengesave të

² Ekziston të kuptuarit e gabueshëm, kryesisht në mes shkrimtarëve në Perëndim, se Islami prejardhjen e tij ia ka borxh Muhammedit (a.s.), kurse disa shkrimtarë e emërtojnë “themelues të Islamit”. Ajo është shtrembërim i së vërtetës. Islami ishte fe e të gjithë pejgamberëve të Zotit, dhe të gjithë kanë sjell të njëjtin mesazh. Pejgamberët nuk ishin themelues të Islamit: Ata kanë qenë vetëm besimtarë të tij. Islami është shpallje e Zotit e transmetuar njerëzve nëpërmjet pejgamberëve besnikë.

padurueshme, përqeshjeve dhe poshtëtimeve me të cilat gjithmonë ishin të rrethuar, këta peygamberë të Zotit prapëseprapë nuk largoheshin prej predikimit të tyre. Personaliteti i tyre i jashtëzakonshëm më në fund triumfoi; mësimi i tyre nuk mbeti pa efekt. Numër i madh i njerëzve dhe popujve pranorin mesazhin dhe idetë e tyre. Devijimet e grumbulluara me shekuj në formë të lajthitjeve, injorancës dhe veprat e këqija tash morën formë tjetër: derisa peygamberët ishin të gjallë, mësimi i tyre ishte i ndjekur dhe i pranuar, por pas vdekjes së tyre, popujt përsëri nxirrnin në shesh devijimet e tyre të vjetra në religjionet e tyre dhe ndërronin mësimet e Peygamberit. Ata përvetësonin forma të reja të adhurimit: disa adhuronin peygamberin e vet, duke e trajtuar atë si zot i inkarnuar, bile edhe si fëmijë i Zotit; disa i kanë identifikuar peygamberët me Zotin në Hyjninë e Tij; Shkurt qëndrimet e ndryshme, të cilat njeriu në këtë shikim i ka përvetësuar, ishin shtrembërime të logjikës së tyre dhe përqeshje e vetvetes; ai adhuronte si idhuj personat, detyrë e shenjtë e të cilëve ishte që t'i rrënojnë idhujt. Duke e përzier religjionin, traditat dhe lutjet e xhahilijetit, anekdotat dhe ligjet e rrejshme, të cilat ata vetë i kanë menduar, aq e ndërruan ideologjinë e Peygamberit dhe e çoroditën atë sa që ajo pas shumë shekujve është bërë përzierje e reales dhe fiktives dhe mësimet e peygamberëve janë humbur në ngatërresën e trillimeve dhe çorodive, kështu që ishte e pamundur të dalloheshin kokrrat prej bykut. Dhe të pakënaqur me falsifikimin e mësimet të Peygamberit, ata futën përralla të trilluara dhe përshkruan tradita të rrejshme prej jetës së peygamberëve të vet dhe ashtu e shtrembëruan biografinë e tyre sa që u bë e pamundur që të bëhet një përshkrim i saktë dhe i besueshëm i jetës së tyre. Edhe pas këtyre falsifikimeve, puna e Peygamberit nuk është krejtësisht e kotë. Në mes të të gjithë popujve edhe pas shtrembërimeve, mbetën disa gjurmë të së Vërtetës. Ideja mbi Zotin dhe jetën pas vdekjes, disa parime morale të vlefshme definitivisht janë pranuar në njërën ose në formën tjetër prej të gjithë popujve. Peygamberët d.m.th. e kanë përgatitur moralisht çdo popull që të pranojë

religionin universal - religionin i cili është në pajtim të plotë me natyrën e njeriut, e cila kyç krejt atë çka ka qenë e mirë në të gjithë fetë dhe shoqëritë e mëparshme, e cila përgjithësisht ka qenë e pranuar për tërë njerëzimin.

Siç thamë, në fillim paraqiteshin pejgamberë në çdo popull, ndaj mësimi i tyre ishte i dedikuar nergut për atë popull. Shkas për këtë ishte ajo sepse në këtë stad të historisë popujt kanë jetuar të ndarë dhe të izoluar njëri prej tjetrit, ashtu që secili ka mbetur i mbyllur në brendinë e kufijve të vet gjeografikë, ndaj mundësia për lidhje të huazuara as që ekzistonte. Në ato rrethana ishte mjaft vështirë të përhapej feja e përbashkët botërore me sistemin e saj ligjor dhe dispozitat për jetë në këtë botë. Përveç asaj, kushtet e përgjithshme të popujve të parë janë dalluar shumë në mes veti. Injoranca e tyre e pamatur prodhonte forma të ndryshme të lajthitjeve morale dhe shtrembërimeve fetare në mes popujve të ndryshëm. D.m.th. ishte e nevojshme që të paraqiten shumë pejgamberë që t'u predikojnë të vërtetën, që t'i nxjerrin në Rrugë të Zotit; që gradualisht të eliminojnë të keqen dhe devijimet, të çrrënjosin paditurinë, t'i mësojnë të përdorin parimet më fisnike të jetës së rëndomtë, të drejtë dhe të devotshme. Vetëm All-llahu xh.sh. e di sa mijë vjet kanë kaluar në këtë edukim të njeriut, që me këmbëngulje të përparojë moralisht dhe shpirtërisht. Në çdo rast, njeriu nuk ndalet në përparimin e tij, dhe më në fund erdhi koha kur e braktisi shkallën e fëmijërisë dhe hyri në periudhën e pjekurisë.

Me zvillimin dhe përhapjen e tregtisë, industrisë dhe artit, do të vendosen lidhje në mes popujve. Prej Kine dhe Japonie, vendeve të largëta të Evropës dhe të Afrikës hapen rrugë të rregullta tokësore dhe ujore. Shumë njerëz mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë, përhapet shkenca. Idetë dhe dituria fillojnë të transmetohen prej një vendi në vend tjetër. Paraqiten pushtues të mëdhenj, pushtimet e të cilëve shtrihen gjerë e gjatë, ata themelojnë perandori të mëdha, bashkojnë popuj

të ndryshëm nën një sistem politik. Duke u afruar kështu popujt mes veti njëkohësisht zhduken edhe dallimet në mes tyre.

Në këtë mënyrë u poqën kushtet që prej Zotit të shpallet një fe e vetme dedikuar njerëzve e cila paraqet mënyrë universale të jetës dhe i plotëson të gjitha nevojat e njerëzve: ato morale, shpirtërore, shoqërore, kulturore, politike, ekonomike, dhe e cila në të njëjtën kohë përmban edhe elemente fetare edhe elemente botërore. Më shumë se dy mijë vjet i duheshin gjinisë njerëzore që të arrijë aftësinë shpirtërore për religjionin e gjithanshëm. Budizmi, i cili përmban vetëm disa parime morale dhe i cili nuk është sistem i plotë i jetës, rrjedh prej Indie, është i përhapur në Japoni dhe në Mongoli në njërën anë, ndërsa në anën tjetër deri në Afganistan dhe Buharë. Misionarët e tij ecin nëpër tërë botën. Disa shekuj më vonë u paraqit Krishterimi. Edhe pse feja, të cilën e ka predikuar Isa a.s. ka qenë vetëm Islami, nxënësit dhe ithtarët e tij e shndërruan atë në një përzierje, e cila u quajt Krishterim, dhe ky religjion, dedikuar izraelitëve, u përhap deri në anët e largëta të Iranit dhe të Azisë së Vogël, si dhe të Evropës dhe të Afrikës. Këto kushte tregojnë qartë se në atë kohë u paraqitën kushtet për fe të përbashkët, dhe nevoja për te ishte aq e madhe saqë njerëzit në mungesën e fesë së vërtetë dhe të plotë, filluan të pranojnë religjione të cilat ekzistonin edhe pse ishin të pavërteta dhe jo të plota.

Në këtë fazë të vendosur të civilizimit, kur vetë shpirti i njeriut lakmonte pas një feje botërore, në Arabi u lind Pejgamberi për tërë botën dhe për tërë popujt. Feja, të cilën e kishte për detyrë ta përhapë, përsëri ishte Islami, por tash në formë të një sistemi të plotë, i cili përmbledhë të gjitha aspektet e jetës së njeriut. Ai u bë Pejgamber i tërë gjinisë njerëzore, ndërsa pejgamberllëku i tij shtrihet në tërë botën. Ai është Muhammedi, Pejgamber i Islamit (a.s.).

PEJGAMBERLLËKU I MUHAMMEDIT (A.S.)

Nëse hedhim një shikim në hartën e botës, do të shohim se asnjë vend në botë nuk është më i volitshëm se Arabia për këtë fe universale. Arabia është e vendosur në mes të Azisë dhe të Afrikës jo shumë larg Evropës. Në kohën e Muhammedit (a.s.), Evropa Jugore ishte e banuar me popuj të civilizuar dhe me kulturë të zhvilluar; kështu që këta popuj anembanë ishin në të njëjtën largësi prej Arabisë siç ishin popujt e Indisë. Kjo i dha Arabisë pozitën qendrore.

Nëse studioni historinë e kësaj epoke po ashtu do të shihni se asnjë popull nuk ishte më i përshtatshëm se arabët që të pranojë pejgamberllëkun.

Popujt e mëdhenj luftuan pamëshirshëm për t'u bërë të parët e botës, dhe në këtë luftë permanente dhe të gjatë, ata i shterën të gjitha burimet dhe fuqinë e tyre jetësore. Arabët ishin një popull i freskët dhe i vendosur. Përparimi i ashtuquajtur shoqëror krijoi shprehi të këqija tek popujt e zhvilluar, ndërsa në mesin e arabëve nuk ekzistonte kësajsoj organizate shoqërore. Sipas kësaj, ata ishin të lirë prej përtacisë, poshtërsisë dhe të metave, të cilat i lind luksi dhe ngopja shqisore. Arabët paganë të shekullit të shtatë, nuk ishin të okupuar me ndikimin e keq të sistemit shoqëror dhe të civilizimit artificial të popujve të mëdhenj të botës. Ata posedonin të gjitha cilësitë e mira të një populli, te i cili nuk kishte arritur “progresi shoqëror” i asaj kohe. Ishin të guximshëm, fisnikë, besnikë të fjalës së dhënë, liridashës, politikisht të pavarur, të lirë prej çfarëdo hegjemonie. Jetonin jetë të thjeshtë, duke mos njohur kurrfarë dëfrimi dhe shthurje morale. Pa dyshim, në jetën e tyre kishte edhe dukuri të caktuara të padëshiruara, të cilat do t'i përmendim më vonë, por shkas për ekzistimin e dukurive të tilla, ishte ajo se në mesin e tyre me mijëra vjet nuk ishte paraqitur pejgamber e as reformator që t'i civilizojë dhe t'i pastrojë moralisht. Jeta

shekullore e lirë dhe e pavarur në shkretëtirat rërore krijoi padituri të madhe në mesin e tyre. Do të thotë se u bënë aq të pashpirtë dhe këmbëngulur në injorancën e tyre saqë ishte e pamundur t'i humanizojë njeriu i rëndomtë. Por, në anën tjetër, nëse dikush i dhuruar me fuqi të jashtëzakonshme i thirrte që të përmirësohen dhe u jepte ideal fisnik dhe program të plotë, ata pranonin thirrjen e tij dhe me gjithë dëshirë punonin në arritjen e atij qëllimi, duke mos u sprapsur para kurrfarë sakrifice për atë gjë. Ata ishin të gatshëm pa aspak pikëllim t'i rezistojnë armiqësisë së tërë botës për punën e misionit të vet. Dhe me të vërtetë, ishte ai një popull i ri, me plot fuqi, guximtar, i cili kishte nevojë për përhapjen e mësimit të Pejgamberit universal, Muhammedit (a.s.).

Pastaj të shohim gjuhën arabe: sikur të studionit dhe sikur të depërtonit thellë në letërsinë e saj, ju do të bindeshit se nuk ka gjuhë më të përshtatshme që të shprehen ideale të larta, që të sqarohen problemet më delikate dhe më suptile të shkencës hyjnore, që të preket zemra e njeriut dhe të udhëzohet për dëgjimin e Zotit. Fjali të shkurtra mjaftojnë që të shprehin një sërë idealesh dhe njëkohësisht të lënë gjurmë të thellë në zemër, tingëllimi i thjeshtë i tyre nxit lotët në sytë tuaj dhe ju shpie deri në shkallën më të lartë të entuziazmit. Ajetet janë të ëmbla si mjalti, ashtu me një tingëllimë të ëmbël saqë çdo qime e trupit dridhet prej muzikalitetit të tyre. Kësisoj gjuhë e pasur ishte fort e nevojshme për Kur'anin, për fjalën e Zotit xh.sh.

Ajo ishte d.m.th. manifestimi i urtisë së madhe të Zotit, që Ai e zgjodhi Arabinë për vendlindje të Pejgamberit universal. Të shohim tash se sa ishte i veçantë dhe i jashtëzakonshëm personaliteti i bekuar, i zgjedhur prej All-llahut xh.sh. për këtë thirrje të Pejgamberit universal.

Nëse do të mund të mbyllim sytë dhe të hepo kemi në mendimet e botës para 1400 vjetëve, do të shihnim se ajo është botë krejtësisht tjetër nga kjo jona, botë e cila nuk përmban as ngjashmëri më të vogël me këtë kaos, i cili na rrethon sot neve. Rastet për këmbimin e ideve ishin të vogla, mjetet komunikative primitive dhe të pamjaftueshme, dituria njerëzore e ngushtë dhe e kufizuar në konceptimin e vet, e cila notonte në atmosferën e dyshimit dhe të ideve të marra dhe të shtrembëruara.

Sundonte errësira. Dituria e asaj kohe nuk ishte e mjaftueshme që të ndriçojë horizontin e logjikës njerëzore. Nuk kishte as radio as televizion, as telefon, as kinema.

Hekurudha, automobili dhe aeroplani as që vinin parasysh, ndërsa rendi i shtypit, ndërmarrjet botuese, ishin të panjohura, vetëm kopjuesit mundësonin që ky material letrar të përcillet prej një gjenerate në tjetrën. Shkollimi ishte luks i rezervuar vetëm për më të pasurit, ndërsa shkollat ishin shumë të rralla, horizonti i njeriut ishte i ngushtë, ndërsa idetë e tij mbi njerëzit dhe sendet ishin të kufizuara në rrethin e tij të kufizuar. Bile edhe dijetari i asaj kohë në shikim të caktuar ishte i shlyer prej diturisë, të cilën sot e posedon një njeri i rëndomtë. Edhe njeriu më i arsimuar ishte më pak i arsimuar nga njeriut ynë i thjeshtë.

Njerëzimi me të vërtetë ishte fundosur në padituri dhe dyshim. Drita e dobët e diturisë, e cila ekzistonte atëherë, iu dorëzua luftës më parë të humbur me errësirën e cila triumfoi rreth e përçark. Ajo që sot konsiderohet si arsimim i nivelit të thjeshtë, në atë kohë, edhe pas mësimit shumëvjeçar dhe mendimit të durueshëm vështirë arrihej. Njerëzit udhëtonin dhe e kalonin tërë jetën për të arritur dituri modeste, e cila sot është privilegj i të gjithëve. Sendet, të cilat sot i quajmë mite dhe të dyshimta, në atë kohë ishin të vërteta të paluhatshme. Veprat që sot i

konsiderojmë si të neveritshme dhe barbare, atëherë ishin krejtësisht normale. Metodrat e shëmtuara në të kuptuarit e sotëm të moralit, atëherë përbënin themelet e moralit dhe në atë kohë nuk mund të paramendohej se mund të ekzistojë mënyrë tjetër e jetës. Mosbesimi kishte marrë aso dimensione dhe aq përhapje sa që njerëzit e konsideronin si të lartësuar dhe fisnike vetëm atë që është e mbinatyrshme, jonormale, misterioze, bile edhe e pakuptimtë. Ata kishin arritur një kompleks të vlerës së ulët sa që nuk mundnin të paramendojnë se qenia njerëzore mund të posedojë shpirt hyjnor, ose që njeriu të jetë evlia.

ARABIA - GREMINË E ERRËSIRËS

Në këtë epokë të paarsimit, ishte një vend ku errësira ishte edhe më e dendur sesa në vendet tjera. Vendet fqinje, Persia, Bizanti, Egjipti, ishin më të civilizuara, por Arabia nuk ishte aspak në ndikimin e kulturës. Ajo ishte e izoluar me një det të madh ranor. Tregtarët arabë, të cilët shkonin në udhëtime të gjata shumëujore, tregtonin në këto vende, por në këto udhëtime nuk mundën të arrijnë as shkallën minimale të diturisë. Në vendin e tyre të lindjes nuk kishte shkollë, as bibliotekë, askush nuk interesohej për zhvillimin e shkencës. Individët e rrallë, të cilët dinin të shkruanin dhe të lexonin, nuk ishin të arsimuar sa duhet që të interesoheshin për shkencën dhe artin që ekzistonte. Ata në të vërtetë posedonin një gjuhë mjaft të zhvilluar, e cila ishte në gjendje që të shpreh edhe nuancat më të fshehta të mendimit të njerëzve, dhe shijen letrare të rendit të lartë, por studimi i literaturës tjetër të tyre tregon qartë, sa dituria e tyre ishte e kufizuar, sa standardi i kulturës dhe i civilizimit të tyre ishte i ulët, sa që mendja e tyre ishte e mbushur me

dyshim, sa barbare dhe të ashpra ishin mendimet dhe traditat e tyre, sa të çuditshme dhe të degraduara ishin konceptet dhe standardet e tyre morale.

Ai ishte vend pa pushtet. Çdo fis kërkonte sovranitet dhe trajtim të pavarur. Ekzistonte vetëm ligji i xhunglës. Plaçka, djegia, vrasja e të dobtëve dhe të pafajshëmve ishin praktikë e ditës. Jeta e njeriut, prona dhe nderi gjithmonë ishin të rrezikuara. Shumë fise jetonin me thika të mprehta. Incidenti më i vogël mjaftonte që të nxiste përleshje e cila shndërrohej në betejë të vrazhdë, ose ndonjëherë edhe në përleshje në nivel të vendit, e cila zgjaste me dekada. Beduini nuk parashihte nevojën të kursejë anëtarin e fisit tjetër, të cilin konsideronte se ka plot të drejtë që ta vrasë dhe ta plaçkisë.

Të gjitha konceptet e tyre për moralin, kulturën, civilizimin ishin primitive. Vështirë dallonin se ç'është e pastër e çka jo, ç'është ligjore e çka jo, ç'është njerëzore e çka është e panjerëzishme. Bënin jetë të vështirë, tradita barbare, kënaqeshin në amoralitet (zina), bixhoz dhe alkool. Plaçkitja dhe vjedhja ishin moto e tyre, vrasja dhe plaçkitja, shprehi e tyre. Pa kurrfarë turpi paraqiteshin haptaz të zhveshur saqë edhe gratë e tyre ishin të zhveshura duke u shëtitur rreth Qabes. Për shkak të kuptimit të keq të autoritetit, vajzat e tyre, për të mos pasur dhëndër, i varrosnin të gjalla. Pas vdekjes së babait, kurorëzoheshin me njerkat e veta. Nuk i dinin as elementet më themelore të ushqimit, të veshjes dhe të higjienës.

Sa i përket besimit të tyre i mundonin sëmundjet e njëjta, të cilat i preokuponin edhe popujt tjerë të botës. Adhuronin gurët, drunjtë, idhujt, fantazmat, shkurt, krejt çka njeriu mund të paramendojë, përveç All-llahut xh.sh. Nuk dinin asgjë për mësimet e pejgamberëve të mëparshëm. Me nebulozitet u kujtohej se Ibrahim i dhe Ismaili janë të parët e tyre, por praktikisht nuk dinin asgjë

për atë çka kanë predikuar ata, e as për Zotin, të cilin ata e kanë adhuruar. Rrëfimet për Adin dhe Themudin gjendeshin në folklorin e tyre, por nuk përmbanin kurrfarë gjurmësh për mësimet e Hudit dhe të Salihut. Hebrejtë dhe të krishterët u transmetonin rrëfime popullore legjendare, të cilat kishin të bëjnë me peygamberët hebrej. Ata paraqesin fotografi të mjerë të këtyre shpirtrave fisnikë. Mësimet e tyre ishin trillime të shtrembëruara, kurse jeta e tyre ishte e ngjyrosur me të zeze. Edhe sot mund të parafytyrojmë konceptet religjioze të këtyre njerëzve, vetëm nëse hedhim një shikim në israilijatet, të cilat i transmetojnë komentuesit muslimanë të Kur'anit. Fotografia, e cila aty është e prezentuar, për institucionin e peygamberllëkut dhe për karakterin e peygamberëve hebrej është në kundërshtim të plotë me atë që e kanë predikuar këta mbrojtës fisnikë të së vërtetës.

SHPËTIMTARI U LIND

Në atë kohë dhe në atë vend u lind një njeri. Prindërit i vdiqën në fëmijërinë e tij, kurse disa vjet më vonë edhe gjyshi. Domethënë se ai ishte i shlyer edhe prej asaj edukate të paktë, të cilën një fëmijë arab mund ta fitonte atëherë. Në fëmijëri ruan dhitë dhe dhentë me fëmijët tjerë beduinë. Kur rritet merret me tregti. Marrëdhënie pune ka vetëm me arabët. Plotësisht i pashkolluar dhe analfabet. Asnjëherë nuk pati rast të ulet në shoqërinë e njerëzve të ditur, pasi ata njerëz as që ekzistonin në Arabi. Pati raste që të dalë nga vendlindja e vet, por këto udhëtime kufizoheshin në Siri dhe ato ishin udhëtime tregtare të karvanëve arabë. Edhe nëse takonte njerëz të ditur, ose nëse kishte rast të vërejë forma të ndryshme të kulturës dhe të civilizimit, këto takime dhe këto

vërejtje ishin të rastësishme, të cilat nuk luajtën kurrfarë roli në formimin e personalitetit të tij. Sepse ndodhitë e këtilla nuk mund të kenë asnjëherë ndikim të thellë te ndonjëri që ai të lëshojë vendlindjen e vet e të arsimohet plotësisht dhe të ngrihet deri në atë nivel të origjinalitetit dhe të famës saqë mos të mbesë kurrfarë ngjashmërie në mes tij dhe shoqërisë prej së cilës rrjedh. E as që këto vëzhgime mund të jenë mjet për arritjen e asaj diturie të thellë dhe të pamatur, e cila mund të kthejë beduinin analfabet në udhëheqës, jo vetëm të vendit të vet por të tërë botës, bile edhe për tërë kohët e ardhshme. Sado i madh të ishte ndikimi kulturor dhe intelektual, i cili u mvishet udhëtimeve, mbetet fakti se ato assesi nuk kanë mundur që t'ia frymëzojnë këto koncepte dhe këto parime mbi moralin fetar, mbi kulturën dhe mbi civilizimin, të cilat në atë kohë nuk kanë ekzistuar askund në botë, e as që kanë mundur të krijojnë një model të përsosur dhe fisnik të karakterit njerëzor, i cili atëherë nuk mund të ndeshej në jetë.

GUR I ÇMUESHËM NË GRUMBULLIN E GURËVE

Të vëzhgojmë tash jetën dhe veprën e këtij njeriu të vlefshëm, jo vetëm në kontekstin e shoqërisë arabe, por të tërë botës së atëhershme.

Ky njeri dallohet krejtësisht prej njerëzve në mesin e të cilëve është i lindur dhe me të cilët kalon rininë dhe fazën e hershme të martesës.

Asnjëherë nuk ka gënjyer. Tërë vendi i tij kishte të njëjtën bindje dhe dëshmi se ishte i ndershëm dhe shpirtmirë. Bile edhe armiqtë më të mëdhenj të tij nuk e paditën se ka gënjyer ndonjëherë

gjatë jetës së vet. Ai flet njerëzisht dhe asnjëherë nuk ka përdorur fjalë fyese dhe të turpshme. Ai kishte personalitet sharmant dhe sjellje të mirë me të cilën e mbushte zemrën e atyre, të cilët vinin në kontakt me të. Në kontaktet e tij me njerëzit, ndjek parimet e drejtësisë. Me tregti është marrë gjatë, por asnjëherë nuk ka bërë ndonjë punë tregtare në mënyrë jo të ndershme. Ata, të cilët punonin me të, kishin besim të plotë në ndershmërinë e tij. Të gjithë e thirrin “El-Emin” (i sinqertë dhe i besueshëm). Bile edhe armiqtë e tij i linin sendet e çmueshme personale tek ai për sigurim, ndërsa ai u tregua i denjë ndaj besimit të tyre. Ai është simbol i pastërtisë në një shoqëri, e cila në thelb ishte e panjerëzishme. I lindur dhe i edukuar ndërmjet njerëzve, të cilët e konsideronin alkoolizmin dhe bixhozin si shkathtësi, asnjëherë nuk e ka provuar alkoolin, e as që ka luajtur bixhoz në jetën e tij. Populli i tij ishte i vrazhdë, i paarsimuar dhe i ndytë, por ai në veten e vet vëren kulturën më të lartë dhe shikimin më të mirë estetik. I rrethuar me njerëz të papërdëllimtë, ai ka zemër e cila është e pasur me butësi njerëzore. U ndihmon vejjshave dhe bonjakëve, si dhe sillet mirë ndaj udhëtarëve. Nuk i bën dëm askujt, por me gëzim duron për të tjerët. Duke jetuar me një popull për të cilin lufta ishte mjet për jetë, ai është aq liridashës sa që zemra i përgjaket kur sheh se i rrëmbejnë armët dhe vriten në mes vete. Ai rrin anash përleshjeve në fisin e vet, por gjithmonë këshillon paqe. I edukuar në fis idhujtar kishte shpirt aq të pastër sa që e dinte se asgjë, as në qiej as në tokë, nuk është e denjë që të adhurohet, përveç Zotit të Vetëm dhe të Vërtetë. Nuk përulet para asnjë krijese, nuk merr pjesë në kurrfarë kontributi për idhujt, madje as në fëmijërinë e vet. Instinktivisht urrenë çdo formë të adhurimit, që nuk ka të bëjë me Zotin. Shkurt, personaliteti i jashtëzakonshëm dhe brilant i këtij njeriu u paraqit në mes të një ambienti të errët, si kështjellë e dritës, e cila ndriçon plotësisht natën e errët, ose si gur i çmueshëm, i cili shkëlqen në grumbullin e gurëve.

REVOLUCIONI AFROHET

Pasi që e kaloi një pjesë të mirë të jetës së vet në mënyrë të ndershme, të pastër dhe të civilizuar, pason një kthesë në qenien e tij. Fillon të ndjejë lodhje prej errësirës dhe injorancës, të cilat e rrethojnë. Dëshiron t'u ikë këtyre greminave të çorodisë, amoralitetit, idhujtarisë dhe kaosit, të cilët e rrethonin nga të gjitha anët. Çdo gjë që e rrethonte e fyente shpirtin e tij. Tërhiqet në një kodrinë, larg prej zhurmës. I kalon ditët dhe netët në vetmi dhe në meditim të plotë. Agjëron që zemra dhe shpirti t'i bëhen edhe më të pastër dhe më fisnikë.

Ai mendon thellë. Kërkon dritën, e cila do t'i largojë errësitat. Dëshiron të vendosë themelet e një bote të re dhe më të mirë.

Ndryshim i rëndësishëm ndodh në te. Befas drita hyjnore ndriçon zemrën e tij dhe i jep forcë për të cilën lakmonte. Lëshon vetminë e shpellës dhe i kthehet popullit me këto fjalë:

Idhujt të cilët i adhuroni janë mashtrime të qarta, mos i adhuroni më. Asnjë qenie njerëzore, yjet, druri, guri, fantazma - nuk meriton të adhurohet. Mos i përulni kokat para tyre. E tërë gjithësia dhe krejt ajo që përmban i takon All-llahut të Gjithëfuqishëm. Vetëm Ai është Krijues i juaj, Furnizues i juaj, e sipas kësaj Sovran i juaj i vërtetë. Atij duhet t'i përuleni, t'i luteni dhe t'i nënshtroheni. Pra, vetëm Ate adhurone dhe vetëm urdhrat e Tij dëgjoni. Plaçkitja, vrasja, padrejtësia, mizoria, të gjitha të metat të cilat ju i keni, janë krime tek Zotit. Leni veprat tuaja të padrejta: Krejt atë Zoti e dënon. Flitni të vërtetën. Bëhuni të drejtë. Askë mos e vritni. Merrni vetëm pjesën, e cila ju takon. Ktheni huanë atyre, të cilëve ua keni marrë në mënyrë të drejtë, ju jeni qenie njerëzore e të gjitha qeniet njerëzore janë të njëjta tek Zoti. Askush nuk është i lindur

me shenjën e trupit ose të bujarisë në fytyrën e vet. Fisnik dhe i ndershëm është vetëm ai, i cili i frikësohet All-llahut, vetëm ai i cili është i devotshëm, i sinqertë në fjalët dhe në veprat e tij. Dallimet sipas lindjes, racës dhe klasës, nuk janë kritere të shkallës së madhështisë dhe nderit. Ai i cili i frikësohet All-llahut dhe punon vepra të mira është njeriu më fisnik. Ai i cili është i shlyer nga dashuria e All-llahut, i cili ka bërë vepra të këqija, ai është i mallkuar. Ekziston dita e saktë pas vdekjes tuaj, kur do të paraqiteni para Sunduesit tuaj. Do të thirreni të jepni llogari për punët tuaja, të mira ose të këqija, dhe asgjë nuk do të mund të fshehni. E tërë historia e jetës suaj do të jetë para Tij si libër i hapur. Fati juaj do të varet prej veprave tuaja, të mira ose të këqija. Para All-llahut të Gjithëfuqishëm nuk merret parasysh propozimi ose rekomandimi. Nuk mund ta korruptoni. Nuk do të jepni llogari për prejardhjen tuaj e as për pasardhësit tuaj. Vetëm feja e vërtetë dhe veprat e mira do të merren parasysh në atë kohë. Ai i cili i ka këto, do të banojë në xhennet, kurse atij të cilit do t'i mungojnë, do të hudhet në xhehennem.

Ky është mesazhi të cilin e sollti ai. Populli i paarsimuar u kthye kundër tij. Fyerjet dhe gurët hedheshin pas personalitetit të tij të lartësuar. Ai duroi të gjitha llojet e torturës dhe të mizorisë edhe atë jo një ditë e dy, por gjatë trembëdhjetë vjetësh. Më në fund braktisi vendlindjen. Por, edhe atëherë nuk e lanë të qetë. E shqetësohin në mënyra të ndryshme edhe atë nën kulmin e tij. E tërë Arabia u ngrit kundër tij. Ndiqej pandërprerë tetë vjet të plota e më tepër. Tërë këtë e duroi duke mos e ndryshuar qëndrimin e tij as për një grimë.

PËRSE TËRË KJO ARMIQËSI?

Njeriu pyet. Përse populli i tij u bë armik i përbetuar i tij? A mbështeteshin ata në ar, argjend ose në ndonjë pasuri tjetër botërore? A rrjedh e tërë kjo armiqësi për shkak të hakmarrjes së gjakut? A kishte kërkuar diçka ai prej tyre? Jo. E tërë kjo armiqësi bazohet në faktin se ai kërkoi që të adhurohet vetëm një Zot i vërtetë, të jetohet një jetë e drejtë, e devotshme dhe e mirë. Predikonte kundër idhujtarisë, gjykonte mënyrën e gabuar të jetës së tyre. Ai preu në rrënjë pushtetin e priftërisë (klerit). Gjykonte të gjitha dallimet, në bazë më të lartë ose më të ulët, në mes njerëzve, gjykonte paragjykimet racore dhe fisnore si injorancë e vërtetë; dhe dëshironte të ndërrojë tërë strukturën e shoqërisë, e cila datonte prej kohëve më të hershme. Bashkëqytetarët e tij i thanë se parimet e misionit të tij janë në kundërshtim me traditat e stërgjyshërve të tyre dhe kërkuan që t'u largohet ose përndryshe do të ketë pasoja të këqija.

Mund të imagjinojmë çështjen. Përse ai i duroi të gjitha këto vështirësi? Populli i tij i premtoi se do ta zgjedh për mbret të vetin dhe do t'ia dorëzojnë tërë pasurinë e vendit, nëse ai largohet prej thirrjes në fenë e tij dhe përhapjes së misionit të tij.

Por ai refuzoi të gjitha ofertat tërheqëse dhe në vend të asaj zgjodhi të vuajë për punën e vet. Përse? Çka do të fitonte ai nëse këta njerëz bëheshin të ndershëm dhe të devotshëm?

Përse ai nuk kujdesej për pasuri, luks, mbretëri, famë? A kërkoi ai të mira materiale aq të mëdha ashtu që këto propozime dukeshin të pavlefshme. A nuk ishin këto dobi aq tërheqëse që ai të zgjedhë të durojë zjarrin, shpatën, që me vjet të durojë qetë torturën e trupit dhe të shpirtit? Duhet të mendohet gjatë që të gjendet përgjigja.

A mund të paramendohet shembull më i lartë i vetësakrifikimit, ndjeshmërisë, bujarisë së zemrës ndaj të afërmeve të vet, se ky të cilin e ofroi ky njeri i cili flijoi fatin e vet personal për të mirën e të tjerëve, derisa këta njerëz të njëjtë e gjuajnë me gurë, e fyejnë, e ndjekin, dhe nuk e kursejnë as në ndjekjen e tij, por, ai pas tërë kësaj nuk pranon të ndërprejë luftën për mirëqenien e tyre?

Sikur të kishte besim të dobët, a do të mundte të durojë vuajtjet, për një gjë të rrejshme? A do të mund të tregonte këso qëndrueshmërie një plaçkitës ose një ëndërrues këmbëngulës, për idealin e vet, të mbetet i qetë dhe i vendosur para të gjitha rreziqeve dhe torturave, të cilat mund të paramendohen, atëherë kur i tërë një vend ngrihet me armë kundër tij? Kjo fe, kjo këmbëngulje, kjo vendosmëri me të cilat e udhëhiqte lëvizjen e tij deri në suksesin final, është d.m.th. argument i qartë i vërtetësisë së plotë të thirrjes së tij. Sikur të kishte edhe një gjurmë më të vogël të dyshimit, të pasigurisë në zemrën e vet, ai nuk do të mundej asnjëherë t'i bëjë ballë stuhisë, e cila bënte kërdi njëzet e një vjet me radhë.

Kjo është njëra anë e revolucionit i cili ngjante në te. Ana tjetër është ende më e mirë.

NJERIU I NDRYSHUAR NË MOSHËN DYZETVJEÇARE TË JETËS. PËRSE?

Ai jetoi dyzet vjet si arab në mesin e arabëve. Gjatë asaj kohe nuk ishte i njohur as si burrë shteti, as si predikues, e as si orator. Asnjëri nuk e kishte dëgjuar duke shprehur margaritarë të urtisë dhe të diturisë, siç do ta dëgjonin kur ai filloi t'i shprehë ato më vonë. Asnjëri nuk e kishte parë e

dëgjuar duke diskutuar për parimet e metafizikës, etikës, drejtësisë, ekonomisë dhe sociologjisë. Jo vetëm që nuk ishte gjeneral i madh, por nuk ishte as ushtar i rëndomtë. Asnjëherë nuk kishte lëshuar asnjë fjalë për Zotin, për melekët, për librat e shpallur, për pejgamberët e mëparshëm, për popujt e humbur, Ditën e gjykimit, jetën pas vdekjes, xhennetin dhe xhehennemin. E vërtetë është se posedonte karakter të jashtëzakonshëm dhe sjellje të përsosur, kishte kulturë të përsosur, por nuk kishte asgjë ashtu tërheqëse tek ai që të mund të pritej diçka e madhe dhe revolucionare prej tij në të ardhmen. Ishte i njohur në mesin e njohësve të tij si modest, i qetë, qytetar i përzemërt, si njeri i cili i përmbahet ligjit dhe i disponuar mirë. Kur u kthye prej shpellës, me mesazhin e ri, ai plotësisht ishte i ndryshuar.

Kur filloi të predikojë misionin e tij, e tërë Arabia ishte e shtangur dhe e habitur me fjalorin dhe shkathhtësinë e tij të përsosur oratorike. Ai kishte aq entuziazëm dhe ishte aq tërheqës sa që edhe armiqtë më të mëdhenj të tij frikësoheshin ta dëgjojnë, prej frikës që mos t'i prekë thellë në zemër, që mos t'i entuziazmojë, t'i lëshojnë besimet dhe kuptimet e tyre të vjetra. Ai ishte aq i pakrahasueshëm sa që asnjëri prej poetëve, predikuesve dhe oratorëve arabë të rangut më të lartë, nuk kishte krijuar diçka të njëjtë sipas bukurisë së gjuhës, diksionit madhështor kur ai i shtyri armiqtë e vet të bashkuar të krijojnë bile një ajet më të vogël të ngjashëm me atë që ai recitonte.

MESAZHI I TIJ UNIVERSAL

Përveç asaj, ai atëherë u paraqit para popullit të vet si filozof i vetëm, si reformator jo i rëndomtë, si modelues me renome i kulturës dhe civilizimit; politikan i famshëm, udhëheqës i madh, si gjykatës eminent dhe si gjeneral i pacenueshëm. Ky beduin analfabet, ky banor i shkretëtirës fliste aq me dituri dhe me urti saqë askush para tij nuk kishte folur kështu dhe askush pas tij nuk do të flasë më. Ai ekspozonte probleme të komplikuar metafizike e teologjike, ekspozonte gjykimin e tij për shkatërrimin e popujve dhe të perandorive, duke i bazuar tezat e veta në të dhënat historike të së kaluarës. Ai shqyrtonte veprat e reformatorëve të vjetër, vlerësonte religjionet e ndryshme të botës, jepte gjykim për konfliktet dhe përleshjet në mes popujve. Ai rregullonte dispozitat kulturore dhe etike. Formulonte ligje sociale dhe ekonomike, sjelljen e përgjithshme, marrëdhëniet ndërkombëtare aq urtë dhe aq mirë saqë mendimtarët e famshëm dhe shkencëtarët mund të tregojnë vleftën e tyre të vërtetë vetëm pas gjurmimit të gjatë dhe përvojës së madhe me njerëz. Bukuritë e këtij mesazhi zbulohen gradualisht në proporcion me përparimin e njeriut në dituritë teorike dhe në përvojën praktike.

Ky tregtar i qetë dhe paqedashës, i cili kurrë më parë nuk kishte marrë në dorë shpatën, nuk kishte ushtruar kurrë stërvitje ushtarake, vetëm njëherë kishte marrë pjesë në luftë, edhe atë si vëzhgues, u stërvit befas në ushtar aq të guximshëm saqë asnjëherë nuk dezertoj, bile edhe në betejat më të ashpra. Në kohën kur armët e luftës ishin primitive, ndërsa mjetet komunikative të kufizuara, u bë udhëheqës ushtarak aq i madh saqë për nëntë vjet e pushtoi tërë Arabinë. Mendjemprehtësia e tij, sukcesi, shpirti luftarak, të cilin e mbillte te njerëzit e tij dhe stërvitjet ushtarake, të cilat ia ofronte ushtrisë së larme arabe (armët e të cilëve nuk kanë vleftë as të

përmenden), bënin mrekulli aq të mëdha sa që për disa vjet i rrëzuan dy superfuqitë ushtarake të asaj kohe dhe u bënë sundues të pjesës më të madhe të botës së njohur në atë kohë.

Ky njeri i përmbajtur dhe i qetë, i cili dyzet vjet të plota asnjëherë nuk tregoi shenja të interesimit për aktivitete politike, paraqitet befas në skenën botërore si reformator i jashtëzakonshëm politik dhe burrë shtetas, i cili pa ndihmën e radios ose shtypit, i bashkoi banorët e shpërndarë të shkretëtirës në dy mijë kilometra katrorë, populli i cili ishte luftëdashës i paarsimuar, i padisiplinuar, i pashkolluar dhe i fundosur në luftëra fisnore të përgjakshme, u bashkua nën flamur, ligj, fe, kulturë, civilizim dhe formë sundimi të njëjtë.

Ai e ndërroi mënyrën e të menduarit të tyre, shprehitë dhe moralin e tyre. I arsimoi barbarët në njerëz të civilizuar, i arsimoi mizorët në njerëz të drejtë dhe të përgjigjshëm ndaj Zotit. Natyra e tyre jo e nënshtruar dhe krenare u kthye në nënshtrim dhe përgjigje ndaj ligjit dhe rendit. Populli, i cili nuk dha asnjë njeri të madh, të denjë këtij emri, me shekuj lind nën ndikimin e Muhammedit (a.s.), me mijëra shpirtra fisnikë, të cilët shkojnë në pjesët e largëta të botës të predikojnë dhe t'ua mësojnë të tjerëve parimet e fesë, të moralit dhe të civilizimit.

Muhammedi (a.s.) nuk e krijoi tërë këtë duke përdorur dinakëri, forcë e as tirani, por duke i falënderuar sjelljes së tij tërheqëse, personalitetit të tij të moralshëm dhe të mësuarit të tij të bindshëm. Me sjelljen e tij fisnike tërhoqi edhe simpatinë e armiqve të vet. Me prirjen e tij të çmuar dhe mirësinë natyrore i pushtoi zemrat e njerëzve. Sundoi drejtë. Asnjëherë nuk largohej prej të vërtetës dhe drejtësisë. Asnjërin nuk e ka torturuar, bile as armiqtë më të mëdhenj të tij, të cilët provonin që ta vrasin, të cilët e gjuajtën me gurë, të cilët e dëbuan prej vendlindjes, të cilët

nxitën tërë Arabinë kundër tij, e as ata të cilët e përtypën mëlçinë e mixhës së tij të vdekur në dalldinë e fortë për hakmarrje.

Të gjithë të mundurit i fali. Asnjërit nuk iu hakmuar për mizoritë e bëra ose për të padrejtat që i bënë ndaj tij.

Edhe pse ishte në krye të vendit të vet, ishte aq jovetjak dhe modest, ashtu që gjithmonë mbeti i thjeshtë dhe i kursyer në shprehinë e tij. Jetonte i matur si edhe më parë, në shtëpinë e tij modeste prej plitharëve. Flente në rrogoz, mbante veshje prej pëlhure të vrazhtë, hante atë që hante edhe i varfëri, ndërsa ndonjëherë mbetej edhe pa ushqim. Shpesh e kalonte tërë natën në namaz. U ndihmonte të varfërve dhe fatkeqëve.

Nuk ndihej aspak i fyer nëse punonte si punëtor fizik. Deri në momentin e fundit nuk kishte në të asnjë grimcë krenarie dhe madhërie, të cilën shpesh e kanë ata të cilët janë të pasur ose të cilët zënë pozita të larta. Si edhe çdo njeri, ulej dhe ecte me popullin, e ndante me te gëzimin dhe zemërimin. I huaji nuk do të mund ta njihnte lehtë të parin e shtetit në mes të ithtarëve të tij.

Edhe pse ishte në pozitë të lartë, sjellja e tij ndaj çdokujt ishte sjellje e rëndomtë e një njeriu të thjeshtë. Në të gjitha luftërat dhe fazat e jetës së vet, nuk kërkoi kurrfarë shpërblimi ose dobie për vete dhe nuk u la kurrfarë pasurie trashëgimtarëve të vet. Tërë këtë pasuri ia kushtoi Ummetit të vet (popullit të vet). Kërkonte prej ithtarëve të tij që mos të reservojnë asgjë për të dhe pasardhësit e tij, bile u ndaloi pasardhësve të vet pranimin e zeqatit, që ithtarët e tij mos t'ua ndajnë tërë zeqatin atyre.

KONTRIBUTI I TIJ PËR MENDIMIN NJERËZOR

Suksesi i këtij njeriu të përsosur nuk ndërpritet këtu. Që të tregojmë vlerën e tij të vërtetë, duhet të shqyrtojmë veprën e tij në tërësi, në kontekst të historisë botërore. Atëherë edhe më qartë shihet se ky banor analfabet i shkretëtirës arabe i lindur në kohën e errësirës, para më se një mijë e katërqind vjetëve ishte pionier i vërtetë i epokës moderne dhe njëri prej pishtarëve të njerëzimit. Ai është udhëheqës jo vetëm i atyre, të cilët e pranojnë autoritetin e tij, por edhe i atyre të cilët e mohojnë autoritetin e pejgamberllëkut të tij. I vetmi dallim është se këta të dytët nuk janë të vetëdijshëm për atë se direktivat e tij vazhdojnë të ndikojnë në mendimet dhe aksionet e tyre, dhe se ato janë udhëheqësit kryesorë të jetës së tyre dhe të vetë shpirtit të kohës moderne.

Arthur Leonardi shkruan: "Islami, në realitet realizoi një detyrë të madhe. La gjurmë të pashlyera në fletët e historisë dhe i cili plotësisht mund të vlerësohet vetëm gradualisht me zhvillimin e botës."

Dijetari John Davenport thekson: "Duhet të pranojmë se e tërë dituria përsa i përket fizikës, astronomisë, filozofisë, matematikës, e cila përhapej në Evropë, duke filluar prej shekullit të dhjetë, buron nga shkollat arabe, ndërsa saracenët e Spanjës mund të konsiderohen si etër të filozofisë evropiane". (cit. prej A. Karin në Islam's contribution to Science and Civilization).

Filozofi i famshëm anglez Bertrand Rasel shkruan: "Superioriteti i Orientit nuk është vetëm lufta. Shkenca, filozofia, poezia dhe arti lulëzonin në botën muslimane në kohën kur Evropa vuante në barbarizëm. Evropianët me zemërgushtësi të pafalur e quajnë këtë epokë "epoka e errësirës",

por vetë Evropa ishte në errësirë. Vetë Evropa e krishtere, sepse Spanja, e cila ishte muslimane, kishte kulturë brilante. Pakistan Quarterly, broshura IV numër 3.

Historiani i njohur Robert Brifaullt (Brifo) në librin e vet The Making of Humanity pranon se: "Është mjaftë e qartë se civilizimi evropian pa arabët nuk do të arrinte asnjëherë atë cilësi, e cila i lejoji të kalojë fazat e para të evolucionit. Edhe pse nuk ka asnjë aspekt të zhvillimit njerëzor në të cilin nuk është i dukshëm ndikimi i vendosur i kulturës islame, ajo kurrkund nuk është më e qartë dhe më e rëndësishme sesa në formimin (gjenezën) e këtij ndikimi, i cili përbën fuqinë karakteristike më të lartë të botës moderne dhe zgjidhjen më të madhe të fitimit të tij - shkencat natyrore dhe shpirtin shkencor. Atë që mund ta quajmë si shkencë rezulton në Evropë me një shpirt të ri të hulumtimit, me metoda të reja të shqyrtimit, eksperimentimit, të vërejturit, të maturit, zhvillimit të matematikës në formën, e cila ishte e panjohur për grekët. Ky shpirt dhe kjo metodë ishin të sjellura në Evropë nëpërmjet arabëve. Stanword Cobb, themelues i Progressive Education Association, shkruan: "Islami ka qenë themeluesi potencial i renesansës në Evropë". Citoi Robert L. Gullich në Muhammed the Educator.

Muhammedi a.s. kthen rrjedhën e mendimit njerëzor prej prirjes së saj në dyshim, mbinatyreshmëri dhe paqartësi, dhe e drejtoi në afrim racional, dashuri ndaj realitetit, dhe ndaj jetës së devotshme dhe të baraspeshuar në tokë. Ai ishte i cili, në një botë ku ndodhitë mbinatyrore ishin mrekulli të domosdoshme për argumentimin e së vërtetës së misionit fetar, mbolli dëshirën për argumentim racional dhe besim në te si në kriter të vetëm të vyeshtë të së vërtetës. Ai ua çeli sytë atyre që deri atëherë ishin mësuar të kërkojnë shenjat hyjnore në fenomenet natyrore. Ai ishte, i cili në vend të teorive të pabaza, udhëheq njerëzit në rrugën e të kuptuarit racional, rezonimit të shëndoshë në bazë të të vërejturit, të përvojës dhe të hulumtimit.

Ai definoi qartë kufijtë dhe funksionet e perceptimit shqisor, logjikës dhe intuitës. Ai tregoi qartë marrëdhëniet në mes shkathtësive materiale dhe shpirtërore, solli në pajtim fenë me shkencën dhe aksionet, me ndihmën e fesë krijoi shpirt shkencor dhe përpunoi ndjenjë të vërtetë fetare në bazë të shpirtit shkencor.

E çrrënjosi idhujtarinë, adhurimin e njeriut dhe politeizmin në të gjitha format dhe krijoi fe aq të fortë në Njësinë e Zotit sa që edhe ato religjione, të cilat ishin plotësisht të bazuara në dyshim dhe idhujtari, ishin të detyruara të përvetësojnë bazën monoteiste. Ndërroi themelet e koncepteve të moralit dhe shpirtësisë. Atyre të cilët besonin se vetëm asketizmi dhe vetëshkatërrimi përbëjnë kriteret e pastërtisë morale dhe shpirtërore, dhe se pastërtia mund të arrihet vetëm me të larguarit prej jetës së kësaj bote, duke mos i llogaritur nevojat fizike dhe duke e vënë trupin në të gjitha llojet e mundimit, ai ua tregoi rrugën e evolucionit shpirtëror, emancipimit moral dhe shpëtimit me pjesëmarrje aktive në punët praktike të botës që i rrethon.

Ai ia tregoi njeriut vlerën e tij të vërtetë dhe pozitën e tij. Atyre të cilët pranojnë vetëm inkarnimin e Zotit ose djalit të Zotit si udhëheqës shpirtërorë të tyre, ai u tregon se qeniet njerëzore siç janë ato, të cilat nuk lakmojnë që të jenë të adhuruar, mund të bëhen mëkëmbës të Zotit në Tokë. Atyre të cilët konsideronin për zota të vet, personat e fuqishëm, dhe si të tillë i adhuronin, ai u vë në dije se këta zota të rrejshëm janë qenie të rëndomta njerëzore dhe asgjë tjetër. Ai thekson se askush nuk mund të dëshirojë shenjtëri, pushtet dhe sovranitet, si e drejtë e cila i takon që prej lindjes dhe askush nuk është i lindur rob ose zotëri i paprekur. Ai dhe të mësuarit e tij inspiron mendimet për bashkimin e njerëzimit mbi barazinë e qenies njerëzore, demokracisë dhe lirisë së vërtetë në botë.

Nëse e lëmë anash këtë sferë të të menduarit, mund të vërejmë rezultate të panumërta praktike të udhëheqjes së këtij njeriu analfabet në ligje dhe në tradita. Numër i madh i parimeve të sjelljes së mirë, të kulturës dhe të civilizimit, pastërtisë së të menduarit dhe aksioneve, të cilat mbizotërojnë me botën e sotme, prejardhjen e tyre e kanë prej këtij njeriu. Ligjet shoqërore të cilat i dha ai, depërtuan thellë në strukturën e jetës shoqërore të njeriut, proces i cili vazhdon deri më sot. Parimet themelore të ekonomisë, të cilat i tregoi ai janë të inkuadruara në shumë aktivitete të historisë botërore, e sigurisht kështu do të ngjajë edhe në të ardhmen. Ligjet për udhëheqje, të cilat i themeloi ai ishin shkak për shumë kthesa në teoritë politike të botës, të cilat vazhdojnë të ndikojnë deri më sot. Parimet themelore të drejtësisë dhe të të drejtës, të cilat e mbajnë vulën e gjenialitetit të tij, ndikuan mjaft në administratën e drejtësisë të shumë popuj dhe formuan burim të përhershëm të udhëzimit për të gjithë njohësit e ligjeve në të ardhmen. Ky arab analfabet ishte i pari i cili ndërroi praktikisht tërë strukturën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe rregulloi ligjet e luftës dhe të paqes. Sepse para kësaj, nuk dinte se mund të ekzistojë ligji etik për luftën dhe se marrëdhëniet ndërkombëtare mund të jenë të rregulluara në bazë të humanitetit të bashkuar.

REVOLUCIONARI MË I MADH

Në defilenë e historisë botërore, figura madhështore e këtij njeriu të përsosur i tejkalon të gjithë njerëzit e mëdhenj të të gjitha kohëve, saqë të gjithë heronjtë nacionalë duken si shkurtabiqë në krahasim me Muhammedin (s.a.v.s.). Asnjëri prej tyre nuk kishte poseduar gjenialitet aq të aftë që të ndikojë në dy, tri, ose më shumë lëmi të jetës njerëzore. Disa janë teorikë brilantë, por nuk

kanë arritur që t'i zbatojnë idetë e tyre në praktikë. Të tjerët janë njerëz aktivë në praktikë, por u mungon dituria. Disa janë të famshëm vetëm si burrështetas, të tjerët si strategë. Disa ishin të koncentruar në një lloj të jetës shoqërore ashtu që i kanë lënë pas dore llojet tjera. Ka prej tyre, të cilët energjinë e tyre ia kanë kushtuar të vërtetave morale dhe shpirtërore, por e kanë injoruar ekonominë dhe politikën. Disa janë të zënë me politikën dhe ekonominë, por e lënë pas dore moralin dhe jetën shpirtërore. Shkurt, hasen heronj të cilët janë ekspertë vetëm në një degë të aktivitetit njerëzor. Ai është shembull i një personaliteti të vetëm në të cilin gjendeshin të gjitha shkathësitë së bashku. Ai është filozof dhe Pejgamber, dhe personifikim i gjallë i sjelljes së tij personale. Ai është burrështetas i madh dhe gjeni ushtarak. Ai është ligjdhënës dhe mësues i moralit. Ai është dritë shpirtërore dhe udhëheqës fetar. Vegimi i tij depërton në të gjitha aspektet e jetës dhe nuk ka asgjë në të cilën ka depërtuar e atë nuk e ka zbukuruar. Urdhrat dhe porositë e tij mbulojnë një fushë të gjerë: prej marrëdhënieve ndërkombëtare deri te traditat e jetës së përditshme siç janë: ushqimi, pija, higjiena. Në teoritë e tij, ai themeloi tërë civilizimin dhe kulturën, dhe vendosi aq baraspeshim të mirë në kontrastet jetësore saqë nuk mund të gjendet kurrfarë gabimi, mungesë ose e metë. A mund të përmendet ndonjë shembull tjetër i një personaliteti të këtillë të përsosur dhe të gjithanshëm?

Për shumicën e personave të famshëm botërorë thuhet se janë prodhim i mesit të vet, por rasti i tij është i vetëm. Rrethi i tij duket se nuk ka pasur kurrfarë ndikimi në formimin e personalitetit të tij. Historikisht nuk mund të vërtetohet se lindja e tij është e sinkronizuar me rendin e sendeve në Arabi në atë kohë. Më mirë që mund të thuhet është ajo se Arabia, në rrethanat në të cilat gjendej atëherë, kishte nevojë të domosdoshme për paraqitjen e një personi të tillë, i cili do t'i bashkonte fiset luftarake në një popull dhe do t'i vinte themelet e solidaritetit dhe të mirëqenies së tyre

ekonomike, duke i futur vendet tjera nën dominimin e tyre. Shkurt, udhëheqës nacional, i cili do t'i kishte të gjitha karakteristikat e një arabi të atëhershëm, dhe i cili duke i falënderuar mizorisë, persekutimit, gjakderdhjes, poshtërsisë, dyfytërsisë ose çfarëdo mjeti të mirë ose të keq, e ka pasuruar popullin e vet dhe mbretërinë ua ka lënë trashëgimtarëve të vet si trashëgim. Nuk mund të vërtetohet kurrfarë nevoje tjetër historike e Arabisë në atë kohë.

Në rastin më të mirë, ajo që mund të thuhet në dritën e filozofisë së Hegelit, ose historisë materialiste të Marksit është se koha dhe rrethi kërkojnë lindjen e udhëheqësit, i cili do të mund të krijojë një komb dhe të themelojë mbretëri. Mirëpo filozofia hegeliane dhe marksiste nuk mundën të sqarojnë se si rrethi i tillë ka mund të prodhojë njeriun, detyrë e të cilit ishte t'ua mësojë moralin më të bukur, të pastrojë njerëzimin prej çdo pandershmërie, të fshijë paragjykimet dhe besimet e kota prej ditëve të injorancës dhe errësirës, i cili nuk shikonte racën, nacionalitetin dhe vendin, i cili vuri themelet e rindërtimit moral, shpirtëror, kulturor dhe politik për mirëqenien e tërë botës, e jo vetëm të vendit të vet, të prodhojë njeriun, i cili edhe praktikisht, jo vetëm teoretikisht rregulloi punët tregtare, obligimet dhe të drejtat qytetare, politikën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në baza morale, dhe formoi sintezë, aq të baraspeshuar, në mes jetës shpirtërore dhe asaj trupore, sa që ajo edhe sot e kësaj dite konsiderohet vepër e lartë dhe e rrallë e artisë dhe largpamësisë, njëllë si edhe gjatë jetës së tij. A mund të emërtohet realisht personi i tillë si prodhim i errësirës së gjithmbarshme të Arabisë.

Ai jo vetëm që nuk u paraqit si prodhim i rrethit të tij, por nëse analizojmë misionin e tij, mund të përfundojmë se ai me të vërtetë i tejkalon kufijtë e kohës dhe të vendit. Të shikuarit e tij i mbizotëron pengesat kohore dhe fizike, i tejkalon shekujt dhe mileniumet dhe kaplon vetëqenien e aktivitetit njerëzor dhe të historisë.

Ai nuk është prej atyre, të cilët historia i hedh në harresë si dhe nuk është i lavdëruar vetëm pse ka qenë udhëheqës i madh në kohën e vet. Ai është i vetmi udhëheqës i paharruar i njerëzimit, bashkëkohor në çdo kohë. Me të vërtetë, të mësuarit e tij është aktual në çdo kohë.

Ata të cilët njerëzit i quajnë “ndërtues të historisë” janë vetëm “kreatorë të historisë”. Në realitet në tërë historinë botërore ai është i vetmi shembull i “ndërtuesit të vërtetë të historisë”. Nëse hollësisht shqyrtojmë kushtet historike në të cilat kanë jetuar personalitetet e mëdha, të cilët kanë bërë revolucione, do të shohim se në të gjitha rastet fuqitë e revolucionit janë bashkuar për një kryengritje të caktuar, janë orientuar në kahe të caktuar dhe kanë pritur rast të volitshëm për sulm. Duke e përgatitur këtë fuqi deri në çastin e volitshëm për sulm, udhëheqësi revolucionar luan rolin e artistit, për të cilin qysh më parë është paraparë skena dhe roli, e nga ana tjetër, prej të gjithë ndërtuesve të historisë dhe personaliteteve revolucionare të të gjitha kohëve, ai është i vetmi që e kishte të domosdoshme të gjejë mënyrën dhe mjetet që të mbledhë material për revolucionin ku do të prodhojë njerëz për të cilët kishte nevojë në planet e tij, sepse shpirti i vërtetë dhe simptomat e revolucionit nuk ekzistonin në popullin ku jetonte ai.

Me personalitetin e fuqishëm të tij ai la ndikim të pashlyer në zemrat e mijëra nxënësve të tij dhe i formoi ata sipas konceptit të vet. Me dëshirën e tij të hekurt përgatiti terrenin për revolucion, formuloi shenjat dhe strukturat e tij dhe udhëhiqte zhvillimin e ndodhive në kahen e dëshiruar. A mund të përmendet edhe ndonjë shembull i ndërtuesit të jashtëzakonshëm, revolucionar dhe ashtu i shkëlqyeshëm i historisë i njëjtë si ky?

DËSHMITË PËRFUNDIMTARE

Njeriu mund të mendojë për atë dhe të habitet, se si në atë periudhë të errësirës, para një mijë e katërqind vjetëve, në një rajon të paarsimuar siç ishte Arabia, një tregtar dhe një bari analfabet arab, arriti deri aty që të ketë dritë, dituri, fuqi, aftësi të tilla dhe shkathtësi morale aq të zhvilluara.

Mund të thuhet se nuk ka asgjë të çuditshme në mesazhin e tij. Ai është prodhim i shpirtit të tij personal. Nëse është ashtu, atëherë ai duhej të proklamohet si zot. E sikur të bënte ai në atë kohë diçka të tillë, njerëzit, të cilët nuk e panë për të madhe ta emërtojnë për zot Krishnën dhe Budën, si dhe Jezu Krishtin për djalë të Zotit, prej imagjinatës së pastër, dhe të cilët pa i brejtur aspak ndërgjegjja adhuruan fuqitë natyrore, zjarrin, ujin, erën, me gëzim do të pranonin një personalitet të tillë të çuditshëm, siç ishte Muhammedi (a.s), si zot-Sundues.

Por jo. Thënia e tij është e kundërt. Sepse ai thekson: “Unë jam njeri si edhe ju. Asgjë nuk kam sjellë me iniciativën time personale. Tërë këtë ma ka shpallur All-llahu xh.sh. Krejt çka posedoj unë i takon Atij. Ky mesazh, ekuivalentin e të cilit është në gjendje ta prodhojë i tërë njerëzimi - është mesazhi i All-llahut, ai nuk është prodhim i shpirtit tim. Çdo fjalë të tij ma frymëzoi All-llahu dhe e tërë fama i takon Atij. Krejt sukseset e jashtëzakonshme, të cilat flasin në dobinë time në sytë tuaj, të gjitha ligjet të cilat i dhashë, të gjitha parimet të cilat i kam theksuar dhe i kam treguar, asgjë nuk është prej meje. Unë do të isha plotësisht i paaftë që të prodhoj gjëra të këtilla vetëm me aftësitë e mia personale. Kërkoj udhëzimin e All-llahut në të gjitha punët. Krejt çka urdhëron All-llahu, unë vepro, krejt çka Ai ndalon, unë atë e shpalli.”

Çfarë shembulli i përsosur dhe i gjallë i sinqeritetit, i ndershmerisë, vërtetësisë dhe nderit. Rrenacaku ose hipokriti kryesisht mundohet t'ia përshkruaj vetes të gjitha miraditë për veprat e huaja, bile edhe atëherë kur gënjeshtrohet e atij që flet lehtë mund të vërtetohet. Por ky njeri i madh nuk i pëvetëson miraditë për këto trimëri, edhe atëherë kur askush nuk mund ta përshkruajë atë, pasi nuk është e mundur që të zbulojë burimin e inspirimit të tij.

A ekziston argument më i ndritshëm se sa saktësia e përsosur e qëllimeve të tij, se drejtësia e karakterit të tij dhe se shpirti madhështor i tij! Kush është më i sinqertë se ai, i cili ka pranuar dhunti të vetme të tilla në mënyrë sekrete, dhe i cili prapëseprapë zbulon burimin e çdo frymëzimi të tij. Të gjitha këto shkaqe e bëjnë të domosdoshme që të përfundojmë se një njeri i tillë ishte Pejgamber i vërtetë i All-llahut.

I tillë ishte Pejgamberi ynë, Muhammedi a.s. Ai ishte mrekulli e meritave të jashtëzakonshme, shembull i përsosurisë dhe i mirësisë, simbol i së vërtetës, Lajmëtar i madh i Zotit, Pejgamber i Tij në Tokë. Jeta dhe ideja e tij, sinqeriteti dhe devotshmëria e tij, mirësia dhe karakteri i tij, ideologjia e tij dhe veprat e tij, të gjitha këto janë argumente të pamposhtura të ligjshmërisë së pejgamberllëkut të tij. Çdo njeri i cili studion jetën dhe të mësuarit e tij, pa paragjykime, do të vërtetojë se ai në të vërtetë është Pejgamber i Zotit dhe se Kur'ani - është libër, të cilin ai ia dha njerëzimit - fjalë e vërtetë e Zotit. Çdo hulumtues serioz dhe i cili nuk anon (i realtë) nuk mund t'i ikë këtij përfundimi.

Përveç asaj, duhet të kuptojmë mirë se ne tash e njohim rrugën e drejtë të Islamit vetëm duke i falënderuar Muhammedit a.s.. Kur'ani dhe jeta shembullore e Muhammedit a.s. janë burimet e vetme të besueshme me të cilat disponon njerëzimi që ta njohë dëshirën e Zotit në tërësinë e saj.

Muhammedi a.s. është Pejgamber i Zotit dedikuar tërë njerëzimit dhe me të përfundon cikli (vargu) i gjatë i pejgamberëve. Ai është pejgamber i fundit, dhe krejt udhëzimet, të cilat All-llahu xh.sh. dëshironte t'ia dorëzojë njerëzimit, ishin të dërguara nëpërmjet Muhammedit a.s. dhe të inkuadruara në Kur'an dhe në Sunnet. Tash, ai i cili kërkon të vërtetën dhe dëshiron të bëhet musliman i ndershëm, ithtar i sinqertë i rrugës së All-llahut, duhet të besojë në Pejgamberin e fundit të Zotit, të pranojë të mësuarit e tij, dhe të ndjekë rrugën të cilën ai ia tregoi njeriut. Ajo është rruga e vërtetë e suksesit dhe e shpëtimit.

PËRFUNDIMI I PEJGAMBERLLËKUT

Kjo neve na sjell deri te çështja e përfundimit të pejgamberllëkut të cilën do ta shqyrtojmë tash.

Deri më tash folëm për natyrën e pejgamberllëkut, ndërsa ky diskutim do të sqarojë faktin se ardhja e Pejgamberit nuk është rast i çuditshëm. E as prania e tij personalisht nuk është e rëndësishme për çdo vend, për çdo popull, për çdo periudhë. Jeta dhe të mësuarit e pejgamberit janë fanarë, të cilët i drejojnë njerëzit në Rrugë të Drejtë, dhe derisa janë të gjalla direktivat dhe të mësuarit e tyre, po ashtu edhe ata janë në një mënyrë të gjallë. Vdekja e një pejgamberi të vërtetë nuk përmbahet në vdekjen e tij fizike, por në dobësimin e të mësuarit të tij dhe në interpolacionin (shtrembërimin e tekstit) e udhëzimit të tij. Pejgamberët e mëparshëm kanë vdekur sepse ithtarët e tyre i shtrembëruan mësimet e tyre, i futën udhëzimet e veta dhe e nxinë jetën e tyre shembullore duke shtuar aty ndodhi të trilluara. Asnjëri prej librave të mëparshëm - Tevrati,

Zeburi, Inxhili - nuk ekzistojnë sot në tekstin e tyre origjinal, saqë edhe ithtarët e këtyre librave pranojnë se nuk e posedojnë origjinalin. Biografitë e pejgamberëve të mëparshëm janë aq të përziera me trillime saqë e dhënë precize dhe e saktë për jetën e tyre është e pamundur të gjendet në to. Jeta e tyre është shndërruar në përralla dhe legjenda, e aty nuk mund askund të vërehet interpretimi i besueshëm. Jo vetëm që dokumentet janë të humbura dhe dispozitat e tyre të lëna pasdore, por as nuk mund të thuhet me saktësi se ku është i lindur pejgamberi i caktuar në fjalë dhe ku është rritur, si ka jetuar dhe çfarë ligji u ka ofruar njerëzve. Në realitet, vdekja e vërtetë e një pejgamberi është në vdekjen e të mësuarit të tij.

Duke i vlerësuar faktet sipas këtyre parametrave, askush nuk mund të mohojë se Muhammedi a.s. dhe të mësuarit e tij janë të gjalla. Mësimet e tij janë të pandryshueshme dhe të pandryshuara. Kur'ani - libri të cilin ai ia dha njerëzimit - ekziston në tekstin origjinal dhe në te nuk mungon asgjë.

I tërë përshkrimi i jetës së tij (fjalët e tij, këshillat dhe veprat) është ruajtur me saktësi të plotë, ashtu që edhe pse kanë kaluar katërmëdhjetë shekuj, plani i tij në histori është aq i qartë dhe komplet saqë na duket se e shohim me sytë tanë. Biografia e asnjë qenieje tjetër njerëzore nuk është e ruajtur aq mirë siç është ruajtur ajo e Muhammedit a.s. Në të gjitha fazat e jetës sonë, ne mund të kërkojmë udhëzimet e Muhammedit a.s. dhe të marrim mësim prej jetës së tij. Prandaj nuk ka nevojë për pejgamber tjetër pas Muhammedit, Pejgamberit të fundit (a.s.)

Ekzistojnë tre shkaqe, të cilat e bëjnë të nevojshme paraqitjen e pejgamberllëkut të ri; por ajo nuk do të thotë që të kompensohet pejgamberi i vdekur. Këta shembuj mund të theksohen shkurtimisht kështu:

- a) Mësimet e peygamberëve të mëparshëm janë të shtrembëruara ose të prishura ose kanë vdekur dhe të ngjallen. Në rastin e tillë paraqitet peygamberi i ri, ashtu që mund të pastrojë jetën mizore të njerëzve, dhe t'ia kthejë fesë formën dhe pastërtinë qenësore të saj.
- b) Të mësuarit e peygamberit të vdekur ka qenë jo i plotë, duhet të plotësohet, të përmirësohet ose të kompletohet. Atëherë dërgohet peygamber i ri që t'i kryejë këto ndryshime dhe këto plotësime.
- c) Peygamberi i mëparshëm është paraqitur apostafat për këtë apo atë popull ose territor, dhe peygamberi është i nevojshëm për një popull ose për një vend tjetër.

Mund të ketë edhe rast tjetër, ku peygamberi vjen t'i ndihmojë peygamberit tjetër - si Haruni Musait - Por pasi këta shembuj janë të rrallë, në Kur'an janë të dhënë dy shembuj të tillë, ky lloj i peygamberllëkut ka qenë përjashtim e jo rregull i përgjithshëm, prandaj këtë nuk e cekëm si rast i katërt.

Këto janë tre kushtet themelore të cilat janë shkak për paraqitjen e peygamberit të ri. Shqyrtimi me vërejtje të plotë i këtyre fakteve tregon se asnjë prej këtyre kushteve sot nuk ekziston. Të mësuarit e Peygamberit të fundit Muhammedit a.s. është ende i gjallë, plotësisht i ruajtur dhe i pavdekshëm. Udhëzimet dhe direktivat, të cilat ai ia dha njerëzimit, janë të kompletuara, të përsosura dhe të shkruara në Kur'an. Të gjitha burimet e Islamit janë shembullore dhe çdo aksion dhe instruksion i Peygamberit të Zotit mundet, pa kurrfarë dyshimi, të vërtetohet. Domethënë, meqë të mësuarit e tij është plotësisht pa të meta, nuk ka kurrfarë nevojë për peygamber të ri.

E dyta, direktivat, të cilat All-llahu i shpalli nëpërmjet Pejgamberit, Muhammedit (a.s.), janë në formë të plotësuar, dhe Islami është fe e kompletuar dhe universale. All-llahu ka thënë “Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë time, zgjodha për ju fe Islamin.” (Kur’ani, 5: 3) Me studimin e Islamit si mënyrë komplete e jetës vërtetohet saktësia e këtyre fjalëve të Kur’anit. Islami jep udhëzim për jetë në këtë dhe në botën tjetër, dhe asgjë prej asaj që është e rëndësishme për njeriun nuk është e lënë pasdore. Feja tash është e kompletuar dhe s’ka kurrfarë nevojë për pejgamberllëk të ri, që do të shprehte mungesat. Është thënë se koha, e cila ka kaluar, është shkas i mjaftueshëm për paraqitjen e udhëzimit të ri dhe se feja e cila është shpallur para katërmëdhjetë shekujve, patjetër është dashur të tejkalohet dhe të mos jetë e përshtatshme për nevojat e kohës së re. Ky kundërshtim është plotësisht i pabazë, dhe ja shkurtimisht pse:

- a. Mësimet Islamike janë të përhershme sepse i ka shpallur All-llahu xh.sh., i cili njuh të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, dhe i cili Vetë është i përhershëm. Dituria njerëzore është e kufizuar, syri i njeriut nuk sheh në errësirën e perspektivës së ardhshme, e jo Zoti, dituria e të cilit është mbi kufijtë e kohës dhe të vendit.
- b. Islami bazohet në natyrën njerëzore, kurse natyra e njeriut mbetet e njëjtë në të gjitha kohët dhe epokat. Të gjithë njerëzit rrjedhin prej të njëjtit model dhe natyra themelore e njeriut mbetet e pandryshuar.
- c. Në jetën e njeriut ekziston baraspeshim i përsosur në mes elementeve të qëndrueshmërisë dhe të ndryshimit. As s’është e përhershme çdo gjë e as s’është e ndryshueshme çdo gjë. Parimet themelore, shkathhtësitë bazore, nuk kërkojnë ndryshim. Format e jashtme ndërrohen me kohën, por duke i ruajtur disa baza të përhershme. Islami i plotësoi edhe nevojat e qëndrueshmërisë edhe

të ndryshimit. Kur'ani dhe Sunneti shprehin parimet e përhershme të Islamit, por ato me ndihmën e Ixhtihadit (zgjdhja e pyetjeve nga ana e një personi në bazë të burimeve të drejtësisë së sheriatit në Kur'an dhe Hadis duke mos iu përshtatur mendimeve të shkencëtarëve fetarë), mund të ndërrohen në çdo kohë sipas nevojave. Islami është fe e vetme, e cila themeloi mekanizmin për evolucionin e përhershëm të shoqërisë njerëzore në pajtueshmëri me parimet themelore dhe shkathtësitë e përhershme të jetës.

ç. Edhe njerëzit shkencorë jetojnë në kohën, e cila ka filluar me paraqitjen e njeriut në Tokë, dhe asnjë ndryshim themelor evolutiv nuk ka ndodhur në këtë fazë të jetës. Civilizimet janë zhvilluar dhe kanë vdekur, kulturat kanë lulëzuar dhe janë vyshkur, mbretëritë kanë mugulluar dhe janë zhdukur, por ne gjendemi në të njëjtën hallkë të zinxhirit të madh të evolucionit kozmik. Prandaj, mendimi se direktivat të cilat janë dhënë para disa shekujve me kalimin e kohës automatikisht janë bërë të vjetëruara, janë bërë sipërfaqësore dhe të pabaza.

Së fundi, mesazhi i Muhammedit a.s. nuk i është drejtuar një populli, një vendi ose një kohe. Ai është paraqitur si Pejgamber i së Vërtetës për tërë njerëzimin. Kur'ani e urdhëron Muhammedin a.s. të thotë se: Unë jam Pejgamber i Zotit për të gjithë juve. Ai është përshkruar si “mëshirë për të gjithë njerëzit e botës” dhe mesazhi i tij është universal. Prandaj pas tij nuk ka nevojë për pejgamberllëk të ri: së fundi ai në Kur'an është i quajtur Hatemun-Nebijjun, i fundit prej vargut të pejgamberëve të vërtetë. Kur'ani dhe Hadisi janë shumë kategorikë në këtë pyetje. Kur'ani thotë: “Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i Dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijshtëm për çdo send”. (Kur'ani,33:40) Pejgamberi i Zotit ka thënë: *“Nuk do të ketë pejgamber pas meje”*. Në një rast tjetër ka thënë: *“Raporti im në ciklin e gjatë të pejgamberëve mund të ilustrobet në krabasimin me një pallat. Pallati është i ndërtuar*

bukur. Çdo gjë në të është e kompletuar, përveç se në një vend mungon vetëm një tullë. Unë e kam mbushur atë vend dhe tash pallati është i kompletuar”. (Buhariu dhe Muslimi)

Tash domethënë, burim i vetëm i njohjes së Zotit dhe rrugës së shpëtimit është Muhammedi (a.s.) Ne mund ta njohim Islamin vetëm nëpërmjet mësimave të tij, të cilat janë aq komplete dhe universale saqë mund t'i udhëheqin njerëzit në të gjitha kohët e ardhme. Sot bota nuk ka nevojë për peygamber të ri, asaj i duhen vetëm njerëz, të cilët kanë besim të plotë në Muhammedin (a.s.), të cilët bëhen pishtarë të mesazhit të tij, e propagandojnë në tokë, dhe orvaten të vendosin kulturën të cilën Muhammedi a.s. ia dha njeriut. Botës i duhen njerëz me karakter, të cilët mund të përdorin shkencën e saj në praktikë dhe të themelojnë një shoqëri, e cila do të silltet sipas Ligjit Hyjnor, superioritetin e të cilit erdhi ta vërtetojë Muhammedi (a.s.). I tillë është misioni i Muhammedit a.s. dhe nga suksesi i tij varet suksesi i njeriut.

KAPITULLI IV

NENET E FESË

Para se të vazhdojmë, do të ishte mirë që në mënyrë koncize të përsërisim diskutimet e mëparshme dhe të rezymojmë esencën e tyre.

a) Islami është nënshtrueshmëri ndaj All-llahut, Sunduesit të gjithësisë. Por meqë mjet i vetëm i vërtetë për njohjen e Atij, dëshirës së Tij dhe ligjit të Tij është të mësuarit e Pejgamberit të vërtetë, Islami mund të definohet si religjion, i cili kërkon besim të plotë në të mësuarit e

Pejgamberit dhe nënshtrueshmëri permanente ndaj mënyrës së jetës së tij. Sipas kësaj ai, i cili e mohon ndërmjetësimin e Pejgamberit dhe thotë se e ndjek drejtpërdrejt Zotin, nuk është musliman.

b) Në epokat e mëparshme janë paraqitur pejgamberë të posaçëm për popuj të ndryshëm. Në atë kohë Islami ishte emri i religjionit të cilin popullit ia sqaronte pejgamberi i tyre personal ose më shumë pejgamberë. Pasi që natyra dhe qenia e Islamit ishin të njëjta, pa marrë parasysh kohën dhe vendin, mënyrën e adhurimit, dispozitat ligjore dhe rregullat e tjera në detaje si dhe dispozitat e jetës ishin pak më të ndryshme, në pajtim me kushtet lokale dhe të posaçme të çdo populli. Prandaj nuk ishte e nevojshme për një popull të ndjek pejgamberin e popullit tjetër si edhe përgjegjësia e tij kufizohej vetëm në atë që të ndjek udhëzimet e pejgamberit të vet personal.

c) Kjo periudhë e koekzistimit të më shumë pejgamberëve përfundon me paraqitjen e Muhammedit a.s. Me të është kompletuar të mësuarit e Islamit. Është formuluar ligji i vetëm themelor për tërë botën dhe ai u bë pejgamber i tërë njerëzimit. Pejgamberllëku i tij nuk i ishte dedikuar një populli, një vendi, ose një epoke të caktuar, mesazhi i tij ishte universal dhe i përhershëm. Dispozitat e mëparshme u evoluan me ardhjen e Muhammedit a.s. i cili i dha botës ligjin e kompletuar të jetës. Tashmë nuk ka pejgamber tjetër, ligj fetar tjetër, deri në Ditën e gjykimit. Të mësuarit e Muhammedit a.s. u është dedikuar të gjithë bijve të Ademit, tërë gjinisë njerëzore. Islami përmbahet në ndjekjen e Muhammedit a.s. që d.m.th. në pranimin e pejgamberllëkut të tij, në të besuarit e krejt asaj që ka kërkuar ai të besohet, në ndjekjen edhe me zemër edhe me shpirt dhe në nënshtrimin ndaj të gjitha urdhrave të tij si urdhra të Zotit. Ky është Islami.

Kjo neve automatikisht na drejton në pyetjen: Çka kërkoi që të lejohet Muhammedi a.s.? Cilat janë nenet e fesë Islame? Tash do të orvatemi t'i shqyrtojmë këto nene dhe të shohim sa të thjeshta, sa të vërteta, sa tërheqëse, sa të vlefshme dhe sa mund të ngrenë autoritetin e njeriut në këtë botë si dhe në botën tjetër.

TEVHIDI - BESIMI NË NJË ZOT

Të mësuarit më kryesor dhe më fundamental i Pejgamberit, Muhammedit a.s., është besimi në njëshmërinë e Zotit. Kjo është e shprehur në Kelimenë Themelore të Islamit: La ilahe il-l-allah: “Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut”. Kjo fjali e bukur është themel i Islamit dhe vetë qenia e tij. Të shprehurit e këtij besimi diferencon besimtarin e vërtetë prej kafirit (pabesimtarit), mushrikut (ai i cili i bashkangjet Zotit zota të tjerë) ose dehrrijut (ateistit). Të pranuarit apo të refuzuarit e kësaj fjalie bën dallim të madh ndërmjet një njeriu dhe njeriut tjetër. Ata, të cilët besojnë në të formojnë një bashkësi të vetme, kurse ata të cilët nuk pranojnë, formojnë grupin e kundërt. Besimtarët do të përparojnë në rrugën e suksesit në këtë dhe në botën tjetër, ndërsa mossuksesit dhe pandershmëria do të jenë fat përfundimtar i atyre që refuzuan të besojnë.

Por dallimi i cili ndodh ndërmjet besimtarit dhe jobesimtarit nuk është vetëm rezultat i shqiptimit të disa fjalëve të caktuara. Është afër mendjes se vetëm shqiptimi i një ose dy fjalive nuk mund të shkaktojë dallim kaq të madh. Fuqia e vërtetë qëndron në pranimin e vetëdijshëm të kësaj thënieje dhe në lidhshmërinë e plotë ndaj urdhrave të saj në jetën praktike. Nëse ju nuk e dini

domethënien e vërtetë të fjalëve “Nuk ka Zot tjetër, përveç All-llahut” dhe gradën, të cilën me pranimin e saj arrinë njeriu në jetën e vet, ju nuk mund të kuptoni domethënien e vërtetë të kësaj thënieje. Ajo mund të jetë efi kase vetëm nëse këto parime praktikohen. Vetëm të përsëriturit e fjalës “ushqim” nuk mund të heq urinë; vetëm të përsëriturit e recetës mjekësore nuk mund të shërojnë sëmundjen. Po ashtu nëse kelimeja përsëritet pa e kuptuar domethënien dhe porositë e saja, ajo nuk mund të bëjë rikthimin e pritur. Rrikthim në mentalitetin dhe jetën e një personi mund të bëhet vetëm nëse ai kupton konceptin e plotë të thënies, nëse kupton çka don të thotë ajo, nëse singerisht beson në te dhe nëse pranon dhe ndjek atë edhe me fjalë edhe me punë. Nëse kjo lëmi e Kelimesë nuk është sendërtuar, ajo nuk ka kurrfarë efekti të vërtetë. Ne i frikësohemi zjarrit pasi e dimë se djeg; i largohemi helmit sepse e dimë se është vdekjeprurës. Në të njëjtën mënyrë nëse ne e përvetësojmë plotësisht konceptin e thellë të Tevhidit, nevojitet patjetër t’i largohemi, si në mendimet tona ashtu edhe në sjelljen tonë, çdo nuance të mosbesimit, ateizmit dhe politeizmit. Kjo është porosia e besimit në njësinë e Zotit.

DOMETHËNIA E KELIMESË

Në gjuhën arabe fjala “ilah” d.m.th. “ai i cili adhurohet”, që na jep të kuptojmë se bëhet fjalë për qenien, e cila për shkak të madhësisë dhe fuqisë është e denjë që të adhurohet, e denjë që para saj të përkulemi në shenjë respekti dhe nënshtrimi. Çdo krijesë ose qenie e dhuruar me fuqi tepër të madhe quhet po ashtu “ilah”. Koncepti “ilah” kyç, pra, të poseduarit e fuqisë së pakufizuar; fuqisë e cila mund t’i frikësojë të tjerët. Ai po ashtu përmban kuptimin se të tjerët janë të varur

prej Allahit, kurse ai nuk është i varur prej askujt. Fjala “ilah” posedon edhe kuptimin e sekretit ose misterit (fshehtësisë); ilah është qenie e padukshme dhe e paperceptuar. Fjala Huda në persisht, Deva në indisht, Dieux në frëngjisht, God në anglisht, Gott në gjermanisht ka përafërsisht të njëjtin kuptim. Gjuhët tjera të botës kanë po ashtu një fjalë e cila ka kuptim të ngjashëm.

Fjala All-llah, në anën tjetër është emri personal i Zotit. La ilahe il-l-all-llah, tekstualisht do të thotë: “Nuk ka ilah tjetër, përveç Qenies Superiore të njohur nën emrin All-llah”. Kjo domethënë që në tërë gjithësinë nuk ka qenie absolute e denjë të adhurohet, përveç All-llahut, që vetëm para tij duhet të përkulim kokën në shenjë adhurimi dhe nënshtrimi. Ai është qenie e vetme, e cila posedon tërë fuqinë, të gjithë njerëzve u nevojitet mëshira e Tij, dhe të gjithë janë të obliguar të kërkojmë ndihmën e Tij. Ai mbetet i fshehtë prej shqisave tona dhe logjika jonë nuk arrinë që të vërejë Realitetin e Tij.

Pasi që sqaruam kuptimin e këtyre fjalëve, të zbulojmë tash domethënien e tyre të vërtetë.

Sipas asaj që dimë prej historisë njerëzore prej kohëve më të lashta, si dhe sipas mbeturinave më të vjetra të civilizimit antik, duket se njeriu ka pranuar dhe ka adhuruar një ose më shumë zota në çdo kohë. Bile edhe në kohën e tashme, çdo popull në tokë prej më primitivit deri në më të civilizuarit beson dhe adhuron ndonjë hyjni (zot). Kjo vërteton se koncepti Zot dhe adhurimi i Tij është thellë i rrënjosur në natyrën e njerëzve. Ka diçka në shpirtin e njeriut, e cila e detyron që të veprojë ashtu.

Atëherë mund të parashtrohet pyetja: Ç’është kjo ide dhe pse ndihet i detyruar të bëjë ashtu? Ne ndoshta mundemi të përgjigjemi në këtë pyetje nëse provojmë të shohim pozitën e njeriut në këtë gjithësi gjigante. Analizimi i njeriut dhe natyrës së tij nga kjo fushatë tregon se ai nuk është i

gjithëfuqishëm. Ai nuk është i mjaftueshëm për veten e vet, dhe nuk ekziston nga vetvetiu, e as që fuqia e tij është e pakufizuar. Në realitet, ai është krijesë e dobët, e butë dhe e ndjeshme. Jeta e tij varet prej shumë fuqive pa ndihmën e të cilave ai nuk mund të përparojë. Ekzistojnë gjëra të panumërta, të cilat janë të nevojshme për mirëmbajtjen e jetës së tij, por të cilat nuk janë plotësisht nën fuqinë e tij. Ndonjëherë ato arrijnë në pronën e tij në mënyrë të thjeshtë dhe të natyrshme, kurse ndonjëherë tjetër janë të shlyera nga ajo. Ka shumë gjëra të rëndësishme, të cilat ai tenton t'i arrijë, por disa herë korrë sukses e disa herë nuk korrë sukses në të, sepse nuk është plotësisht në fuqinë e tij që t'i fitojë. Ekzistojnë shumë gjëra, të cilat janë të dëmshme për te: fatkeqësitë vetëm për një moment mund të shkatërrojnë veprën jetësore të tij ose krejt shpresat e tij; sëmundja, brenga dhe fatkeqësitë gjithmonë i kanosen dhe e pengojnë ecjen e tij drejt fatit. Ai mundohet t'u ikë, por asnjëherë nuk është i sigurt se do të korrë sukses në të. Ekzistojnë shumë gjëra madhësisë dhe përsosurisë së të cilave i shpreh respektim: kodrat dhe lumenjtë, kafshët e mëdha dhe kafshët e egra. Ai duron tërmetet, stuhitë dhe fatkeqësitë tjera natyrore. Vëren retë mbi kokën e vet dhe shikon se si ato mblidhen dhe errësohen, me oshëtimën e bubullimës, rrufesë dhe prishjes së mjegullave. Shikon Diellin, Hënën, yjet në lëvizjen e pandërprerë të tyre. Sheh se sa të mëdhenj dhe të fuqishëm janë këta trupa qiellorë dhe në krahasim me ta sa i dobët dhe i pavlefshëm është ai! Fenomenet natyrore, nga njëra anë, dhe vetëdija mbi kalueshmërinë e tij personale në anën tjetër, bëjnë që të kuptojë pamundësinë e vet, pozitën modeste të tij. Dhe krejtësisht është normale se ideja themelore e Hyjnisë përputhet me këtë ndjenjë. Ai mendon për atë, i cili i zbut këto fuqi të mëdha. Ideja mbi madhësinë e tyre bën që me përlulesi të ulë kokën, parafytyrimi për fuqinë e tyre bën që të kërkojë ndihmën e tyre. Ai mundohet t'i ikë hidhërimit të tyre që mos të shkatërrohet.

Në fazën fillestare të paditurisë njeriu mendon se elementet natyrore, madhësia dhe ndriçimi i të cilave shihet, dhe të cilat duken aty dashamirë aty armiq, në vete posedojnë fuqi dhe pushtet të vërtetë dhe sipas kësaj janë të natyrës hyjnore. Ashtu ai adhuron drunjtë, kafshët, lumenjtë, malet, zjarrin, shiun, ajrin, trupat qiellorë dhe shumë sende tjera. Kjo është forma më e keqe e injorancës.

Kur padituria e tij fillon të humbet, ai kupton se këto elemente madhështore dhe impulsive për vetvete janë të pamundshme, dhe nuk janë të autorizuar për pozitë në raport me njeriun, por i janë të nënshtruara atij. Kafsha më e madhe dhe më e fortë vdes si edhe mikrobi i imët dhe humbë tërë fuqinë e saj; niveli i lumenjve të mëdhenj mund të ngrihet dhe të lëshohet; por ato mund edhe të thahen. Vetë njeriu mund të hapë tunele nëpër kodrat e mëdha dhe të rrëzojë majet e tyre. Produktiviteti i tokës nuk varet vetëm prej asaj; uji e bën të plleshme - të thatit e bën të paplleshme. Vetë uji nuk është i pavarur; ai varet prej erës, e cila i shtyn retë. Vetë era është e pafuqishme dhe dobia e saj varet prej shkaqeve tjera.

Hëna, Dielli, yjet po ashtu u janë të nënshtruara ligjeve të forta në kufijtë e të cilave ato nuk kanë kurrfarë pavarësie. Pas këtyre analizave, mendja e tij atëherë vëren mundësinë e ndonjë fuqie të madhe të fshehtë të natyrës hyjnore, e cila kontrollon sendet, të cilat ai i sheh dhe të cilat mund të jenë arkë e çdo pushteti. Këto meditime shkaktojnë besimin në fuqitë e fshehta në anën tjetër të dukurive natyrore, të zotave të panumërt për të cilët parafytyrohet se udhëheqin në lëmenj të ndryshëm të natyrës, siç janë era, drita, uji... Njeriu konstrukton forma ose simbole materiale të paramenduara, të cilat i paraqesin ato dhe fillon t'i adhurojë këto forma dhe simbole. Kjo është po ashtu një formë e paditurisë; realiteti mbetet ende i fshehtë ndaj syrit të njeriut, bile edhe në këtë fazë intelektuale dhe kulturore.

Në qoftë se njeriu përparon në shkencë dhe sa më thellë mediton mbi problemet themelore të jetës dhe të ekzistimit, ai zbulon ligjin e gjithëfuqishëm dhe kontrollin e gjithanshëm në gjithësi. Çfarë saktësie të përsosur mund të shohim në lindjen dhe perëndimin e diellit, në erërat dhe shiun, në lëvizjen e yjeve dhe rendin e stinëve të vitit! Me çfarë harmonie punojnë bashkarisht fuqi të panumërta, dhe me çfarë ligji të urtë dhe efikas janë të harmonizuara ato që të veprojnë bashkë në një kohë të caktuar, për një rezultat të caktuar! Duke e vërejtur këtë uniformitet, këtë saktësi dhe këtë përrulje të plotë ndaj ligjit të pandryshueshëm në të gjithë lëmenjtë e natyrës, vetë politeisti është i detyruar të besojë se patjetër duhet të ekzistojë një hyjni më e madhe se krejt të tjerat, e cila mban pushtetin suprem. Sepse sikur të kishte zota të pavarur dhe të posaçëm, atëherë kjo makineri e gjithësisë do të ishte çrregulluar. Njeriu e emërton këtë hyjni më të madhe me emra të ndryshëm siç janë: All-llah, Parmeshvar, God, Dieux, Huda, Hudaigan, Zot, etj. Por derisa ekzistojnë errësitat e paditurisë ai vazhdon të adhurojë hyjnitë më të vogla bashkë me Hyjninë Supreme. Ai mendon se mbretëria e Zotit nuk duhet të dallohet prej mbretërisë tokësore. Ashtu si mbreti tokësor ka ministra, njerëz të besueshëm, mëkëmbës dhe oficerë përgjegjës, ashtu edhe hyjnitë më të vogla janë përgjegjëse nën pushtetin e Zotit të gjithëfuqishëm, të cilit mund t'i afrohet vetëm nëse arrihet mëshira e oficerëve të dëgjueshëm ndaj tij. Ashtu edhe ata patjetër duhet të adhurohen dhe të thirren në ndihmë, assesi nuk duhet të nënçmohen. Domethënë ata konsiderohen si përfaqësues, me ndihmën e të cilëve mund të arrihet deri te Zoti i Gjithëfuqishëm.

Njeriu sa më shumë shton diturinë aq më e madhe bëhet pakënaqësia e tij ndaj hyjnive të shumta. Ashtu numri i zotave të vogël fillon të zvogëlohet. Njerëzit e arsimuar analizojnë sistematikisht këta zota dhe zbulojnë se asnjëri prej këtyre zotave, të cilët i ka menduar njeriu nuk kanë karakter

hyjnor; Ata janë krijesa si edhe njeriu dhe njëlloj të pafuqishëm. Kanë filluar të lihen dhe të refuzohen një nga një derisa nuk ka mbetur vetëm një Zot. Por koncepti i një Zoti ende përmban gjurmët e elementeve të padituriisë. Disa mendojnë se Ai ka trup si edhe njerëzit dhe se jeton në një vend të caktuar. Të dytët mendojnë se Zoti ka zbritur në tokë në formë të njeriut; të tretët mendojnë se Zoti pasi rregulloi gjithësinë është tërhequr dhe tash pushon. Disa thonë se duhet t'i afrohem Zotit nëpërmjet të të shenjtëve dhe fantazmave si dhe kurrfarë veprë nuk mund të sjellë rezultate pa angazhimin e tyre. Disa mendojnë se Zoti ka formë dhe fotografi të caktuar dhe e konsiderojnë të nevojshme të prodhohen fotografi, të cilat i adhurojnë ata. Këto koncepte të shtrembëruara të hyjnisë ekzistojnë edhe sot e kësaj dite dhe ende pranohen prej popujve të ndryshëm.

Tevhidi është koncepti më i lartë i Hyjnisë. Ligjin për këtë All-llahu xh.sh. ua dërgoi njerëzve në të gjitha kohët nëpërmjet pejgamberëve të vet. Ky kuptim ishte i futur në kokën e Ademit në fillim kur u dërgua në tokë. I njëjti kuptim i është shpallur Nuhit, Ibrahimit, Musait dhe Isait (Qoftë i kënaqur All-llahu me të gjithë). Të njëjtin koncept ia solli njerëzimit Muhammedi a.s. Kjo është dituri e pastër dhe absolute pa kurrfarë gjurme të padituriisë. Njeriu bëhet fajtor për shirkun, kufrin, idhujtarinë, vetëm pse është larguar prej të mësuarit të Pejgamberit dhe është bërë i varur prej paragjyqimit të vet personal të gabuar mbi kuptimet dhe sqarimet e rrejshme. Tevhidi i shpërndanë të gjitha retë e padituriisë dhe ndriçon horizontin me dritën e realitetit. Të shohim çfarë realiteti të rëndësishëm sjell ky koncept i Tevhidit - kjo fjali e shkurtër: “La ilahe il-lall-llah”. Ne atë do ta kuptojmë nëse mendojmë për pikat që vijojnë.

Para së gjithash jeni të ballafaquar me pyetjen e gjithësisë, jeni të ballafaquar me gjithësinë e madhe dhe të pafund. Mendja e njeriut nuk arrinë të njohë fillimin e saj e as që të parafytyrojë

fundin e saj. Ajo lëviz nëpër shtegun e caktuar që moti, dhe vazhdon udhëtimin e saj me perspektiva të pamatura në ardhmëri. Krijesa të panumërta janë të paraqitura në te dhe vazhdojnë të paraqiten çdo ditë. Dukuritë natyrore aq të hutojnë saqë mendja e njeriut mbetet e habitur dhe e mahnitur. Njeriu është i paafte të kuptojë realitetin me të pamurit e tij aq të kufizuar. Ai nuk mund të besojë se krejt ajo është paraqitur rastësisht thjeshtë. Gjithësia nuk është masë aksidentale e materies. Ajo nuk është përzierje e sendeve të paharmonizuara. Ajo nuk është grumbull i sendeve të çrregulluara dhe të pakuptimta. E tërë kjo nuk mund të jetë pa Krijues, Arkitekt, Drejtor. Por kush ka mund të krijojë dhe të dretojë këtë gjithësi madhështore? Këtë mund ta bëjë vetëm Ai, i cili është Sunduesi i Gjithçkaje; i cili është i pafund dhe i përherëshëm; i cili është i gjithëfuqishëm, i cili di gjithçka, i cili sheh gjithçka. Ai duhet të ketë pushtet suprem mbi krejt atë çka ekziston në gjithësi, të posedojë fuqi të pafund, të jetë Sundues i gjithësisë dhe i krejt asaj që gjendet në te, duke mos pasur kurrfarë mungese ose papërsosurie. Askush nuk ka fuqi të ndërmjetësojë në Veprën e Tij. Vetëm Qenia e tillë mund të jetë Krijues, Sundues dhe Drejtor i gjithësisë.

E dyta, është e rëndësishme që krejt këto cilësi të Zotit patjetër duhet të bashkohen në një Qenie. Është e pamundur të mendohet se ekzistojnë njëkohësisht dy ose më shumë persona, të cilët kanëtribute dhe fuqi të njëjta. Ata gjithsesi do të përleshën. Sipas kësaj, mund të ekzistojë vetëm një Qenie Supreme e vetme, e cila ka kontroll mbi të gjithë të tjerët. Nuk mund të paramendohen dy udhëheqës për të njëjtën provincë ose dy komandantë kryesorë për një armatë. Po ashtu është e pamundshme të paramendohet ndarja e këtyre kapaciteteve ndërmjet zotave të ndryshëm: p.sh. njëri është i gjithëdijshëm, i dyti - jep gjithçka, i treti - është burim i jetës; që secili ka fushë të pavarur në fushatën e tij. Gjithësia është tërësi e pandarë, e atëherë çdonjëri prej këtyre zotave do

të ishte i varur nga një tjetër në kryerjen e detyrës së tij; do të shihej qartë mungesa e harmonizimit dhe në atë rast bota do të ishte e gjykuar në shkatërrim. Këtotribute hyjnore janë të patransferueshme. Është e pamundur që një cilësi e caktuar t'i takojë njerit ose tjetrit në një moment të caktuar, e pastaj në momentin tjetër t'i takojë zotit tjetër. Qenia hyjnore, e cila nuk është e aftë që vetë të mbetet gjallë, nuk mund t'i japë jetë tjetrit. Ai i cili nuk mund të mbrojë pushtetin e vet hyjnor, është plotësisht i paaftë të udhëheq me gjithësinë e pakufishme.

Pra, sa më shumë mendoni për këtë problem, aq më shumë jeni të bindur se krejt këtotribute hyjnore mund t'i takojnë vetëm një Qenieje të Vetme. Sipas asaj, politeizmi është formë e paditurisë, dhe nuk mund të durojë analizën e mbështetur në logjikë. Kjo është pamundësi praktike. Faktet natyrore dhe jetësore nuk pajtohen me këtë sqarim. Ato automatikisht sjellin njeriun deri te Realiteti, që d.m.th. deri te Tevhidi (Njëshmëria e Zotit).

Duke pasur parasysh këtë konceptcion të plotë dhe të vërtetë të Zotit, hedhjani tash një shikim analizues kësaj gjithësie të madhe. Përpiquni me të gjitha mundësitë tuaja që të shqyrtoni këtë problem dhe tregoni se a keni gjetur në mes të krejt sendeve, të cilat i shihni, në mes të krejt sendeve të cilat i vëreni, në mes krejt atyre që mund t'i paramendoni, ndjeni, parafytyroni - tërë atë që vetëdija juaj mund ta arrijë - dikë, i cili i posedon këto cilësi? Dielli, Hëna, yjet, kafshët, shpezët, peshqit, materia, të hollat, ndonjë njeri ose grup i njerëzve, a i posedon ndonjëri prej këtyre këto cilësi? Sigurisht jo, askush! Sepse çdo gjë në gjithësi është e krijuar, e kontrolluar, e rregulluar, e varur mes veti, e vdekshme dhe e kalueshme. Asgjë nuk është vetëvepruese, vetëlëvizëse; edhe lëvizja më e vogël është e kontrolluar me ligjin e papërkulshëm dhe nuk mund të shmanget prej atij ligji. Një pamundësi e qartë e tillë e të gjitha sendeve argumenton se veshja e hyjnisë nuk është e përshtatshme për trupin e tyre. Ata nuk posedojnë as gjurmën më të vogël të

Hyjnisë dhe nuk kanë kurrfarë lidhjesh me të. Ata janë të shlyer prej fuqisë hyjnore dhe t'u përshkruhet atyre pozita hyjnore është shtrembërim i së vërtetës dhe marrri e shkallës më të lartë. Kjo është domethënie e La ilahe, që d.m.th. “nuk ka zota”; asnjë person e as send nuk posedon fuqinë hyjnore dhe pushtet, i cili meriton adhurim dhe nënshtrim.

Por kjo nuk është fundi i hulumtimit tonë. Zbuluam se Zoti nuk pushon në asnjë element material ose njerëzor të gjithësisë dhe se asnjëri prej tyre nuk posedon bile gjurmën më të vogël të tij. Ky shqyrtim na sjell deri në përfundimin se Ekziston Qenie Supreme mbi çdo gjë që sytë tanë të dobët shohin në gjithësi, e cila posedon attribute hyjnore, që është Dëshirë, mbi të gjitha fenomenet, Krijues i kësaj gjithësie grandioze, Kontrollues i Ligjit të Tij të përsosur, Udhëheqës i të gjitha punëve: Ajo qenie është All-llahu “Zoti i gjithësisë” dhe nuk ka tjetër në Hyjninë e Tij. Kjo d.m.th. il-lall-llah.

Kjo dituri është më superiore se çdo lloj tjetër i diturisë, dhe sa më shumë që të përpiqeni aq më e thellë do të jetë bindja juaj se ajo është pikënisje e çdo diturie. Në çdo lëmi të hulumtimit, qoftë ajo fizika, kimia, astronomia, gjeologjia, ekonomia, politika, sociologjia ose filologjia, ju do të vëreni, sesa më shumë e studioni pyetjen, aq më të qarta bëhen shenjat e së vërtetës La ilahe il-lall-llah. Ky koncepton hap degët e hulumtit dhe edukimit, dhe shndritë rrugët e diturisë me dritë të realitetit. Dhe nëse e mohoni këtë realitet ose nëse silleni indiferent ndaj atij, ju do të jeni të pezmatuar në çdo hap, sepse mohimi i kësaj të vërtete elementare të çdo gjëje në gjithësi ia shkëput domethënien e saj reale dhe kuptimin e vërtetë. Gjithësia atëherë bëhet e pakuptimtë, kurse perspektivat e përparimit të paqarta.

NDIKIMI I TEVHIDIT NË JETËN E NJERIUT

Të shqyrtojmë tash efektet, të cilat i shkakton besimi në La ilahe il-lall-llah në jetën e njeriut dhe të shohim pse ai do të ketë sukses çdoherë në jetë e pse ai i cili nuk pranon këtë besim do të përjetojë humbje edhe në këtë botë edhe në botën tjetër.

a) Ai që beson në këtë Kelime nuk ka paragjykime e as që është zemërngushtë. Ai beson në Zotin, i cili është Krijues i qiejve dhe i tokës, Zot i Lindjes dhe i Perëndimit, dhe Furnizues i tërë gjithësisë. Në bazë të këtij besimi ai nuk konsideron asgjë në botë si të huaj ndaj tij. Çdo gjë në gjithësi ai e sheh si pronë të Zotëriut të cilit edhe ai i takon. Nuk është i anueshëm as në mendimet as në veprat e tij. Simpatia e tij, dashuria e tij dhe ndihma e tij nuk janë të rezervuara për një krahinë dhe për një grup të posaçëm. Horizonti intelektual i tij është i gjerë, ndërsa shikimet e tija liberale dhe të pakufizuara siç është mbretëria e Zotit. Si mundet këtë gjerësi të shikimit ta arrijë një pabesimtar ose politeist, ose ndonjë, i cili beson në zot për të cilin pafytyrohet se posedon fuqi të kufizuara dhe jo të plota si edhe njeriu i rëndomtë?

b) Kjo fe krijon në njeriun shkallën më të lartë të vetërespektimit. Besimtari di se vetëm All-lahu xh.sh. ka tërë pushtetin dhe se askush, përveç Atij, nuk mund ta mbrojë ose ta shkatërrojë njeriun, ta furnizojë atë, t'ia marrë jetën ose t'ia japë ate, t'ia humbë nderin ose pushtetin. Kjo bindje e bën shpirtgjerë, të pavarur, dhe të pamposhtur ndaj të gjitha autoriteteve dhe fuqive tona. Asnjëherë nuk e përkul kokën në shenjë nënshtrimi para asnjë krijese të Zotit. Nuk i frikësohet madhësisë së askujt. Këtë cilësi nuk do ta prodhonte asnjë besim (bindje) tjetër. Sepse ata, të cilët i shoqërojnë qenie tjera Zotit, ose mohojnë ekzistimin e Zotit, patjetër e kanë thellë t'u

nënshtrohen atyre krijesave, duke konsideruar se mund t'i mbrojnë, duke u frikësuar dhe duke i lëshuar në to tërë shpresat e tyre.

c) Bashkë me vetërespektimin kjo fe prodhon në njeriun po ashtu ndjenjë të modestisë dhe të nënshtimit. E bën të thjeshtë dhe të ndershëm. Besimtari asnjëherë nuk është kryelartë ose i vrazhdë. Të krenuarit me pushtet, me pasuri nuk ka vend në zemrën e tij, sepse ai e di se krejt çka posedon ia ka dhënë All-llahu xh.sh. dhe se Zoti mund t'ia marrë ashtu si edhe ia ka dhënë. Përkundër kësaj, pabesimtari kur arrinë ndonjë meritë botërore, bëhet kryelartë dhe mendjemadh, sepse mendon se ajo i takon vetëm shkathtësisë së tij. Po ashtu, krenaria dhe mendjemadhësia ndjekin gjithmonë shirkun (të përshkruarit shok Zotit),sepse mushriku beson se në mes hyjnive ka raport të posaçëm, i cili nuk ekziston ndërmjet tyre dhe botës tjetër.

ç) Kjo fe e bën njeriun të ndershëm dhe korrekt. Ai është i bindur se për te nuk ka mjete tjera për të arritur sukses të shpëtojë, përveç pastërtisë së shpirtit dhe sjelljes korrekte. Ai ka besim të plotë në Zotin, i cili nuk ka nevojë për asgjë dhe i cili nuk varet prej askujt. Sepse Zoti xh.sh. është absolutisht i drejtë dhe askush nuk ka pjesë e as ndikim në kryerjen e fuqisë së Tij Hyjnore. Kjo fe krijon në te vetëdijen se, nëse nuk jeton drejtë dhe nuk punon drejtë, nuk do të korrë sukses. Kurrfarë ndikimi ose aktiviteti i fshehtë nuk do të mund ta shpëtojë prej shkatërrimit. Kafirët dhe mushrikët, përkundër, gjithmonë jetojnë me shpresa të rrejshme. Disa prej tyre besojnë se djali i Zotit është sakrifikuar për faljen e mëkateve të tyre; të tjerët mendojnë se janë dashamirë të Zotit dhe nuk do të dënohen: disa mendojnë se të shenjtit e tyre do të kujdesen për ta tek Zoti, ndërsa të tjerët u japin dhurata hyjnive të veta dhe besojnë se duke i korruptuar kështu hyjnitë, marrin leje për krejt mendjelehtësitë e tyre dhe për tërë veprat e tyre të këqija dhe se munden të bëjnë çka të duan. Besimet e tilla të gabuara i mbajnë gjithmonë të lidhur

në rrjetat e mëkatit dhe veprës së keqe, dhe pasi varen prej zotave të tyre, ata lënë pas dore pastrimin e shpirtave të tyre dhe jetën e drejtë në këtë botë. Për sa u përket pabesimtarëve, ata nuk besojnë se ekziston Qenie e cila ka fuqi mbi ata, para të Cilit do të përgjigjen për veprat e tyre të mira ose të këqija; domethënë, ata e konsiderojnë veten të lirë të punojnë plotësisht si duan në këtë botë. Shinakotat e tyre personale bëhen hyjni të tyre dhe ata jetojnë si skllëvër të dëshirave të tyre.

d) Besimtari asnjëherë nuk është i i mundur ose i mposhtur në kurrfarë rrethana. Ai ka besim të fortë në Zotin, i Cili është Zotëri i gjithçkafit që është në qiej e në tokë, mëshira dhe bujaria e Tij nuk ka kufij dhe fuqia e të Cilit është e pafund. Kjo fe i sjell zemrës së tij ngushëllim të posaçëm, e mbush zemrën e tij me kënaqësi dhe me shpresë. Në këtë botë, njeriu do të përjetojë nënçmim në çdo hap, asgjë nuk i shërben qëllimeve të tij, çdo gjë mund t'i mungojë; por feja e tij në Zotin dhe besimi në Te asnjëherë nuk e lëshojnë, ndaj me ndihmën e tyre vazhdon luftën. Ky besim i thellë mund të jetë rezultat vetëm prej fesë në një Zot. Mushrikët, kafirët dhe të pafetë (ateistët), kanë zemra të dridhshme, sepse shpresat e tyre bazohen në themele të dobëta; dhe në çastet e rënda shpejt bien si dhe shpesh bëjnë vetëvrasje. (“Vetëvrasja është e rrallë në shtetet muslimane” - Philip K. Hitl. Historie des Arabes 1951 f.129)

dh) Kjo fe krijon në njeriun shkallë mjaft të fortë të vendosmërisë, këmbënguljes së durueshme, dhe dhënies në Zotin. Kur njëherë ka vendosur që fuqitë e tij t'ia kushtojë kryerjes së urdhrave të Zotit që të përfitojë kënaqësinë e Tij, ai është i sigurt se e përmban Zotëriu i gjithësisë. Kjo siguri e bën të fortë si shkëmbi, dhe kurrfarë rëndësie dhe pengese nuk mund ta largojë prej vendimit të tij. Shirku, kufri dhe ateizmi nuk prodhojnë efekte të tilla.

e) Ky respektim i fesë e bën njeriun të fortë. Ekzistojnë dy gjëra, të cilat e bëjnë njeriun qyqar: 1. Frika prej vdekjes dhe dashuria për siguri; 2. Ideja se ekziston dikush, përveç Zotit i cili mund të marrë jetën dhe se njeriu me mjete të posaçme mund ta vazhdojë vdekjen. Besimi në La ilahe il-lall-llah pastron shpirtin prej këtyre dy nocioneve. Sa i përket nocionit të parë, besimtari di se jeta e tij dhe pasuria e tij dhe çdo gjë tjetër i takon në realitet Zotit dhe ai është gati të sakrifikojë çdo gjë për kënaqësinë e Zotit. Mendimit të dytë ai i lirohet më lehtë, sepse di se kurrfarë arme, asnjë njeri e as kafshë nuk ka fuqi t'ia marrë jetën, vetëm Zoti mund ta bëjë këtë. Koha e tij është e caktuar. Sikur edhe tërë fuqitë e botës të bashkohen dikujt nuk do të mundnin t'ia marrin jetën as një sekond para kohës së paracaktuar. Prandaj askush nuk është më trim se ai i cili beson në Zotin. Asgjë nuk mundet ta frikësojë: bile edhe stuhitë e fatkeqësive, shakullima e pengesave, si dhe armatat më të fuqishme nuk mund ta shkatërrojnë. Kur del të luftojë në emër të Zotit ai mund ta shkatërrojë fuqinë dhjetë herë më të fortë se ai. Prej ku mushrikët, kafirët dhe të pafetë (ateistët) mund të fitojnë vendosmëri të tillë, fuqi të këtillë? Ata konsiderojnë jetën si diçka që është më e shtrenjtë në botë dhe besojnë se vdekjen e sjell armiku dhe se mund t'i iket nëse ikim para tij!

ë) Besimi në La ilahe il-lall-llah sjell paqe, kënaqësi të shpirtit, liron shpirtin prej dëshirave dinake të xhelozisë, të zilisë dhe të lakmisë, e mbron që të mos përdorë mjete të ndaluara për të arritur sukses. Besimtari e di se pasuria është në duart e Zotit dhe se Ai e ndanë në masë më të madhe ose më të vogël si dëshiron; Se nderi, fuqia dhe autoriteti - çdo gjë i është nënshtruar dëshirës së Tij - dhe Ai dhuron si don. Se detyrë e njeriut është vetëm të mundohet dhe të luftojë ndershëm e në mënyrë korrekte. Ai e di se sukcesi dhe mossuksesi varen prej mëshirës së Zotit; nëse Ai don të japë, asnjë fuqi nuk mundet ta pengojë në të, e nëse nuk don, askush nuk mund ta

detyrojë të japë. Përkundrazi, mushrikët, kafirët, dhe të pafetë konsiderojnë se sukseset ose mossukseset e tyre varen vetëm prej orvatjes së tyre personale dhe prej ndihmës dhe rezistencës së fuqive tokësore. Sipas asaj, ata gjithmonë mbeten skllëvër të xhelozisë dhe të lakmisë. Që të korrin sukses ata nuk e shohin për të madhe që të korruptojnë, të lajkatojnë, të tradhtojnë dhe të shfrytëzojnë të gjitha llojet e mjeteve jofisnike. I brenë xhelozia dhe zilia para suksesit të të tjerëve dhe shfrytëzojnë krejt çka është në fuqinë e tyre që të shkaktojnë rënien e rivalit të tyre.

f) Efekti më i rëndësishëm i shprehjes La ilahe il-lall-llah është në atë që ajo bën që njeriu t'i nënshtrohet dhe t'i përmbahet ligjit të Zotit. Ai i cili beson në këtë dispozitë është i sigurt se Zoti di krejt çka bëhet haptas dhe fshehtas. Nëse bën mëkat në vend të fshehtë ose në errësirën e natës, Zoti atë e di. Ai i di bile edhe mendimet dhe qëllimet tona të mira ose të këqija. Ne mundemi të fshehemi prej çdokujt, por prej Zotit nuk mundemi. Sa më shumë është i bindur njeriu në te aq më shumë do t'u përmbahet porosive të Zotit, do t'i largohet asaj që Zoti e ka ndaluar, ndërsa do t'i kryejë urdhrat e Tij, bile edhe nëse është vetë dhe i fshehur në hijen e natës, sepse e di se mbikëqyrja e Zotit nuk mungon asnjëherë dhe ai i frikësohet gjyqit, gjykimi i të cilit është i pashmangshëm. Prandaj kusht i parë dhe më i rëndësishëm që të jesh Musliman është besimi në La ilahe il-lall-llah. Musliman, siç e pamë, është ai i cili i nënshtrohet Zotit, ndërsa nënshtrimi ndaj Zotit është i pamundshëm nëse nuk besohet fort në La ilahe il-lall-llah që d.m.th. askush nuk është i denjë të adhurohet, përveç All-llahut.

Në mësimet e Muhammedit (a.s.) besimi në Një Zot është parim më i rëndësishëm dhe themelor. Kjo është baza e Islamit dhe burim i fuqisë së tij. Të gjitha besimet tjera, urdhrat dhe ligjet e Islamit bazohen në këtë bazë. Të gjithë marrin fuqinë e tyre prej këtij burimi. Nëse e heqim, nuk mbetet asgjë prej Islamit.

BESIMI NË MELEKËT E ZOTIT

Pejgamberi Muhammed (a.s.) na mësoi që përveç kësaj, të besojmë në ekzistimin e melekëve të Zotit. Kjo është shtylla e dytë e besimit islam. Ajo është mjaft e rëndësishme, sepse pastron konceptin e Tevhidit dhe largon rrezikun prej çdo nuance të shirkut (politeizmit).

Politeistët i shoqëronin Zotit:

- a) atë që ka ekzistim material dhe që është e dukshme për syrin e njeriut, siç është dielli, hëna, yjet, zjarri, uji, kafshët, heronjtë.
- b) atë që nuk ka ekzistim material dhe që nuk mund të vërehet me syrin e njeriut: qenie të padukshme për të cilat njeriu mendon se janë përgjigje për drejtimin e gjithësisë: njëra p.sh. e kontrollon erën, e dyta jep dritë, e treta shiun etj.

Hyjnitë e ashtuquajtura të kategorisë së parë kanë ekzistim material dhe njeriu i sheh. Pretendimi i tyre i rrejtshëm mbi Zotin plotësisht është i ekspozuar me Kelimenë La ilahe il-lall-llah. Kjo është e mjaftueshme të refuzohet mendimi se ato posedojnë diçka hyjnore ose se meritojnë çfarëdo respektimi.

Qeniet e kategorisë së dytë, meqë janë jomateriale, janë të fshehura prej syrit të njeriut dhe janë të paarritshme; politeistët janë të prirë që të besojnë në to. I konsiderojnë si hyjni, zota ose si fëmijë të Zotit. Bëjnë idhuj dhe u dhurojnë sakrifica. Që të besohet në njësinë e Zotit, dhe që të eliminohet besimi në krijesat e padukshme të kategorisë së dytë, është e paraqitur posaçërisht kjo shtyllë e fesë.

Muhammedi (a.s.) na ka udhëzuar se këto qenie shpirtërore të padukshme, të cilat njerëzit i marrin për hyjni, zota dhe fëmijë të Zotit, në realitet janë melekët e Tij; ata janë nën sundimin e Tij, dhe aq i janë nënshtruar Atij sa që nuk mund të largohen prej urdhrave të Tij. Zoti i përdorë për udhëheqje në mbretërinë e Tij, dhe ato i plotësojnë urdhrat e Tij saktë dhe me plot vetëdije. Ato nuk kanë kurrfarë pushteti që të mund të vendosin sipas dëshirës së tyre: nuk mund t'i propozojnë Zotit kurrfarë plani të mendimit të tyre; bile nuk janë të autorizuar që të ndërmjetësojnë te Zoti për njeriun. Të adhurohen dhe të kërkohet ndihmë prej tyre është mosdinjtet dhe nënçmim për njeriun. Sepse, në fillim të krijimit, Zoti i urdhëroi ato që t'i përulen Ademit, i dha më shumë dituri prej tyre dhe duke e vënë mbi to e bëri Ademin mëkëmbës të Vetin në tokë. Pra a mund të ketë nënçmim më i madh për njeriun se sa t'u përkulet dhe t'u lutet për mëshirë atyre, të cilët kanë rënë barkas para tij.

Muhammedi (a.s.) na ka ndaluar t'i adhurojmë melekët dhe t'u përshkruajmë karakter hyjnor, por na ka sqaruar në të njëjtën kohë se melekët janë qenie të zgjedhura të Zotit, të pastra prej çdo mëkati, sipas natyrës të paafta që mos t'i nënshtrohen Zotit dhe gjithmonë të zëna me kryerjen e urdhrave të Tij. Përveç asaj na ka mësuar se këta melekë na rrethojnë në të gjitha anët, dhe se gjithmonë janë në shoqërimin tonë. Ata vërejnë dhe shënojnë të gjitha veprat tona, të mira e të këqija dhe ruajnë evidentimin komplet për jetën tonë. Pas vdekjes sonë, kur do të dalim para Zotit, ata do të dorëzojnë protokollin e plotë për punën tonë gjatë jetës në tokë, në atë libër çdo gjë do të jetë e shkruar përgjithmonë, kurse nuk do të lëshohet as imtësia më e vogël, bile edhe hollësia më e parëndësishme dhe më e fshehur.

Ne nuk jemi të informuar për natyrën themelore të melekëve. Na janë përmendur vetëm disa attribute dhe cilësi të tyre dhe prej neve lypet të besojmë në ekzistimin e tyre. Ne nuk kemi

mënyrë tjetër të njohim natyrën dhe cilësitë e tyre. Ajo do të ishte marri e qartë t'u përshkruajmë nga ana jonë çfarëdo forme ose cilësie. Ne duhet të besojmë patjetër në to ashtu siç kërkohet prej nesh. Të mohojmë ekzistimin e tyre është kufr sepse së pari nuk kemi shkas për atë mohim, dhe e dyta, mospranimi ynë që t'i besojmë do të ishte i njëjtë si edhe t'i përshkruajmë rrenë Muhammedit (a.s.). Ne thjesht besojmë në ekzistimin e tyre për atë se në këtë na ka udhëzuar Pejgamberi i vërtetë i Zotit xh.sh.

BESIMI NË LIBRAT E ZOTIT XH.SH.

Shtylla e tretë e fesë, të cilën na e ka urdhëruar Muhammedi (a.s.) ta besojmë është besimi në librat e Zotit; librat të cilat All-llahu ia dërgoi njerëzimit, prej kohe në kohë nëpërmjet pejgamberëve.

Zoti ua ka shpallur librat e Veta pejgamberëve të Vet edhe para Muhammedit dhe këto libra janë të dërguara në të njëjtën mënyrë siç ia ka dërguar All-llahu Kur'anin Muhammedit (a.s.). Ne jemi të informuar për emrat e këtyre librave: Librat e Ibrahimit, Tevrati i Musait, Zeburi i Davudit dhe Inxhili i Isait. Nuk i dimë emrat e librave, të cilat u janë dërguar pejgamberëve të tjerë. Domethënë përsa i përket ekzistimit të librave tjerë fetarë, nuk mund të themi mesiguri se a kanë qenë ato të shpallura ose jo. Por heshtazi besojmë se këto libra, të cilat All-llahu i ka dërguar, janë të vërteta.

Në mes librave të cilat i përmendëm, librat e Ibrahimit u humbën dhe nuk lanë kurrfarë gjurmësh në literaturën botërore. Zeburi i Davudit (libri i psalmeve), Tevrati dhe Inxhili ekzistojnë të hebrenjtë dhe krishterët, por Kur'ani neve na mëson se njerëzit i kanë ndryshuar këto libra dhe se fjalët e Zotit aty janë të përziera me trillimet personale të shkrimtarëve. Bile edhe studimi sipërfaqësor i këtyre librave të Dhjatës së Vjetër dhe katër ungjijve të Dhjatës së Re zbulon se janë prodhim i lapsit të njeriut, dhe se vetëm disa pjesë origjinale të psalmeve të Davudit dhe të Ungjillit të Isait janë të ruajtura aty. Pesë librat e parë të Dhjatës së Vjetër nuk e përbëjnë Tevratin origjinal, por në realitet janë fragmente të Tevratit të përziera me rrëfimet tjera, të cilat i kanë shkruar njerëzit, ku direktivat origjinale të Zotit janë humbur në këtë përzierje. Po ashtu katër ungjijt e Isait nuk janë origjinali, të cilin e ka predikuar Isai a.s. Ato janë në realitet, biografia e Isait, të cilën e kanë shkruar katër njerëz të ndryshëm në bazë të njohjes së tyre dhe thashethemeve të dëshmitarëve të tjerë, me vepra të caktuara të ungjillit origjinal. Por origjinalja dhe fiktivja, hyjnorja dhe njerëzorja, janë aq të përziera, saqë është vështirë të dallohet kokrra prej bykut. Është fakt se fjala origjinale e Zotit nuk është e ruajtur as te hebrenjtë e as te krishterët. Përkundrazi, Kur'ani është plotësisht i ruajtur dhe në te asgjë nuk ka ndryshuar, e as nuk është hequr. Kjo punë në ndryshimin e librave është aq e dukshme saqë vetë hebrenjtë dhe krishterët pranojnë se nuk i kanë tekstet origjinale, por i kanë vetëm përkthimet e tyre, të cilat me shekuj kanë përjetuar dhe ende përjetojnë shumë ndërrime. Duke i studiuar këto libra, gjejmë shumë fragmente dhe përshkrime, të cilat nuk mund të jenë prej Zotit. Fjalët e Zotit dhe të njeriut janë të përziera në këto libra dhe ne nuk dimë çka rrjedh prej Zotit e çka prej njeriut. Na është urdhëruar të besojmë në librat më parë të shpallur në kuptim vetëm që të pranojmë se Zoti ka dërguar libra edhe para Kur'anit nëpërmjet Pejgamberëve të Vet, se të gjitha ato kanë qenë të të njëjtit Zot. Ai i njëjti, i cili e dërgoi Kur'anin dhe lejoi shpalljen e Kur'anit si libër të Zotit; nuk

ishte rast i ri dhe i panjohur, por me këtë kishte për qëllim të vërtetojë, të riformulojë dhe të plotësojë udhëzimet e Tij, të cilat i kanë shtrembëruar njerëzit ose në të kaluarën janë lënë pas dore.

Kur'ani është libri i fundit i Zotit dhe ekzistojnë dallime mjaft të mëdha në mes tij dhe librave të mëparshëm. Këto dallime mund të radhiten shkurt:

- a) Tekstet origjinale të shumicës së librave të mëparshëm të Zotit kanë humbur, kurse kanë mbetur vetëm përkthimet e tyre. Kur'ani, përkundrazi, ekziston ashtu si i është shpallur Pejgamberit: asnjë fjalë, asnjë pikë nuk është e ndryshuar. Fjala e Zotit ashtu është e ruajtur për tërë kohët.
- b) Në librat e mëparshëm të Zotit, njeriu i ka përzier fjalët e veta me fjalët e Zotit; në Kur'an gjenden vetëm fjalë të Zotit në pastërtinë e tyre origjinale. Këtë madje e pranojnë edhe armiqtë e Islamit.
- c) Për disa libra tjerë të shenjtë, të cilët i posedojnë popujt e ndryshëm në bazë të argumenteve historike, nuk mund të thuhet se ato me të vërtetë i takojnë pejgamberit, të cilit i përshkruhen. Për disa as që dihet se në cilën kohë dhe cilit pejgamber i janë shpallur. Përsa i përket Kur'anit, argumentet se ai i është shpallur Muhammedit (a.s.) janë aq të shumta, aq të bindshme dhe aq të pakundërshtueshme saqë edhe kritiku më i ashpër i Islamit nuk mund të dyshojë në to. Këto argumente janë aq në detaje saqë me siguri mund të dihet shkaku dhe vendi i shpalljes së shumë ajeteve dhe urdhrave të Kur'anit.

ç) Librat e mëparshëm të Zotit janë të dërguar në gjuhët, të cilat kohë të gjatë janë gjuhë të vdekura. Në kohën e sotme asnjë popull ose shoqëri nuk flet në këto gjuhë, ndaj vetëm një numër i vogël i njerëzve mund t'i kuptojë. Domethënë, sikur edhe sot të ekzistonin këto libra në formën e tyre të pastër dhe origjinale, do të ishte e pamundshme në kohën tonë t'i kuptojmë dhe sqarojmë drejtë urdhrat e tyre dhe t'i zbatojmë në praktikë. Nga ana tjetër, gjuha e Kur'anit është gjuhë e gjallë; me miliona njerëz flasin në te, kurse me miliona tjerë e kuptojnë dhe e njohin; ajo ligjërohet gati në të gjitha universitetet e botës; çdokush mund ta mësojë, kurse ai i cili nuk ka kohë që ta bëjë këtë, kudo do të gjejë njerëz të cilët e njohin këtë gjuhë dhe të cilët mund ta sqarojnë kuptimin e Kur'anit.

d) Çdo libër i shenjtë i ishte dërguar popullit të posaçëm. Secili prej tyre përmbante numër të caktuar të urdhrave, të cilat si duket i ishin dedikuar për një periudhë të caktuar të historisë, dhe u janë përgjigjur nevojave të asaj kohe. Ato sot nuk janë të nevojshme e as që mund të praktikohen në praktikë me kënaqësi. Kjo tregon qartë se këto libra i ishin të caktuara një populli të posaçëm e jo tërë njerëzimit. Përveç kësaj, ato nuk janë shpallur që të ndiqen përgjithmonë, bile edhe prej popujve, të cilëve u janë dërguar; ato janë të dedikuara që të shfrytëzohen vetëm në një periudhë me kohë të caktuar. Kur'ani, përkundrazi, i është dedikuar tërë njerëzimit: për asnjë dispozitë të tij nuk mund të dyshohet se i është dërguar posaçërisht një populli. Po ashtu porosinë e Kur'anit janë të atilla që mund të përdoren në çdo vend dhe në çdo kohë. Ky fakt tregon se Kur'ani i është dedikuar tërë gjinisë njerëzore dhe ai është ligj i përhershëm për jetën e njeriut.

dh) Nuk mund të mohohet se librat e mëparshëm të Zotit kanë përmbajtur po ashtu parime të drejtësisë dhe ndershmërisë; ato po ashtu kanë mësuar për parimet e moralitetit dhe kanë treguar mënyrën e jetës, e cila i pëlqen Zotit, por asnjëri prej tyre nuk ishte aq i gjithanshëm që të

përmbajë tërë atë që është e nevojshme për jetë morale të njeriut, duke mos lëshuar asgjë dhe duke mos shtuar asgjë. Disa prej tyre dallohen në një shikim, kurse të tjerët në shikim tjetër. Kur'an-i është ai, i cili ruan jo vetëm atë që ishte e mirë në librat e mëparshëm, por edhe e përfundon fjalën e Zotit, e paraqet në mënyrë të plotë dhe e vizaton atë ligj të jetës, i cili përmban krejt çka është e nevojshme për njeriun në këtë botë.

e) Për shkak të përzierjes dhe shtrembërimit të tekstit nga ana e njeriut, me shtimin e fjalëve dhe fjalive të reja, janë të ndërfutura shumë sende në këto libra, të cilat janë joreale, të cilat e revoltojnë logjikën dhe e nënçmojnë çdo instinkt të drejtësisë. Aty gjenden gjëra jonjerëzore dhe të pandershme, të cilat e shtrembërojnë besimin dhe veprimin e njeriut. Për fat të keq, përveç kësaj, janë ndërfutur edhe gjëra, të cilat janë të padenja dhe joreale. Kur'an-i është pa shtime të tilla; ai nuk përmban asgjë të kundërt me logjikën ose diçka që do të nënçmonte moralin; asnjë imperativ i tij nuk është i padrejtë ose i tillë që të udhëzojë në të keq; në te nuk ka as gjurmë më të vogël të mosdinjitetit ose amoralitetit. Prej fillimit deri në fund, libri është plot me urti dhe me vërtetësi. Ai përmban filozofinë më të mirë dhe ligj për civilizimin njerëzor. Ai tregon rrugën e drejtë dhe e udhëheq njeriun drejt suksesit dhe shpëtimit.

Duke pasur parasysh këto karakteristika të posaçme, Kur'anit i përgjigjen të gjithë popujt e botës që të besojnë në te, t'i refuzojnë të gjithë librat tjerë dhe të ndjekin vetëm Kur'anin, sepse ai përmban krejt atë që është rëndësishme që të jetohet në pajtim me kënaqësinë e Zotit dhe pas tij më nuk ka nevojë për kurrfarë libri tjetër të Zotit.

Të studiuarit e dallimeve në mes Kur'anit dhe librave të tjerë të Zotit na lehtëson të kuptojmë, se natyra e fesë në Kur'an dhe në librat tjerë nuk është e njëjtë.

Besimi në librat e mëparshëm të Zotit do të kufizohej në thënien se janë të shpallur krejt prej Zotit, se janë të vërtetë dhe se janë të shpallur që në kohën e vet të plotësojnë qëllimin e ngjashëm si të Kur'anit. Përkundrazi, sa i përket Kur'anit, besimtari duhet të besojë se Kur'ani paraqet vetëm fjalën e Zotit, se absolutisht është i vërtetë, se çdo fjalë e tij është e ruajtur mirë, dhe se krejt çka në të është e përmendur është e saktë, e drejtë dhe e arsyeshme. Njeriu ka për detyrë obliguese, në jetën e vet të udhëhiqet nga të gjitha porosinë e Kur'anit dhe t'i largohet krejt asaj që është në kundërshtim me dispozitat e tij.

BESIMI NË PEJGAMBERËT E ZOTIT XH.SH.

Në kapitullin e mëparshëm pamë se pejgamberët e Zotit janë paraqitur në gjiun e çdo populli, dhe se në esencë të gjithë kanë sjellë të njëjtën fe - Islamin, të cilën e propagandoi Muhammedi (a.s.). Nga ky pikëshikim, të gjithë pejgamberët e Zotit i takojnë kategorisë së njëjtë dhe gjenden në të njëjtën shkallë. Mohimi i njerit prej tyre është njëjtë si edhe të mohosh të gjithë ata, dhe nëse njeriu pranon njërin prej tyre ai duhet patjetër t'i pranojë të gjithë. Shkaku për këtë është mjaft i thjeshtë. Paramendoni se dhjetë njerëz thonë të njëjtën gjë; nëse pranoni se njëri prej tyre flet të vërtetën, ju me atë pranoni se edhe nëntë të tjerët flasin të vërtetën. Nëse ju nuk pranoni atë që thotë njëri prej tyre, ju refuzoni, kuptohet, edhe të gjithë të tjerët. Prandaj në Islam është e domosdoshme të ketë besim të pakushtëzuar në të gjithë pejgamberët e Zotit xh.sh. Ai i cili nuk beson në njërin prej pejgamberëve është kafir, bile edhe nëse beson në krejt pejgamberët tjerë.

Duket se, sipas haditheve, numri i përgjithshëm i pejgamberëve të dërguar popujve të ndryshëm, në epoka të ndryshme është 124.000. Nëse vëreni zanafillën e botës prej kur është paraqitur në të njeriu dhe numri i popujve të ndryshëm, të cilët kanë parakaluar- ky numër nuk është aq i madh. Ne duhet të besojmë saktë në ata pejgamberë, të cilët janë të përmendur në Kur'an. Për sa u përket të tjerëve duhet të besojmë se të gjithë pejgamberët, të cilët i dërgoi All-llahu xh.sh. të udhëheqin njerëzimin, janë të vërtetë. Sipas asaj ne besojmë në të gjithë pejgamberët, të cilët janë paraqitur në Indi, Kinë, Persi, Egjipt, Afrikë, Evropë dhe në të gjitha vendet e botës, por nuk mund të jemi të sigurt sa u përket atyre, të cilët nuk gjenden në listën e pejgamberëve të shënuar në Kur'an. A kanë qenë ata pejgamberë ose jo, ne nuk dimë asgjë të saktë për ta. Nuk na lejohet të flasim diçka kundër njerëzve të shenjtë të feve tjera. Gjithsesi është e mundur që ndonjëri prej tyre të ketë qenë pejgamber i Zotit dhe se nxënësit e tyre e kanë prishur mësimin e tyre pas vdekjes së tyre, ashtu siç bënë nxënësit e Isait dhe Musait (le të jetë i kënaqur Zoti me të dytë!). Domethënë, kurdo që shprehim ndonjë mendim për ta, kjo ka të bëjë me parimet dhe ritet e feve të tyre; për sa u përket themeluesve të këtyre religjioneve, ne nuk do të flasim për ta, nga frika se mos gabojmë ndaj Pejgamberit.

Ata kanë qenë pejgamberë të Zotit dhe Zoti i ka dërguar të tregojnë rrugën e njëjtë të drejtë të Islamit; në këtë plan nuk ka dallim ndërmjet Muhammedit dhe pejgamberëve të tjerë (Le të jetë bekimi i Zotit mbi të gjithë!), dhe neve na është urdhëruar që të besojmë njësoj në të gjithë pejgamberët. Por edhe pse në këtë shikim janë të njëjtë, ekzistojnë dallimet që vijojnë ndërmjet Muhammedit (a.s.) dhe pejgamberëve të tjerë (le të jetë bekimi i Zotit mbi ta të gjithë!):

- a) Pejgamberët e mëparshëm kanë ardhur në kohë të caktuar dhe në popull të caktuar, ndërsa Muhammedi (a.s.) është i dërguar për tërë botën dhe për të gjitha kohët. (Për këtë pikë më detajisht u fol në kapitullin III).
- b) Të mësuarit e këtyre pejgamberëve u humb, ose ajo që ende ka mbetur nuk është e plotë dhe e vërtetë, më shpesh gjendet në përzierje me deklaratat e trilluara dhe të gabueshme. Prandaj edhe nëse dikush do të ndjekë mësimet e tyre, nuk mund ta bëjë atë. Përkundrazi, shkenca e Muhammedit (a.s.), biografia e tij, fjalët e tij, mënyra e jetës së tij, morali i tij, shprehitë dhe shkathtësitë e tij, shkurt, janë të ruajtura të gjitha hollësitë e jetës dhe veprës së tij. Muhammedi (a.s.) sipas kësaj është i vetmi prej ciklit të pejgamberëve, është person i vetëm, pas hapave të të cilit mund të shkohet me përkushtim.
- c) Udhëzimet, të cilat na i kanë dhënë pejgamberët e mëparshëm nuk janë komplete dhe të gjithmbarshme. Çdo pejgamber ka ardhur njëri pas tjetrit dhe ka bërë ndërrime dhe plotësime në mësimet dhe urdhrat e të parëve të vet, duke vazhduar zinxhiri i reformave dhe i progresit. Prandaj mësimet e pejgamberëve të mëparshëm pas një kohe të caktuar janë harruar. Është e qartë se nuk kishte nevojë të ruhen mësimet e mëparshme pasi në vend të tyre vinin udhëzime më komplete dhe më të përsosura. Së fundi, njerëzimit nëpërmjet Muhammedit (a.s.) i është dhënë ligji më i përsosur dhe të gjitha ligjet tjera automatikisht janë revokuar. Do të ishte marrëzi dhe e pakuptimtë që të ndiqet ligji i mangët, kur ekziston ligji i plotë. Ai, i cili ndjek Pejgamberin Muhammed, i ndjek të gjithë pejgamberët, sepse gjithçka që është e mirë dhe e përhershme në mësimet e tyre, gjendet edhe në mësimet e Muhammedit. Pra, ai i cili nuk pranon mësimet e Muhammedit (a.s.) dhe zgjedh të pasojë ndonjë pejgamber tjetër, vetëm fshehet prej udhëzimeve të shumta të mira dhe të dobishme, të cilat mund të gjenden në mësimet e Muhammedit (a.s.),

por të cilat asnjëherë nuk kanë ekzistuar në librat e pejgamberëve të mëparshëm dhe, të cilat janë zbuluar vetëm me ndërmjetësimin e Pejgamberit të fundit.

Prandaj është obligim i çdo qenieje njerëzore të besojë në Muhammedin (a.s.) dhe vetëm atë ta ndjek. Që të bëhet musliman i vërtetë (ithtar i mënyrës së jetës së Muhammedit a.s.) patjetër duhet të besohet plotësisht në Muhammedin (a.s.) dhe të thuhet:

- a) Se ai është Pejgamber i Zotit
- b) Se të mësuarit e tij është i përsosur pa kurrfarë mungese
- c) Se ai është Pejgamber i fundit i Zotit; pas tij nuk do të vijë më asnjë pejgamber te asnjë popull deri në Ditën e gjykimit si edhe kurrfarë personi, të cilit muslimani do të duhej t'i besojë.

BESIMI NË JETËN PAS VDEKJES

E vërteta e pestë e besimit është besimi në jetën pas vdekjes. Pejgamberi i Zotit, Muhammedi (a.s.), na ka udhëzuar të besojmë në ringjalljen pas vdekjes dhe në Ditën e gjykimit. Elementet kryesore të këtij besimi janë siç vijon:

- Jeta e kësaj bote dhe krejt asaj që ekziston, do të përfundojë në një ditë të caktuar. Kjo ditë quhet Kijamet (ringjallja) dhe Ahireti (dita e fundit).

- Të gjitha qeniet njerëzore, të cilat kanë jetuar në këtë botë, prej zanafillës së saj, do të ringjallen dhe do të dalin para Zotit, i cili atë ditë do t'i gjykojë. Kjo quhet Hashr (mbledhje).
- Materiali i kompletuar për veprat e mira ose të këqija, të çdo personi, edhe mashkullit edhe të femrës, do të sillet para Zotit xh.sh. për gjykimin definitiv.
- Zoti xh.sh. do të vendosë për shpërblimin përfundimtar të çdo personi. Ai do t'i masë veprat tona. Ai, veprat e mira të të cilit do të rëndojnë, do të shpërblehet, kurse ai, veprat e këqija të të cilit do të rëndojnë, do të dënohet.
- Shpërblimi dhe dënimi do të jenë të matura drejt. Ata, të cilët me sukses kalojnë në këtë botë shkojnë në xhennet dhe para tyre do të hapen dyert e fatit të përhershëm. Ata, të cilët do të gjykoohen dhe kanë merituar dënim, do të dërgohen në xhehennem - vendin e zjarrit dhe mundimit.

Këto janë elementet kryesore të besimit në jetën pas vdekjes.

PËRSE ËSHTË I NEVOJSHËM KY BESIM?

Besimi në jetën pas vdekjes gjithmonë ka qenë pjesë e pandarë e mësimit të Pejgamberit. Çdo pejgamber ka kërkuar prej ithtarëve të vet të besojnë në te, pra edhe Muhammedi (a.s.). Pejgamberi i fundit e kërkon këtë prej nesh. Kjo ka qenë gjithmonë pikë me rëndësi e besimit islam. Të gjithë pejgamberët kategorikisht kanë deklaruar se ai, i cili nuk beson në te, ose dyshon,

është kafir. Kjo është kështu, sepse mohimi i jetës pas vdekjes i bën të pakuptimshme të gjitha besimet tjera. Ky mohim do të kishte domethënie se për jetë të përsosur nuk do të merret shpërblim, ndaj njeriu do të zbrazte jetën e paditurisë dhe të mosbesimit. Që këtë më mirë ta shkurtujmë, të mendojmë pak për këtë problem.

Në jetën tuaj të përditshme, çdoherë kur nga ju kërkohet të bëni diçka, ju një herë mendoni: kujt do t'i shërbejë ajo dhe çka rrezikoj nëse nuk e bëj atë? Kjo është në vetë natyrën e njeriut. Ai instinktivisht e sheh si vepër të padobishme atë vepër për të cilën nuk ka nevojë. Asnjëherë nuk keni dëshiruar të humbni kohën dhe energjinë tuaj që të bëni një punë të padobishme dhe joproduktive. Po ashtu ju nuk mundeni t'i ikni një gjëje, e cila nuk është e rrezikshme. Është rregull e përgjithshme, se sa më shumë të jeni të bindur në dobinë e një gjëje, aq më shumë përgjigja juaj do të jetë e fortë: sa më shumë dyshoni në suksesin e saj, aq më shumë qëndrimi juaj do të jetë i pavendosur. Më në fund, përse njeriu s'e vë dorën në zjarr? Sepse është i bindur se zjarri djeg. Përse ik prej mësimi? Sepse nuk e kupton rëndësinë e plotë dhe dobinë e edukimit dhe nuk beson në atë që më të vjetrit mundohen t'ia fusin në kokë.

Tani shikoni njeriun, i cili nuk beson në Ditën e gjykimit. A nuk e konsideron ai besimin në Zotin dhe jetën sipas ligjit të tij si diçka jo të rëndësishme? Çfarë vlere do t'i japë ai jetës në synimin për kënaqësinë e Zotit? Për të, nënshtrimi ndaj Zotit nuk sjell kurrfarë përparësie, mosnënshtrimi ligjit të tij, kurrfarë dëmi. Si do të jetë e mundur që ai me plot vetëdije të ndjekë urdhrat e Zotit, të Pejgamberit dhe Librit të tij? Ku do të gjejë ai motive dhe guxim të nevojshëm që t'u bëjë ballë sprovave dhe sakrificave dhe të refuzojë kënaqësinë e kësaj bote? Nëse njeriu nuk e ndjek ligjin e Zotit dhe jeton vetëm sipas dëshirës dhe instinktit të vet personal, për çka i shërben besimi i tij në ekzistimin e Zotit xh.sh., nëse ai kufizohet vetëm në atë?

Kjo nuk është e tëra. Nëse mendoni më thellë do të përfundoni se besimi në jetën pas vdekjes është faktor i rëndësishëm në jetën e njeriut. Të pranuarit e këtij kushti ose të refuzuarit e tij përcakton vetë shtegun e jetës dhe sjelljes së njeriut.

Njeriu, i cili ka parasysh vetëm suksesin ose mossuksesin vetëm në këtë botë, do të kujdeset vetëm për begatitë ose fatkeqësitë, të cilat mund t'i ndodhin në këtë jetë. Nuk do të përgatitet që të marrë ndonjë aksion, nëse nuk ka shpresa se për të do të ketë dobi në këtë botë e nëse ajo nuk i prek interesat e tij në këtë botë, as që do të largohet prej veprës së keqe.

Por njeriu, i cili beson në jetën e ardhshme, në botën tjetër, dhe i cili është fort i bindur në pasojat përfundimtare të veprave të tij, i sheh të gjitha dobitë dhe humbjet e kësaj bote si të përkohshme dhe të kalueshme dhe nuk do të vë në dyshim shpëtimin e tij të përhershëm për një dobi të përkohshme. Ai do t'i shikojë sendet në një perspektivë më të gjerë dhe gjithmonë do të ketë parasysh atë që mund ta fitojë ose ta humbë në të përhershmen. Ai do të bëjë të mira pa marrë parasysh sa do t'i kushtojë ajo në këtë botë, ose pa marrë parasysh sa tërheqëse është fuqia e saj. Ai do të gjykojë për veprat në bazë të pasojave të tyre në amshueshmëri dhe nuk do t'u nënshtrohet instinkteve dhe shinakotave të veta.

Ekziston dallim i plotë në mes koncepteve jetësore të besimtarit dhe të atij, i cili nuk beson në Ditën e gjykimit. Ideja për veprën e mirë të këtij të fundit është e kufizuar në dobinë e drejtpërdrejtë, të cilën ai mund ta arrijë në këtë jetë kalimtare: para, të mira materiale, famë dhe sende të ngjashme, të cilat i japin fuqi, pozitë, nam dhe fat në këtë botë. Këto sende e përbëjnë qëllimin e tij të vetëm në këtë botë. Kënaqja e dëshirave të tij personale dhe sukcesi i tij bëhen

alfa dhe omega të jetës së tij. Që të arrijë këtë, ai nuk sheh për të madhe që të përdorë edhe mjete të ashpra dhe të padrejta.

Po ashtu ai e quan vepër të keqe tërë atë që tërheq rrezik apo që ia ngatërron interesat e tij në këtë botë, si humbja e pasurisë dhe e jetës, shëndeti i keq, autoriteti i ulur, ose ndonjë fatkeqësi tjetër. Përkundër këtij njeriu, koncepti i së mirës dhe së keqes te besimtari është krejtësisht tjetër. Për të e mirë është krejt çka i pëlqen Zotit, kurse e keqe krejt çka e shkakton pakënaqësinë dhe hidhërimin e Tij. Vepra e mirë, sipas mendimit të tij, do të mbetet e mirë edhe nëse nuk i sjell asgjë në këtë botë, bile edhe nëse shkakton humbje në të mirat e kësaj bote, ose i dëmton interesit të tij personal. Ai është i bindur se All-llahu xh.sh. do ta shpërblejë në botën e amshuar dhe se ai është sukses i vërtetë. Po ashtu, ai nuk do t'u nënshtrohet veprave të këqija vetëm për dobinë e kësaj bote, sepse e di se edhe nëse i ik dënimit në këtë jetë të shkurtër, ai do të jetë gjithmonë në humbje dhe nuk do të jetë i aftë që të mbrohet nga dënimi i gjyqit të Zotit. Ai nuk beson në relativitetin e moralit, por u përmbahet normave absolute, të cilat All-llahu i ka shpallur, dhe jeton në pajtim me to, pa marrë parasysh në dobinë ose humbjen e kësaj bote.

Pra, besimi ose mosbesimi në jetën pas vdekjes bën që njeriu të hapë rrugë të ndryshme në jetë. Për atë, i cili nuk beson në Ditën e gjykimit, është e pamundshme të formulojë jetën e vet siç kërkon Islami. Islami thotë: Në rrugën e Zotit jepni zekat të varfërit. Përgjigja e tij do të jetë: “Jo, sepse do të varfërohem duke dhënë zekat; më shumë dua që në vend të tij të jap të hollat me kamatë”. Dhe kur ia paguan borxhin, nuk ia zë për të madhe që të marrë krejt çka i takon atij edhe nëse ata janë të varfër dhe të uritur. Islami thotë: “Flitni gjithmonë të vërtetën dhe largohuni rrenës, bile edhe nëse duke gënjer fitoni e duke folur të vërtetën humbni”. Përgjigja e tij do të jetë: “Përse të flas të vërtetën, nëse prej saj nuk kam dobi dhe nëse më sjell humbje? Përse t'i

largohem rrenës, nëse ajo më sjell dobi, duke mos rrezikuar asgjë, bile nuk më del as zëri i keq?” Ai gjendet i vetmuar në një vend dhe aty gjen një metal të vlefshëm; për situatën e tillë Islami thotë: ajo nuk është prona yte, mos e prek; por ai do të thotë: “ai është send, të cilin unë e gjeta aty rastësisht pa kurrfarë mudi; përse mos ta marr? Askush nuk më sheh, askush nuk do ta lajmërojë policinë si dhe kundër meje nuk do të dëshmojë askush në gjyq, e as do të më dalë zëri i keq ndërmjet njerëzve. Përse mos ta përvetësoj këtë gjë të çmueshme? Dikush ka lënë fshehtë të holla te ky njeri dhe së shpejti pas kësaj vdes. Islami thotë: “Bëhuni të ndershëm dhe të hollat, të cilat janë të deponuara te ju t’ua ktheni trashëgimtarëve të të vdekurit”. Ai thotë: “Pse”? Nuk ka argumente se të hollat e tij më janë besuar mua; dhe fëmijët e tij nuk i dinë. Mund t’i përvetësoj pa rrethana të rënda, duke mos u frikësuar as prej padisë gjyqësore as prej namit të tij “përse unë mos ta bëj atë”?

Më shkurt, në çdo hap në jetë, Islami e udhëheq në rrugë të sigurt dhe kërkon që të përvetësojë sjellje të konsoliduar; por ai gjithmonë do të marrë kahe të kundërt. Sepse Islami çdo gjë matë dhe vlerëson në bazë të pasojave të amshueshme; ndërsa personi i tillë çdoherë ka në mend rezultatën e drejtpërdrejt të kësaj bote. Tash mund të kuptoni përse njeriu nuk mund të jetë me të vërtetë musliman, nëse nuk beson në Ditën e gjykimit. Të jesh musliman është gjë e madhe: në realitet pa këtë besim nuk mund të bëhet as njeri i mirë, sepse mohimi i Ditës së gjykimit e rrëzon njeriun në nivelin më të ulët.

JETA PAS VDEKJES: JUSTIFIKIM RACIONAL

Deri më tash diskutuam për nevojën dhe rëndësinë e besimit në Ditën e gjykimit. Të shqyrtojmë tash deri në cilën pikë mund që racionalisht të sqarohen elementet e këtij besimi. Krejt çka Muhammedi (a.s.) ka mundur të na tregojë për jetën pas vdekjes, mund të mbrohet logjikisht. Edhe pse besimi në Ditën e gjykimit bazohet në besueshmërinë e pakushtëzuar në Pejgamberin e Zotit. Të menduarit racional jo vetëm që vërteton këtë besim, por edhe zbulon se mësimet e Muhammedit (a.s.) në këtë aspekt janë shumë më të kuptueshme se sa të gjitha qëndrimet tjera për jetën pas vdekjes.

Për jetën pas vdekjes mund të hasen mendimet që vijojnë:

- a) Disa mendojnë se me vdekjen për njeriun çdo gjë mbaron dhe se pas këtij rasti, i cili përfundon jetën e tij, nuk ka jetë tjetër. Sipas mendimit të tyre ky besim është ireal. Ata thonë se besimi i tillë është joshkencor dhe se nuk mund të mbrohet. Ky është mendimi i ateistëve, të cilët thonë se ai është i bazuar në shkencë, ndërsa për mbështetje shërben shkenca e Perëndimit.
- b) Të dytët kanë qëndrim se njeriu që t'i heq pasojat e veprave të veta, kthehet në botë përkohësisht. Nëse në jetë ka bërë vepra të këqija, në botën e ardhshme do të ketë formë të kafshës, të qenit, ose të maces etj., ose drurit ose njeriut të klasës më të ulët. Nëse veprat i ka të mira, ai do të ringjallet në klasë më të lartë. Këtë koncept e ndeshim te disa religjione orientale të caktuara.

c) Ekziston koncepti, i cili përmban besimin në Ditën e gjykimit, ringjalljen dhe daljen e njeriut para gjyqit të Zotit, si dhe në ndarjen e shpërblimeve dhe dënimeve. Ky është besimi i përbashkët i të gjithë pejgamberëve.

T'i shqyrtojmë këto konceptione të ndryshme një nga një. I pari, i cili ia përvetëson vetes autoritetin dhe mohon se atë e përmban shkenca, thotë se nuk ka kurrfarë realiteti në jetën pas vdekjes. Mbrojtësit e tij thonë se nuk kanë parë asnjëherë dikë që të kthehet pas vdekjes së vet. Nuk ka ndodhë asnjë rast i vetëm i ringjalljes. Shohim se njeriu pas vdekjes shndërrohet në pluhur. Sipas asaj, vdekja është fund i jetës dhe nuk ka jetë pas vdekjes. Por të mendojmë për këtë paragjykim. A është ai në të vërtetë i bazuar në logjikë? Nëse është e vërtetë se nuk ka ndodh asnjë rast i ringjalljes pas vdekjes, mund të përfundohet se nuk dihet se çka vjen pas vdekjes. Por në vend që të ndalen në këta kufij; ata deklarojnë se nuk do të ndodhë asgjë pas vdekjes, duke nënvizuar në të njëjtën kohë se flasin në emër të shkencës! Në realitet, ata flasin në mënyrë të pacaktuar. Shkenca nuk na thotë asgjë - negative ose pozitive - për këtë lëndë dhe thënia e tyre se nuk ekziston jeta pas vdekjes është e pabazë. Thënia e tyre nuk është aspak e ndryshueshme prej thënies së njeriut të paudhëzuar, i cili nuk ka pa asnjëherë plan dhe i cili duke u mbështetur në atë "dituri" deklaroi se aeroplanët nuk ekzistojnë! Nëse dikush asnjëherë nuk e ka pa një gjë, nuk do të thotë se ajo gjë nuk ekziston. Jo vetëm njeriu por edhe i tërë njerëzimi, nëse asnjëherë nuk e kanë parë një gjë, nuk kanë të drejtë të pohojnë se një gjë e tillë nuk ekziston ose se nuk mund të ekzistojë. Ky pohim është iluzion dhe rreptësisht antishkencor. Asnjë njeri i mençur nuk mund ta mbrojë këtë pohim.

Të shqyrtojmë tash konceptin e dytë. Sipas tij, qenia njerëzore është qenie njerëzore sepse në formën e mëparshme të saj shtazore ka bërë vepra të mira; kurse kafsha është kafshë sepse më

parë ka bërë vepra të këqija si qenie njerëzore. Me fjalë të tjera, të jeshë njeri ose kafshë është pasojë e veprave tona të bëra gjatë formës tonë të mëparshme. Pra, mund të parashtrohet pyetja: Kush u krijua më parë, njeriu ose kafsha? Nëse përgjigjemi që njeriu ka qenë para kafshës, duhet atëherë të pranojmë se ai ka qenë kafshë para asaj dhe se ka fituar formën e njeriut për shkak të veprave të mira të tij. Nëse përgjigjemi se ka qenë kafsha duhet të pranojmë se ajo ka qenë njeri para asaj, dhe është transformuar në kafshë për shkak të veprave të tij të këqija. Kjo na fut në një rreth të mahnitshëm dhe mbrojtësit e kësaj teorie nuk mund të vendosin për formën në të cilën është paraqitur krijesa e parë, sepse çdo gjeneratë përmban në vete gjeneratën e mëparshme ashtu që gjenerata e ardhshme mund të konsiderohet vetëm si pasojë e të parës. Kjo është thjesht absurde.

Të shqyrtojmë tash qëndrimin e tretë. Parafytyrimi i parë është: Kjo botë një ditë do të përfundojë, Zoti do të shkatërrojë gjithësinë dhe në vend të saj do të krijojë një botë tjetër, më të madhe dhe më të mirë. Ky pohim është gjithsesi i saktë: nuk mund të dyshohet në saktësinë e tij. Sa më shumë që mendohet për natyrën e kozmosit aq më e qartë është se orari, i cili ekziston nuk është i amshueshëm, sepse të gjitha fuqitë, të cilat veprojnë në të, janë të kufizuara sipas natyrës së tyre dhe duket krejt e qartë se ato një ditë krejtësisht do të shteren. Prandaj dijetarët pajtohen se një ditë dielli do të ftohet dhe më nuk do të prodhojë energji, se yjet do të ndeshen në mes veti dhe se i tërë sistemi i gjithësisë do të çrregullohet dhe do të shkatërrohet. Përveç kësaj, nëse evolucioni është i vërtetë për pjesët përbërëse të gjithësisë, përse ai mos të jetë i vërtetë edhe për tërë gjithësinë?

Të mendosh se gjithësia do të shkatërrohet plotësisht dhe se do të humbet është më e arsyeshme sesa të mendosh se gjithësia do të kalojë në shkallën e dytë të evolucionit dhe se do të paraqitet rend i ri i sendeve në një gjendje më të mirë dhe më ideale.

Parafytyrimi i dytë i këtij besimi është që njeriu përsëri do të ringjallet. A është e mundur kjo? Nëse është, si ka qenë jeta e tashme e njeriut e mundshme? Është e sigurt se Zoti, i cili krijoi njeriun në këtë botë, mund të bëjë të njëjtën edhe në botën tjetër të ardhshme. Kjo jo vetëm që është e mundshme, por është edhe nevojë e domosdoshme pozitive, siç do të shihet më vonë.

Parafytyrimi i tretë është që “krejt veprat e njeriut në këtë botë shkruhen dhe se do të ekspozohen në Ditën e gjykimit”. Argumentin e saktësisë së këtij pohimi në kohën tonë e pranon edhe vetë shkenca. Është zbuluar para së gjithash, se zërat të cilat i prodhojmë, emitoen në valët e lehta në ajër dhe shuhen. Tash është zbuluar se zëri lë gjurmë në sendet rreth tij dhe mundet, sipas kësaj, të riprodhohet. Pllakat e gramfonit bëhen në këtë parim. Prej aty mund të kuptohet se shenja e çdo lëvizjeje të njeriut është e shtypur në të gjitha sendet, të cilat janë në raport me valët e prodhuara nëpërmjet lëvizjes. Kjo tregon se regjistrimi i të gjitha veprave tona është i ruajtur plotësisht dhe se mund të prodhohet përsëri.

Parafytyrimi i katërt është se në Ditën e ringjalljes Zoti xh.sh. do të vendosë gjyqin e vet dhe do të shpërblejë ose do të dënojë njeriun për veprat e tij të mira ose të këqija. Ç’është këtu e palogjikshme? Vetë logjika dëshiron që Zoti të gjykojë dhe të japë gjykim të drejtë. Ne shohim shpesh se njeriu bën vepër të mirë dhe ajo nuk i sjell asgjë të mirë në këtë botë. Shohim tjetrin i cili bën vepër të keqe dhe nuk dënohet për te në këtë botë. Dhe jo vetëm kjo, ne mund të përmendim me mijëra raste ku vepra e keqe i sjell shpërblim fajtorit. Kur i shohim këto gjëra, të

cilat ndodhin çdo ditë, logjika dhe ndjenja jonë për të vërtetën dëshiron të vijë koha kur njeriu, i cili bën mirë, të shpërblehet, kurse ai që bën keq - të dënohet. Rregulli i tashëm i sendeve, si mund të shihni edhe vet, i është nënshtruar ligjit fizik sipas të cilit njeriu është i lirë të bëjë keq, nëse ai ashtu vendos, kurse për atë të mos ketë pasoja të këqija. Nëse ju keni një kovë me benzinë dhe një kuti të shkrepëses, ju mund ta digjni shtëpinë e armikut tuaj dhe mund t'i ikni krejt pasojave të kësaj vepra, nëse rrethanat janë në favorin tuaj. A do të thotë kjo që ky dëm do të shpëtojë pa pasoja? Sigurisht jo! Ajo do të thotë që është paraqitur vetëm rezultati i tij fizik, kurse rezultati i tij moral ende nuk është i vendosur. A mendoni ju që është e logjikshme që këto pasoja morale asnjëherë të mos paraqiten. Nëse mendoni se ato një ditë do të paraqiten, atëherë parashtrohet pyetja: ku? Sigurisht jo në këtë botë, sepse në këtë botë fizike vetëm veprat fizike manifestohen, ndërsa pasojat racionale dhe morale nuk paraqiten asnjëherë. Në realitet, ato mund të paraqiten vetëm me themelimin e rendit të ri të sendeve, kur ligjet morale dhe racionale do të fitojnë dhe do të kenë superioritet absolut dhe ku ligjet fizike do t'u nënshtrohen atyre morale dhe racionale. Bëhet fjalë për botën e re, e cila është siç thamë më parë; shkalla e ardhshme evolutive e gjithësisë. Ai është evolutiv në atë domethënie që do të jetë i rregulluar më parë me ligj moral e pastaj me atë fizik. Pasojat racionale të veprave të njerëzve, të cilat plotësisht ose pjesërisht janë të shmangura në këtë botë, atëherë do të paraqiten. Pozita e njeriut do të jetë e përcaktuar me vlerën e tij morale dhe racionale, sipas sjelljes së tij në këtë botë provuese. Pra, nuk do të shihni më njeriun e aftë të detyruar t'i nënshtrohet të çmendurit, ose njeriu me moral superior të marrë pozitë më të ulët sesa njeriu më i thjeshtë, siç është rasti në këtë botë.

Parafytyrimi i fundit i këtij besimi është ekzistimi i xhennetit dhe xhehennemit, e cila gjë po ashtu nuk është e pamundshme. Nëse Zoti mund të krijojë Diellin, Hënën, yjet dhe Tokën, pse të mos

mund të krijojë xhennetin dhe xhennemin. Kur do të mbajë gjykimin dhe do të shpreh gjykimet e drejta, duke i shpërblyer ata, të cilët e kanë merituar atë dhe duke i dënuar fajtorët, patjetër duhet të ketë një vend ku të merituarit do të mund të përjetojnë shpërblimin dhe fatin e çdo lloji dhe vendi i dytë ku fajtorët do të durojnë dhembjen dhe nënçmimin.

Meqë i shqyrtaam të gjithë këta probleme, secili do të konkludojë se besimi në jetën pas vdekjes është koncepti më racional, ndaj në te nuk ka asgjë të pakuptueshme. Përveç kësaj, kur Pejgamberi Muhammed a.s. thoshte se ky besim është e vërtetë absolute dhe kur dimë se ai gjithmonë tregonte vetëm atë që është e mirë për ne, logjika na detyron që të besojmë në te në mënyrë të pakushtëzuar e jo të refuzojmë këtë besim pa kurrfarë shkak të arsyeshem.

Pesë dispozitat e lartpërmendura të besimit i përbëjnë themelet e Islamit. Bërthama e tyre është e përmbajtur në fjalinë e shkurtër të ashtuquajtur Kelime Tajjibe. Kur ju e shprehni La ilahe il-lallah (nuk ka Zot tjetër, përveç All-llahut), ju i refuzoni krejt hyjnitë e rrejshme dhe deklaroni se jeni krijesa të Një Zotit; kurse ia shtoni Muhammedun resulull-llah (Muhammedi është Pejgamber i Zotit) ju vërtetoni dhe pranoni pejgamberllëkun e Muhammedit (a.s.). Fakti se pranoni pejgamberllëkun e tij heq pas edhe besimin në një Zot dhe atributet e Tij, në melekët e Tij, në Librat e Tij dhe në jetën pas vdekjes. Kjo juve ju obligon që sinqerisht të ndiqni rrugën e nënshtrimit ndaj Zotit xh.sh. të cilën Pejgamberi (a.s.) na e ka treguar. Këtu mbështetet rruga e shpëtimit dhe e suksesit.

KAPITULLI V

LUTJA DHE ADHURIMI

Diskutimi i mëparshëm na bëri me dije se Pejgamberi Muhammed (a.s.) na ka urdhëruar të besojmë në pesë themelet e fesë:

- a) Besimi në Zotin xh.sh., i cili nuk ka shok në hyjninë e Tij.
- b) Besimi në melekët e Zotit xh.sh.
- c) Besimi në librat e Zotit dhe në Kur'anin si Libër i fundit i Tij.
- ç) Besimi në pejgamberët e Zotit dhe në Muhammedin (a.s.) si pejgamber i fundit i Tij.
- d) Besimi në jetën pas vdekjes.

Këto pesë shtylla e përbëjnë bazamentin e Islamit. Ai i cili beson në to hyn nën krahët e Islamit dhe bëhet anëtar i bashkësisë islame. Por nuk mjafton që të proklamojmë besimin tonë vetëm verbalisht (me fjalë) për t'u bërë muslimanë të vërtetë. Duhet në praktikë të plotësojmë dispozitat, të cilat i ka dhënë Muhammedi (a.s.) në bazë të asaj si e ka urdhëruar All-llahu xh.sh. atë. Sepse besimi në Zotin xh.sh. gjithsesi tërheq pas veti nënshtrimin praktik në fjalët e tij; e ai është nënshtrimi në Zotin xh.sh., të cilin e ka themeluar Islami. Me këtë besim ju deklaroni se vetëm All-llahu është Zot i juaj, e kjo do të thotë se Ai është Krijuesi juaj e ju jeni krijesa të Tij; deklaroni se Ai është Zoti juaj, kurse ju robër të tij; se Ai është Sundues i juaj kurse ju të dërguar të Tij. Pasi që e keni pranuar si Zot dhe Sundues tuaj, nëse e refuzoni nënshtrimin ndaj Tij,

atëherë ju jeni renegat me pranimin tuaj personal. Njëkohësisht, kur ju besoni në Zotin xh.sh. ju besoni se Kur'ani është Libër i Zotit. Kjo do të thotë se ju pranoni se e tërë përmbajtja e Kur'anit është e inspiruar prej Zotit. Ashtu obligimi juaj është të pranoni dhe t'i nënshtrohëni tërë asaj që në te është e përmbajtur. Në të njëjtën kohë ju pranoni se Muhammedi (a.s.) është Pejgamber i Zotit, që do të thotë se keni pranuar se çdo urdhër dhe ndalesë e tij është prej Zotit xh.sh. Nëse këtë e pranoni jeni të obliguar t'i bindeni. Sipas kësaj ju do të jeni muslimanë të vërtetë vetëm atëherë, nëse veprat tuaja janë në pajtim me fjalët tuaja, përndryshe Islami juaj do të mbetet i paplotë.

Të shohim tash rregullat e sjelljes, të cilat na i ka mësuar Muhammedi (a.s.) i frymëzuar prej Zotit të Gjithëfuqishëm. E para dhe para së gjithash në këtë aspekt është Ibadeti - detyrat themelore, të cilave patjetër duhet t'u përmbahet çdo person, i cili deklaron se i takon bashkësisë islame.

SHPIRTI I IBADETIT OSE ADHURIMIT

Ibadet është fjalë arabe e nxjerrur prej Abd (rob) dhe do të thotë përlulje (nënshttrim). Ajo tregon faktin se All-llahu është Zoti juaj dhe se jeni robër të Tij, dhe se krejt ajo që një rob mund ta bëjë që Zoti i tij të jetë i kënaqur me te - është Ibadet. Koncepti islamik i ibadetit është mjaft i gjerë. Nëse ju pastroni gjuhën tuaj prej mosdinjitetit, rrenës, përgojimit, nënçmimit dhe flitni të vërtetën dhe gjëra të mira, kurse krejt atë që e bëni e bëni vetëm për atë që ka urdhëruar Zoti xh.sh. këto vepra e përbëjnë ibadetin, edhe pse ato mund të duken se nuk kanë lidhje me fenë. Nëse ju

rregullisht ndiqni ligjin e Zotit në punët tuaja tregtare dhe ekonomike, dhe nëse mbeteni besnikë në veprat tuaja me prindërit tuaj, farefisin dhe shokët dhe me të gjithë ata, të cilët vijnë në kontakt me ju, të gjitha këto aktivitete tuaja janë ibadet. Nëse ju ndihmoni të varfërit, të uriturit dhe njerëzit në fatkeqësi, nëse atë e bëni jo për interesin tuaj personal, por vetëm për atë pse e kërkon kënaqësinë e Zotit, kjo sjellje po ashtu është ibadet. Bile edhe punët tuaja bujqësore, punë të cilat i ndërmerri që të fitoni për mirëmbajtjen tuaj dhe të atyre që varen prej jush, janë ibadet, nëse i kryeni në mënyrë korrekte dhe të ndershme dhe nëse i përmbaheni ligjit të Zotit. Shkurt, të gjitha aktivitetet tuaja dhe e tërë jeta juaj janë ibadet, nëse janë në pajtim me ligjin e Zotit, nëse zemra juaj është e mbushur me frikë ndaj Zotit duke e bërë krejt këtë.

Pra, çdoherë kur bëni mirë dhe i largoheni së keqes prej frikës ndaj Zotit, në çfarëdo sferë të jetës dhe lëmi të aktivitetit, ju i plotësoni obligimet tuaja islame. Kjo është domethënia e vërtetë e ibadetit: njeriu duhet t'i dorëzohet plotësisht kënaqësisë së All-llahut, t'ia adaptojë jetën e tij rregullit, të cilin All-llahu e ka vendosur. Që të arrihet ky qëllim, është vendosur një cikël i ibadeteve të caktuara, i cili shërben si ushtrim. Sa më zellshëm t'i ndjekim ushtrimet aq më lehtë do të gjejmë harmoninë në mes idealeve tona dhe sjelljes tonë praktike. Pra, ibadetet janë shtyllat në të cilat mbështetet ndërtesa e Islamit.

NAMAZI (SALATI)

Të falurit e namazit është obligimi i parë dhe më i rëndësishëm. Ç'është Namazi? Ato janë lutjet e obligueshme të përditshme, të cilat përbëhen në përsëritjen dhe freskimin e qëndrimeve në të cilat mbështetet besimi juaj, pesë herë në ditë. Ju ngriheni herët në mëngjes, merrni abdest dhe qëndroni para Zotit tuaj. Lëvizjet, të cilat i bëni gjatë namazit (salatit) janë personifikim i shpirtit të adhurimit; leximi në namaz ua përkujton juve obligimet tuaja ndaj Zotit xh.sh. Ju kërkoni udhëzimin e Tij dhe e lutni pandërprerë t'ua bëjë të mundshme t'i largoheni hidhërimit të Tij dhe të ndiqni rrugën e Tij të drejtë. Ju lexoni prej Librit të Zotit dhe dëshmoni vërtetësinë e Pejgamberit dhe në këtë mënyrë freskoni besimin tuaj në Ditën e gjykimit dhe se do të paraqiteni para Zotit tuaj dhe do të jepni llogari për tërë jetën tuaj. Ashtu fillon dita juaj. Disa orë më vonë muezini ju thirrë në namaz dhe përsëri i nënshtroheni Zotit xh.sh. dhe përsëritni marrëveshjen tuaj me Te. Ju ndaheni prej obligimeve tuaja botërore dhe kërkoni pranim te Zoti. Kjo juve edhe një herë ua përkujton rolin tuaj të vërtetë në këtë jetë. Pas kësaj ju u ktheheni punëve tuaja; dhe përsëri pas disa orëve i prezentoheni Zotit tuaj. Kjo, përsëri është si vërejtje për ju që përsëri të rregulloni kujdesin tuaj në dispozitat e fesë. Kur dielli perëndon dhe bie errësira, ju përsëri kryeni namazin, ashtu që ju as atëherë nuk mundeni të harroni obligimet dhe detyrat tuaja. Pas një kohe të caktuar ju përsëri paraqiteni para Zotit dhe ajo është lutja juaj e fundit. Pra, para se të shkoni të fleni edhe një herë e forconi besimin tuaj dhe përuleni para All-llahut xh.sh.. Ashtu përfundoni ditën tuaj. Shpeshësia dhe koha e namazit ka për qëllim që asnjëherë mos të harroni qëllimin dhe detyrën e jetës suaj në mesin e aktiviteteve të kësaj bote.

Lehtë është të kuptohet se si lutjet e përditshme i forcojnë themelet e fesë tuaj, ju përgatisin juve për një jetë të përlurur dhe të virtytshme ndaj Zotit xh.sh. dhe e gjallërojnë këtë fe, prej nga buron trimëria, sinqeriteti, vendosmëria, pastërtia e zemrës dhe e shpirtit dhe ngritja e moralit.

Të shohim tash se si sendërtohet kjo. Ju merrni abdest si e ka rregulluar ate Pejgamberi i Zotit (a.s.). Ju i kryeni lutjet tuaja sipas udhëzimeve të Pejgamberit. Pse ju e bëni atë? Rëndom vetëm për atë se besoni në pejgamberllëkun e Muhammedit (a.s.) dhe se detyrë obliguese e juaj është që t'i përujeni me shpirtgjerësi. Përse ju nuk bëni gabime me qëllim në leximin e Kur'anit? A e bëni këtë për atë se pranoni se ky tekst është fjalë e Zotit dhe nëse i shmangeni ndonjë germe të tij e konsideroni për mëkat. Në namaz ju lexoni shumë prej tij pa zë, nëse leni diçka mangut ose bëni gabim askush nuk ka që të ju kontrollojë. Por ju atë asnjëherë nuk e bëni me qëllim. Pse? Sepse besoni se All-llahu xh.sh. gjithmonë është i zgjuar, se Ai e dëgjon tërë atë që ju e shprehni dhe se i janë të njohura të gjitha gjërat e dukshme dhe të padukshme. Kush është ai, i cili bëri që ju të faleni bile edhe në vendet ku askush nuk e kërkon atë prej jush, ose që të ju shohë se si e bëni atë? A nuk është kjo vetëm për shkak të bindjes suaj se Zoti xh.sh. gjithmonë ju vëren? Kush është që ju detyron që t'i bëni lutjet tuaja të rëndësishme dhe të shpejtoni në namaz në xhami? Kush bën që ju të ndërpreni gjumin herët në orët e mëngjesit, të shkoni në xhami, në të nxehtin e ditës dhe të lëshoni zbatimjen e natës për shkak të namazit? A është kjo diçka tjetër përveç ndjenjës suaj të obligimit, të kuptuarit tuaj se patjetër e keni të plotësioni përgjegjësinë tuaj ndaj Zotit me çdo kusht? Dhe përse frikësoheni të bëni gabim duke u lutur? Sepse zemra juaj është e mbushur me frikë e respekt ndaj Zotit dhe për atë se e dini se do të paraqiteni para Zotit xh.sh. në Ditën e gjykimit dhe do të jepni llogari për tërë jetën tuaj. A mund të ketë metodë më të mirë të ushtrimit moral dhe shpirtëror prej namazit? Ky ushtrim e bën njeriun musliman shembullor.

Namazet ia përkujtojnë marrëveshjen e tij me Zotin xh.sh. dhe e gjallërojnë besimin e tij në Allahun xh.sh. dhe bëjnë që gjithmonë të ketë në mend Ditën e gjykimit. Lutjet i ndihmojnë që të jetojë sipas parimeve të Pejgamberit (a.s.) dhe e nxitojnë të kryejë obligimet e tij. Lutja është mënyra më e mirë që t'i ndihmohet njeriut t'ua përshtatë sjelljen e vet idealeve të veta. Është e qartë nëse njeriu është i vetëdijshëm për obligimet e tij ndaj Krijuesit të vet aq fortë saqë e çmon atë më shumë se të gjitha pasuritë e kësaj bote, ai sigurisht do të jetë korrekt në të gjitha aktivitetet e tij se përndryshe do t'ia ngarkojë vetes moskënaqësinë e All-llahut të cilës gjë gjithmonë i është larguar. Ai do t'i mbetet besnik Ligjit Hyjnor në të gjitha fazat e jetës, njëllon si ka kujdes ndaj pesë namazeve të përditshme. Në këtë njeri mund të llogaritet edhe në lëmenjtë tjerë të aktiviteteve, sepse nëse i afrohet hija e mëkatit ai do të orvatet t'i largohet prej frikës ndaj Zotit e cila gjithmonë është e pranishme në zemrën e tij. E nëse edhe pas një ushtrimi qenësor të tillë njeriu sillet keq në lëmenjtë tjerë të jetës dhe e shkel ligjin e Zotit, ai mund të rrjedhë vetëm prej një mosnënshtrimi natyror të personalitetit të tij.

Pra, ne përsëri e përsërisim, ju duhet të kryeni namazet tuaja me xhemat, veçanërisht namazin e xhumasë. Ashtu formohet në mes të muslimanëve lidhja e dashurisë dhe të kuptuarit e përbashkët. Kjo ngjallë në ta ndjenjën për një kolektivitet të përbashkët dhe kultivon në ta vëllazërimin kombëtar. Të gjithë i kryejnë lutjet e tyre me xhemat, ndaj ajo mbjell një ndenjë të thellë të vëllazërimit. Namazet po ashtu janë simbole të bashkimit sepse i varfëri dhe i pasuri, i dobtë dhe i forti, oficeri dhe ushtari, i dituri dhe injoranti, i ziu dhe i bardhi - të gjithë janë në të njëjtin saf dhe bien në sexhde para Zotit të tyre. Lutjet u mbjellin ndenjë të thellë të disiplinës dhe përujes ndaj udhëheqësit të zgjedhur. Shkurt, namazet na mësojnë të gjitha shkathtësitë, të cilat lejojnë zhvillimin e një jete të pasur individuale dhe kolektive.

Këto janë disa prej begative të panumërta, të cilat mund t'i nxjerrim prej namazeve të përditshme.³

Nëse refuzojmë që të shërbehemi me to, ne jemi vetëm në humbje. Nëse nuk falemi, kjo do të thotë se: nuk e pranojmë namazin si obligim tonin; ose e pranojmë si obligim tonin, por prapëseprapë i ikim këtij obligimi. Në rastin e parë, feja jonë e tillë është rrenë e turpshme, sepse nëse ne refuzojmë të pranojmë urdhrat, me vetë atë refuzojmë edhe Autoritetin e atij, i cili i jep urdhrat. Në rastin e dytë nëse ne pranojmë Autoritetin dhe nuk i përuleni urdhrave të tij, atëherë jemi krijesat më jostabile në tokë. Sepse nëse mundemi ta bëjmë këtë ndaj Autoritetit më të lartë në gjithësi, kush garanton se nuk do të bëjmë të njëjtën në sjelljen tonë ndaj qenieve tjera njerëzore. E nëse në një shoqëri mbisundon tradhtia, çfarë kaosi do të ndodhte në mesin e tyre.

AGJËRIMI

Atë, që namazet e bëjnë pesë herë në ditë, agjërimi e bën një herë në vit gjatë muajit të Ramazanit (muaj i nëntë i vitit hënor). Gjatë kësaj periudhe prej agimit deri në perëndimin e diellit, nuk hamë asnjë thërrmi ushqimi, nuk pimë asnjë pikë ujë, pa marrë parasysh sa jemi të uritur ose të etshëm. Ç'është ajo që na detyron t'i nënshtrohemi një rigoroziteti të tillë? Ajo është besimi në Zotin

³ Më detajisht për natyrën dhe domethënien e namazit shikoni librin në gjuhën urde prej Mevlana Mevdudit: *Ibadat Par Ek Tahgigi Nazar*.

xh.sh. dhe frika prej Tij dhe Ditës së gjykimit. Në çdo moment gjatë agjërimit tonë ne i frenojmë epshet dhe dëshirat tona, dhe me sjelljen tonë vërtetojmë superioritetin e ligjit të Zotit. Kjo vetëdije mbi obligimin dhe durimin, të cilin agjërimi njëmuajor e mbjell në ne, na ndihmon që të forcojmë fenë tonë. Përmbajtja dhe disiplina e ashpër gjatë këtij muaji na vëndosin neve sy më sy me realitetin e jetës dhe na ndihmojnë të bëjmë jetën tonë edhe gjatë muajve tjerë, një jetë me nënshtrim të sinqertë ndaj dëshirës së Tij.

Nga ana tjetër, agjërimi ka ndikim të madh në shoqërinë, sepse të gjithë muslimanët, pa marrë parasysh pozitën e tyre, duhet të agjërojnë gjatë të njëjtit muaj. Kjo shpreh bashkimin e vërtetë të njerëzve dhe krijon në ta ndjenjën edhe më të thellë të dashurisë dhe vëllazërimit. Gjatë Ramazanit e keqja humbet, kurse e mira vjen në plan të parë dhe e tërë atmosfera është e mbushur me devotshmëri dhe pastërti.

Kjo disiplinë na është imponuar për të mirën tonë personale. Përsa u përket atyre, të cilët nuk e praktikojnë këtë obligim themelor, për ta nuk mund të llogaritet se do t'i plotësojnë obligimet tjera të tyre. Por më të këqij janë ata, të cilët gjatë këtij muaji të ndershëm nuk ngurrojnë që të pinë dhe të hanë haptas. Sjellja e tyre tregon se ata nuk u kushtojnë kurrfarë kujdesi urdhrave të All-llahut xh.sh., për të Cilin thonë se i besojnë si Krijues të tyre. Përveç asaj, ata tregojnë po ashtu se nuk janë anëtarë të denjë të bashkësisë islame, thënë më mirë se nuk kanë asgjë të përbashkët me te. Është e sigurt se përsa i përket nënshtrimit në ligjin dhe besimin, të cilin e kemi në to - mund të pritet gjëja më e keqe prej hipokritëve të tillë.

ZEKATI

Obligimi i tretë është Zekati. Çdo musliman, kushtet financiare të të cilit janë përtej minimumit të caktuar, duhet të paguajë në vit 2,5% prej kursimit të tij njeriut të cilit i takon, anëtarit të ri të bashkësisë islame, udhëtarit, borxhliut. Zekati nuk është vetëm në të holla, por edhe në ar, argjend, plaçka, kafshë dhe gjëra të tjera të çmueshme. Shuma e zekatit për tërë këtë mund të gjendet në Fikh, por këtu nuk është përmendur për shkak të kursimit të vendit. Prandaj këtu është përmendur vetëm përqindja në të holla. Duhet të kemi parasysh se Pejgamberi i Zotit ua ndaloi pasardhësve të vet të pranojnë zekat. Edhe pse Hashimitët janë të obliguar të japin zekat atë nuk mund ta pranojnë, bile edhe nëse janë të varfër dhe në skamje. Nëse dikush don të ndihmojë hashimiun e varfër, mund t'i japë vetëm dhuratë. Ai nuk mund të ndihmohet prej kapitalit të zekatit.

Të hollat, të cilat i japim zekat nuk janë diçka që i duhet All-llahut xh.sh., ose që e pranon Ai. Atij asgjë nuk i duhet. Ai neve na premton në mëshirën e Tij të pakufizuar, shpërblime të panumërta, nëse i ndihmojmë të afërmit tanë. Por ai ka vendos aty një kusht themelor. Kur ne japim zekat në emër të All-llahut xh.sh., nuk duhet të presim ndonjë dobi të kësaj bote prej shfrytëzuesit të Zekatit e as që të na dalë zëri i filantropit (person, i cili i don njerëzit dhe kujdeset që të jetojnë mirë).

Zekati është ibadeti themelor në Islam njëlloj si edhe format tjera të ibadetit: salati (namazi) dhe saumi (agjërimi). Rëndësia e tij shtrihet në faktin se ai kultivon në ne shkathtësi për vetëmohim dhe na liron prej egoizmit. Islami pranon nën krahët e tij vetëm ata, të cilët janë të përgatitur që në rrugë të Zotit të japin një pjesë prej të mirave, të cilat i kanë fituar vështirë, vullnetarisht duke

mos pritur kurrfarë dobie personale ose dobi të kësaj bote. Islami nuk ka asgjë të përbashkët me koprracët. Muslimani i vërtetë, kur do të arrijë ftesa, do të japë tërë pasurinë e vet për kënaqësinë e Zotit sepse zekati e ka përgatitur për te.

Shoqëria islame fiton shumë prej institucionit të zekatit. Është detyrë obliguese e çdo të pasuri që të ndihmojë vëllain e varfër. Pasurinë e tij nuk ka të drejtë ta shpenzojë vetëm për konforin dhe luksin e tij personal; edhe të tjerët kanë të drejtë në pasurinë e tij: vejushat dhe bonjakët, të varfërit dhe të paaftit për punë, ata të cilët janë të aftë, por nuk u mjaftojnë mjetet për punë, ata të cilët janë të aftë por nuk kanë pasuri që të arsimohen dhe të bëhen anëtarë të dobishëm të shoqërisë. Ai, i cili nuk e pranon në pasurinë e tij pjesën e anëtarëve të shoqërisë, ai vërtetë është mizor. Sepse nuk mund të ketë mizori më të madhe prej asaj që dikush t'i mbushë valixhet, kurse me mija të tjerë vdesin prej urie ose vuajnë prej papunësisë. Islami është armik i përbetuar i egoizmit, i makutërisë dhe i babëzisë së tillë. Pabesimtarët të shlyer prej ndjenjës së dashurisë universale, dinë vetëm të ruajnë të hollat e tyre dhe t'i shtojnë duke i dhënë me kamatë. Mësimet islame janë plotësisht kundër këtij qëndrimi. Këtu ndahet pasuria me të afërmit dhe u ndihmohet që edhe ata të ngrihen në këmbët e veta dhe të bëhen anëtarë produktivë të shoqërisë.

HAXHXHI

Haxhxhi në Mekke është ibadeti i katërt themelor. Me të janë të obliguar vetëm ata njerëz, të cilët kanë mjete për ta kryer dhe vetëm një herë në jetë. Në Mekke gjendet vendi në të cilin pejgamberi

Ibrahim (a.s.) ndërtoi një shtëpi të vogël që me të madhërohet emri i All-llahut xh.sh.. All-llahu e bekoji atë, duke e emërtuar si shtëpi të Vetën dhe duke e bërë si qendër nga e cila duhet të kthehemi kur falet namazi. Kjo vizitë nuk është vetëm vizitë e thjeshtë mirësjellëse. Ky pelegrinazh ka kushtet dhe lutjet e veta, të cilat duhet të plotësohen dhe të cilat na mbjellin devotshmëri dhe mirësi. Kur nisemi në pelegrinazh, prej nesh kërkohet të frenojmë epsheet tona, të largohemi prej derdhjes së gjakut. Të bëhemi të pastër në fjalët tona si edhe në veprat tona. All-llahu xh.sh. premton shpërblim për sinqeritetin dhe nënshtueshmërinë tonë.

Ky pelegrinazh në një mënyrë të posaçme është ibadeti më i madh. Sepse nëse njeriu në realitet nuk e don Zotin, ai nuk do të merrte një udhëtim aq të gjatë, duke i lënë krejt ata që i do. Pra, ky pelegrinazh dallohet prej të gjitha udhëtimeve tjera. Aty mendimet e tij janë të mbështetura në All-llahun xh.sh., qenia e tij dridhet prej devotshmërisë intensive. Kur arrinë në qytetin e bekuar gjen atmosferën me plot devotshmëri; viziton vendet, të cilat dëshmojnë famën e Islamit, dhe e tërë kjo lë ndikim të pashlyer në shpirtin e tij, të cilin ai e ruan deri në frymën e fundit.

Pastaj si edhe prej ibadeteve, muslimanët mund të kenë dobi të mëdha edhe prej këtij pelegrinazhi. Mekka është qendër ku muslimanët mblidhen një herë në vit dhe diskutojnë për objektet e interesit të përbashkët dhe në një mënyrë të caktuar i gjallërojnë dhe i freskojnë në vete bindjet se të gjithë muslimanët janë të njëjtë dhe se e meritojnë dashurinë dhe ndjenjat e të tjerëve pa marrë parasysh prejardhjen e tyre gjeografike dhe kulturore. Domethënë, Haxhxi i bashkon muslimanët në vëllazërimin ndërkombëtar.

MBROJTJA E ISLAMIT

Edhe pse mbrojtja e Islamit nuk është kategorikisht parim themelor, nevoja për te dhe rëndësia e saj është theksuar shpeshherë në Kur'an dhe në Hadith. Ajo është në masë më të madhe test i sinqeritetit tonë si ithtarë të Islamit. Nëse nuk e mbrojmë atë që e quajmë si shok prej mosmarrëveshjeve dhe sulmeve të armiqve të tij, e as që kujdesemi për te, nëse jemi të udhëhequr me egoizëm, atëherë jemi vetëm shokë të rrejtshëm. Po ashtu, nëse propagandojmë besimin tonë në Islam, domosdo e kemi që me zili të ruajmë prestigjin e Islamit. Udhëheqës yni i vetëm në sjelljen tonë domosdo duhet të jetë interesi i muslimanëve në përgjithësi, ndërsa shërbimi ndaj Islamit, në krahasim me të gjitha kërkesat tona duhet të ketë përparësi.

XHIHADI

Xhihad është një pjesë e kësaj mbrojtjeje të Islamit. Xhihad do të thotë lufta deri në kufijtë e fuqisë sonë. Njeriu, i cili mundohet fizikisht ose shpirtërisht ose shpenzon pasurinë e tij në rrugë të Zotit, është në xhihad. Por në gjuhën e sheriatit, kjo fjalë është e përdorur vetëm për luftë, e cila është vetëm në emër të Zotit kundër torturuesve dhe armiqve të Islamit. Kjo sakrificë më e madhe është obligim i të gjithë muslimanëve.

Por nëse një grup i muslimanëve vullnetarisht shkon në xhihad, e tërë shoqëria është e liruar prej përgjegjësisë. Por nëse askush nuk paraqitet, të gjithë janë fajtorë. Kjo vepër nuk ekziston për

qytetarët e shtetit islam kur ai është i sulmuar prej një shteti të huaj joislamik. Në këtë rast të gjithë janë vullnetarë. Nëse vendi i sulmuar nuk është i fortë aq sa të mbrohet, atëherë është obligim fetar i vendeve islamike fqinje t'i shkojnë në ndihmë: nëse edhe ato nuk korrrin sukses, atëherë muslimanët e tërë botës duhet të luftojnë kundër armikut të përbashkët. Në të gjitha këto raste, xhahadi është obligim themelor i muslimanëve, njëlloj si namazi dhe agjërimi. Ai i cili tërhiqet, është mëkatar. Deklarimi i tij se është musliman, është i dyshimtë. Ai është vetëm hipokrit, i cili bie në provimin e sinqeritetit dhe të gjitha ibadetet e tij janë vetëm tradhti dhe reklamim i kotë i devotshmërisë.

KAPITULLI VI

DINI DHE SHERIATI

Deri më tash u morëm me Dinin ose besimin në Zotin. Tash do të diskutojmë për Sheriatin e Pejgamberit të Zotit (a.s.). Por para së gjithash është e domosdoshme që të shohim dallimin e vërtetë në mes Dinit dhe Sheriatit.

DALLIMI NË MES DINIT DHE SHERIATIT

Në kapitujt e mëparshëm thamë se të gjithë pejgamberët, të cilët janë paraqitur kohë pas kohe, kanë predikuar Islamin, që d.m.th. besimin në Zotin, në të gjitha cilësitë e Tij, në Ditën e gjykimit, pejgamberët, librat dhe se kanë kërkuar që populli të jetojë një jetë të nënshtruar ndaj Zotit të vet. Të gjitha këto përbëjnë Dinin i cili është i përbashkët në mësimet e të gjithë pejgamberëve.

Përveç Dinit, ekziston edhe Sheriati: Kodeksi i hollësishëm i sjelljes ose ligji, i cili përshkruan mënyrat e lutjeve; standardet e moralit dhe jetës, gjërat e lejuara dhe të ndaluara, ligjet të cilat vlerësojnë çka është mirë e çka jo. Një drejtësi e tillë harmonike pati ndërrime dhe plotësime prej kohe në kohë, edhe pse çdo pejgamber pati të njëjtin din, sillte me vete shariat të ndryshëm, i cili u përshtatej kushteve të popullit dhe kohës së vet. Kjo shërben për zhvillimin e civilizimeve të popujve të ndryshëm shekuj me radhë dhe që t'i ngrejë në pikëpamje morale. Procesi përfundon me ardhjen e Muhammedit, i cili solli ligjin final, dedikuar tërë njerëzimit për tërë kohët. Dini nuk pati kurrfarë ndërrimi, por tash të gjitha shariatet e mëparshme u revokuan, ekziston vetëm sheriat i përgjithshëm të cilin na e solli Muhammedi (a.s.). Ky është kulmi, fundi i procesit të madh të formimit i cili filloi në agimin e erës njerëzore.

BURIMET E SHERIATIT

Ekzistojnë dy burime, ku gjenden burimet e sheriatit të Muhammedit (a.s.): Kur'ani dhe Hadithi. Kur'ani është shpallja e Zotit, çdo fjalë e tij është prej All-llahut xh.sh.. Hadithi është përmbledhja e udhëzimeve dhe vërejtjeve të përcjellura prej Pejgamberit të fundit, si i kanë ruajtur ata të cilët kanë jetuar me të ose ata të cilëve u janë transmetuar nëpërmjet dëshmitarëve të sinqertë. Këto tekste pastaj janë të pastruara dhe të tubuara në përmbledhje në mes të të cilave më autentik janë: Përmbledhja e Malikut, e Buhariut, e Muslimit, e Tirmidhiut, e Ebu Davudit, Nesaiut dhe e Ibni Maxhes.

FIKHU

Ligjin e plotë që rrjedh prej Kur'anit dhe Hadithit përsa u përket problemeve të shumta, të cilat mund të paraqiten në jetën e njeriut, e kanë hartuar disa fukaha më eminentë në të kaluarën. Popujt islamikë gjithmonë do t'u jenë falënderues këtyre njerëzve të ditur dhe mendjemprehtë, të cilët jetën e vet ia kushtuan studimit dhe analizës së Kur'anit dhe Hadithit duke ia lehtësuar ashtu çdo muslimani që të përshtatë sjelljen e tij të përditshme sipas kërkesave të sheriatit. Duke iu falënderuar atyre, muslimanët kudo në botë mund të ndjekin lehtë sheriatin edhe pse njohja e tyre e fesë asnjëherë nuk do të lejojë që t'i interpretojnë drejtpërdrejt Kur'anin dhe Hadithin.

Në fillim numër i madh i të parëve fetarë iu përkushtuan kësaj detyre. Tash mund të përmendim vetëm katër shkollat kryesore të drejtësisë:

- a) Fikh - Hanefi: Ky është fikhu, të cilin e ka hartuar Ebu Hanife Numan ibn Thabit, me ndihmën e Ebu Jusufit, Muhammedit, Zuferit dhe të tjerëve, të gjithë të përmendur me njohjen e tyre të thellë të çështjeve fetare. Ai është i njohur nën emrin: Fikhu i shkollës Hanefite.
- b) Fikh - Maliki: Malik ibn Enes el- Asbahi
- c) Fikh - Shafi: Muhammed ibn Idris esh- Shafi
- d) Fikh - Hanbeli: Ahmed ibn Hanbeli.

Që të katër fikhët, në format e tashme, janë të hartuar dyqind vjet pas vdekjes së Pejgamberit. Nëse ekziston ndonjë dallim në mes tyre, ajo është vetëm se e vërteta është e shumanshme. Kur persona të ndryshëm e interpretojnë një ndodhi, çdonjëri prej tyre e sqaron sipas koncepteve të tij personale.

Ajo, që këtyre shkollave të ndryshme u jep autenticitet është tërësia e themeluesve të tyre dhe burimi i metodave, të cilat i kanë pranuar. Prandaj të gjithë muslimanët pa marrë parasysh cilës shkollë i takojnë, i konsiderojnë që të katër shkollat si të drejta dhe të vërteta. Edhe pse të katër shkollat janë të vlefshme në jetë, mund të ndiqet vetëm njëra. Por ekziston grupi i Ehli- Hadithit, i cili konsideron se ata, të cilët kanë dituri të saktë mund të kalojnë drejtpërdrejt në Kur'an dhe Hadith, që prej aty të dedukojnë udhëzime. Ata të cilët nuk janë përgatitur me dituri të thellë dhe aftësi të këtilla do të ndjekin udhëzimet sipas zgjedhjes së vet për një lëndë të tillë individuale.

TESAVVUFI

Fikhu merret me sjelljen e jashtme të njeriut, me të kryerit e obligimit pikë për pikë. Krejt ajo që ka të bëjë me kuptimin e sjelljes së njeriut është Tesavvuf. P.sh. kur ne i kryejmë lutjet tona (namazin) Fikhu gjykon vetëm për kërkesat e jashtme siç janë abdesti, të kthyerit nga Kibleja, koha dhe numri i rekateve, ndërsa Tesavvufi gjykon për namazet tona nga ana e koncentrimit, devotshmërisë, pastërtisë së shpirtit tonë dhe efektit të namazit në moralin dhe në mënyrën e sjelljes. Pra Tesavvufi i vërtetë islamik është masë e shpirtit tonë të nënshtrueshmërisë dhe sinqeritetit, ndërsa Fikhu me vëmendje kujdeset si i ndjekim rregullat në detajet e tyre. Ibadeti pa shpirt, pa bindje të thellë edhe pse i saktë në procedurë, është si njeriu i bukur në formën e jashtme, por pa karakter; Ibadeti me bindje të thellë, por i kryer pa i respektuar rregullat, është si njeriu fisnik dhe i karaktershëm në formën e jashtme, por i deformuar.

Shembulli i lartpërmendur sqaron dallimin e Fikhut dhe Tesavvufit. Por për fat të keq, muslimanët me kohë bien në lëmin e diturisë dhe karakterit, ata i nënshtrohen filozofisë së devijuar të superfuqive që sundojnë në atë kohë, të cilët pranojnë fenë e tyre vetëm që të deformojnë dhe të përhapin dogmat e tyre të shtrembëruara në fenë e tyre.

Ata e ndërrojnë pastërtinë e Tesavvufit islamik me pakuptimësi, e cila nuk mund të vërtetohet me të menduarit në bazë të Kur'anit dhe Hadithit. Gradualisht paraqitet një grup i muslimanëve, i cili e mban veten mbi kërkesat e Sheriatit. Këta njerëz nuk kanë lidhje me Islamin sepse Islami nuk pranon Tesavvufin, i cili largohet dhe devijon prej sheriatit. Asnjë sufi nuk ka të drejtë të cenojë kufijtë e sheriatit ose të veprojë pa vëmendje me obligimet themelore (farzet) siç janë: namazi, agjërimi, zekati, haxhxi. Në kuptim të drejtë Tesavvufi është vetëm dashuri intensive ndaj All-

llahut xh.sh. dhe Muhammedit (a.s.), kurse dashuria e tillë kërkon nënshtrim të plotë ndaj urdhrave të tyre të sqaruara në Kur'an dhe Sunnet. Çdonjëri, i cili largohet prej këtyre urdhrave të Zotit, gënjen kur thotë se e don All-llahun dhe Pejgamberin e Tij.

KAPITULLI VII

PARIMET E SHERIATIT

Diskutimi ynë lidhur me themelet e Islamit do të mbetet i mangët sikur të mos e shqyrtonim ligjin e Islamit, nëse nuk do t'i studionim parimet e tij themelore, nëse nuk orvatemi që të përshtojmë tipin e njeriut dhe të shoqërisë, të cilët Islami dëshiron t'i prodhojë. Në këtë kapitull të fundit, kemi për qëllim të analizojmë parimet e sheriatit që të rrumbullakojmë kuptimin tonë për Islamin dhe të mund të kuptojmë përparësinë e mënyrës së jetës islamike.

SHERIATI : NATYRA DHE QËLLIMI I TIJ

Njeriu është dhuruar me një numër të madh të përparësive dhe të aftësive. Në këtë aspekt All-llahu xh.sh., është treguar mjaft bujar ndaj tij. Ai posedon logjikë, urti, dëshirë, aftësi të të pamurit, të të folurit, të shijuarit, të prekurit, aftësi të ndërtojë vendin, të shfrytëzojë duart e tij, dashuri, hidhërim, frikë etj. Tërë kjo është e dobishme për te dhe asgjë nuk është e tepërt. Këto

aftësi i janë të dhuruara sepse i janë mjaft të nevojshme. Jeta dhe suksesi i tij varen prej përdorimit të përshtatshëm të këtyre aftësive që të kënaqë dëshirat dhe nevojat e tij. Këto kapacitete, të cilat ia dha All-llahu xh.sh., janë të destinuarat t'i shërbejnë atij dhe nëse nuk janë të shfrytëzuara në masë të plotë, jeta nuk ka kurrfarë vlere.

Zoti xh.sh. po ashtu i ka dhënë njeriut të gjitha mjetet dhe pasuritë e duhura që t'i funksionalizojë aftësitë e veta natyrore dhe që të arrijë të kënaqë nevojat e veta.

Trupi i njeriut është i përbërë në atë mënyrë që ai është instrument i parë kryesor i njeriut në luftën e tij për plotësimin e qëllimit të tij jetësor. Pastaj ekziston bota ku jeton njeriu, rrethina e së cilës përmban mjete të të gjitha llojeve si dhe dhunti, të cilat ai i shfrytëzon si instrumente për arritjen e qëllimeve të tij. Natyra dhe krejt ajo që i përket asaj, është e adaptuar për te dhe ai mund çdo gjë të shfrytëzojë. Ekzistojnë edhe njerëz të ngjashëm me te ashtu që ata mund të bashkëpunojnë njëri me tjetrin në ndërtimin e jetës më të mirë dhe më të lumtur.

Të mendojmë tash pak më thellë për këtë fenomen. Këto aftësi dhe këto mundësi ju kanë dhënë juve që t'i shfrytëzoni për të mirën e të tjerëve. Ato janë të krijuara për të mirën tuaj e jo që t'ju shkatërrojnë e të ju dëmtojnë. Funkzioni i tyre është që të sjellin të mirë dhe shkathtësi e jo që të ju shpiejnë në rrezik. Pra përdorimi pozitiv i këtyre aftësive është ajo, që i bënë këto për ju mirëbërëse, bile edhe nëse aty ka ndonjë pengesë, nuk duhet të kalojmë minimumin e pashmangshëm. Vetëm kështu është përdorimi i përshtatshëm i këtyre aftësive. Çdo përdorim tjetër nëse sjell deri në prishje dhe shkatërrim është i keq, i palogjikshëm dhe i dëmshëm. P.sh. nëse bëni diçka që ju dëmton ose ju sjell dhembje, ajo thjeshtë do të ishte gabim. Ose nëse veprat tuaja i dëmtojnë të tjerët dhe u sjellin atyre fatkeqësi, ajo është keqpërdorim i aftësive të dhëna

prej Zotit. Nëse ju i prishni mjetet, i shkatërroni së koti, ajo është mashtrim i rëndë nga ana juaj. Aktivitetet e tilla janë thjeshtë të pakuptimta, sepse vetë logjika e njeriut këshillon se shkatërrimit dhe së keqes duhet t'i iket, dhe të ndiqet rruga e dobisë dhe e suksesit. Dhe nëse bëhet diçka e keqe, ajo duhet të bëhet vetëm në rast, kur ajo është e pashmangshme dhe kur dobia është më e madhe. Çdo kthim prej kësaj do të ishte drejtim i gabuar.

Nëse kemi parasysh këtë shqyrtim themelor dhe nëse analizojmë gjininë njerëzore, gjejmë dy kategori njerëzish:

- 1) Ata, të cilët me qëllim keqpërdorin aftësitë dhe mundësitë e tyre. Për shkak të këtij keqpërdorimi i prishin, i dëmtojnë interesat e tyre personale jetësore, dhe shkaktojnë dënimin e të tjerëve.
- 2) Ata, të cilët janë të sinqertë dhe qëllimmirë, por devijojnë për shkak të paditurisë.

Ata, të cilët qëllimisht i keqpërdorin aftësitë e veta, janë të këqij dhe të prishur dhe meritojnë ashpërsinë e ligjit për shkak të përmirësimit dhe mbikëqyrjes së tyre. Atyre, të cilët devijojnë prej paditurisë u duhet dituri e vërtetë dhe udhëzim që të mund të shohin Rrugën e Drejtë dhe sa më mirë t'i shfrytëzojnë aftësitë dhe mundësitë e tyre. Edhe ligji i sjelljes - Sheriati - të cilin All-llahu xh.sh., ia zbuloi njeriut, pajtohet me këtë nevojë.

Sheriati paraqet ligjin e Zotit dhe jep udhëzime për rregullimin e jetës në interes më të mirë të njeriut. Qëllimi i tij është t'ia tregojë njeriut rrugën më të mirë dhe t'i japë mjete që t'i kënaqë nevojat e veta në mënyrën më të mirë. Ligji i Zotit është plotësisht në dobinë tuaj. Në te nuk ka asgjë që ju çon në prishjen e aftësive tuaja ose që i ngatërron nevojat tuaja, emocionet tuaja ose

dëshirat tuaja natyrore. Ai nuk paraqet asketizmin (murgërinë). Ai nuk thotë: Lëshojeni këtë botë, largohuni prej çdo komforti (komoditeti) në jetë, lëshoni shtëpitë tuaja, drejtohuni nga shkretëtirat, malet ose pyjet pa ushqim dhe veshmbathje. Ai nuk propozon as teprim ose vetëshkatërrim. Ky shikim nuk ka asgjë të përbashkët me ligjin islamik, me ligjin të cilin e ka hartuar Zoti xh.sh., i cili i adaptoi të gjitha gjërat në dobi të njeriut. Ai nuk do të dëshironte ta shkatërrojë krijesën e Tij. Ai nuk i dha njeriut kurrfarë aftësie, e cila është e padobishme ose e tepërt. Ai asgjë nuk krijoi as në qiell as në tokë që nuk i shkon në interes njeriut. Ajo është dëshira e tij kategorike që gjithësia, kjo punëtori e madhe me aktivitetet e llojllojshme të saj të vazhdojë të funksionojë në mënyrë harmonike ashtu që njeriu, kurora e krijimit, të mundet më mirë dhe më me leverdi të shfrytëzojë aftësitë dhe mundësitë e tij, krejt atë që i është dhënë në qiell e në tokë. Ai duhet të shfrytëzojë atë në atë mënyrë që ai dhe të ngjashmit me te të mund të mbledhin fryte të mira dhe mos t'u shkaktojnë asnjëherë qëllimisht ose pa qëllim, kurrfarë të keqe krijesave të Zotit. Sheriati ka për qëllim të udhëheqë njeriun në këtë drejtim. Ai ndalon gjithë atë që është e dëmshme për njeriun, ndërsa lejon dhe urdhëron gjithë atë që është e dobishme.

Parimi themelor i ligjit është që njeriu ka të drejtë, kurse në raste të posaçme ajo është detyrë obliguese e tij t'i kënaqë krejt nevojat dhe dëshirat dhe të orvatet me mish e me shpirt që të sendërtojë interesat e tij dhe të arrijë sukses dhe fat: por (e kjo “por” është mjaft me rëndësi) ai duhet të mundohet me të gjitha forcat jo vetëm që interesat e të tjerëve të mos lëndohen dhe të mos shkaktohet kurrfarë padrejtësie në orvatjet e tyre për kënaqjen e të drejtave dhe obligimeve të tyre personale, por me tërë kohezionin e tij shoqëror, me ndihmën reciproke dhe bashkëpunimin me njerëzit për suksesin e qëllimeve të tyre të përbashkëta. Sikur që në këto sende janë të përziera e mira dhe e keqja, fitimi dhe humbja, parimi i ligjit është që të zgjedhet më pak e keqe

në emër të fitimit më të madh dhe të flijohet interesi i vogël që t'i iket së keqes më të madhe. Kjo është ideja kryesore e shariatit.

Dimë se dija e njeriut është e kufizuar. Çdo njeri, në çdo kohë, nuk di as vetë ç'është e mirë e ç'është e keqe, ç'është e dëmshme e ç'është e dobishme.

Burimet e dijes së njeriut janë shumë të kufizuara që t'ia paraqesin të vërtetën. Prandaj All-llahu xh.sh. e ruajti prej rrezikut të sprovës dhe nënshtrimit dhe ia zbuloi ligjin e tij, i cili është ligj i plotë dhe i vërtetë për tërë gjininë njerëzore. Me kohë shkathtësitë dhe të vërtetat e këtij ligji i bëhen njeriut gjithnjë e më të qarta. Para disa shekujsh numër i madh i përparësive të tij ishin të paqarta për njeriun, ndërsa përparimi i shkencës i nxori në pah ato. Bile edhe sot njerëz të posaçëm nuk i kuptojnë krejt meritat e këtij ligji, por përparimi i mëtutjeshëm do të hedh dritë të re dhe do të shprehë superioritetin e tij. Bota me të mirë ose me dhunë drejtohet në rrugën të cilën që moti e ka trasuar ligji i Zotit. Shumë njerëz, të cilët kanë refuzuar ta pranojnë, tash pas devijimit të gjatë janë të detyruar të përvetësojnë dispozita të caktuara të këtij ligji. Ata, të cilët e mohojnë saktësinë e Shpalljes dhe i besojnë logjikës sonë të dobët pasi që bëjmë gabime dhe përjetojmë përvoja jo të volitshme, përvetësojnë në mënyrë të caktuar urdhrat e shariatit. Por çfarë humbje! Edhe tash e bëjnë atë pjesërisht!

Nga ana tjetër, ka njerëz, të cilët besojnë në peygamberët e Zotit, pranojnë fjalët e tyre dhe përvetësojnë shariatin, duke e njohur mirë lëndën. Nganjëherë ata nuk janë të vetëdijshëm për vlerat ose domethëniet e kësaj ose asaj dispozite, por marrë në tërësi ata pajtohen me ligjin, i cili është rezultat i dijes së vërtetë dhe i cili vuan prej së keqes dhe prej gabimeve të paditurisë, prej sprovës dhe mashtrimit. Këta njerëz janë në rrugë të drejtë dhe atyre u takon shpërblimi.

Para katërmbëdhjetë shekujve, Sheriati ia tregoi njeriut të vërtetën e pastër. Por me logjikën e tij të paaftë, njeriu tash vëren këto të vërteta, pasi që i nënshtroi qindra miliona njerëz segregacionit të padrejtë, pasi që e degradoi njeriun dhe e prishi shoqërinë me shekuj. Sheriati është rruga më e shkurtër dhe më e rëndomtë kah realiteti dhe duke e refuzuar, i nënshtrohen mossuksesit dhe kaosit të plotë.

SHERIATI: TË DREJTAT DHE OBLIGIMET

Modeli i jetës, të cilin e përshkruan Islami, përbëhet prej një varg të drejtash dhe obligimesh dhe çdo genie njerëzore, e cila përvetëson këtë fe, duhet t'i adaptohet atyre.

Në përgjithësi, ligji islamik ia ngarkon njeriut katër lloje të drejtësisë dhe obligimeve:

- 1) Obligimi ndaj Zotit, të cilin çdo njeri është obliguar ta plotësojë.
- 2) Obligimi i njeriu ndaj vetvetes.
- 3) Të drejtat e të tjerëve ndaj tij.
- 4) Të drejtat në mjetet materiale, të cilat All-llahu xh.sh. ia la në disponim dhe lejoi që t'i shfrytëzojë për mirëqenien e tij.

Këto të drejta dhe obligime e përbëjnë gurin themeltar të Islamit, ndaj kjo është detyrë e domosdoshme e çdo muslimani të vërtetë që t'i kuptojë dhe t'u nënshtrohet me vetëdije. Sheriati

shqyrton qartë çdo lloj drejtësie dhe e përpunon detajisht. Ai hedh dritë në mjetet me ndihmën e të cilave mund të plotësohen këto obligime - ashtu që të gjitha obligimet tona mund të plotësohen dhe asnjëri prej tyre të mos tejkalohet ose të mos merret parasysh. Ne tash shkurtimisht do të diskutojmë për këto drejta dhe këto obligime që të japim një pasqyrë të mënyrës së jetës në Islam dhe për vlerat themelore të tij.

OBLIGIMET NDAJ ZOTIT XH.SH.

Para së gjithash duhet të studiojmë bazat në të cilat, sipas Islamit, mbështeten marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin e tij. Obligimi kryesor, të cilin njeriu e ka ndaj Zotit xh.sh. është të besojë në Të, të pranojë autoritetin e Tij dhe mos t'i shoqërojë Atij askë. Kjo është e përmbledhur në Kelimenë: La ilahe il-lall-llah (nuk ka zot tjetër, përveç All-llahut, Kapitulli IV).

Obligimi ynë i dytë ndaj Zotit është të pranojmë sinqerisht dhe të ndjekim udhëzimin e Tij (Hidajetin) - ligjin të cilin Ai ia zbuloi njeriut - dhe të kërkojmë kënaqësinë e Tij me gjithë zemër e me shpirt. Ne e plotësojmë këtë obligim duke besuar në Pejgamberin e Zotit dhe duke e pranuar atë për udhëheqës dhe udhërrëfyes (Kapitulli III).

Obligimi ynë i tretë ndaj Zotit është T'i nënshtrohemi me plot vetëdije dhe në mënyrë të pakushtëzuar. Këtë obligim e plotësojmë duke ndjekur ligjin e Zotit, siç është i përmbajtur në Kur'an dhe në Sunnet (Kapitulli IV).

Obligim ynë i katërt ndaj Zotit është Ta adhurojmë. Kjo kryhet me faljen dhe ibadetet tjera siç është përshkruar më herët, (Kapitulli V).

Këto detyra dhe këto obligime kanë përparësi për obligimet tjera: si të tilla ato duhet të plotësohen, bile edhe në dëm të obligimeve dhe detyrave tjera. P.sh. duke u falur dhe agjëruar, njeriu patjetër duhet të largohet prej shumë të drejtave personale. Ai duhet të orvatet dhe të sakrifikojë veten që t'i kryej këto obligime ndaj Zotit xh.sh.. Duhet të zgjohet herët në namaz duke e sakrifikuar gjumin dhe pushimin e tij. Gjatë ditës, ai shpesh i vonon punët e tij të rëndësishme që të adhurojë Krijuesin e Tij. Gjatë Ramazanit (muajit të agjërimin) ai duron urinë dhe të gjitha llojet e moskënaqësive, vetëm që të arrijë kënaqësinë e Zotit. Duke dhënë zeqat, ai humb në pasurinë e tij, por vërteton se dashuria e tij ndaj Zotit është mbi çdo gjë dhe se dashuria ndaj të hollave aty nuk bën pengesa. Duke e kryer Haxhxhin ai duhet të sakrifikojë edhe pasurinë e tij edhe të ballafaqohet me vështirësitë e udhëtimit. Edhe duke bërë Xhihadin ai flijon të hollat, materialin dhe krejt çka ka - bile edhe jetën e tij.

Po ashtu në kryerjen e këtyre obligimeve duhet të flijojë më shumë ose më pak, disa prej të drejtave të të tjerëve dhe ashtu të dëmtojë interesat e tyre personale në përgjithësi. Shërbëtori duhet të lëshojë punën e tij që të prezentojë në namaz. Tregtari duhet të ndërpresë punët tregtare që të kryejë Haxhxhin në Mekke. Në xhihad njeriu flijon jetën e tij vetëm për Zotin xh.sh.. Në të njëjtën mënyrë që të kryejë obligimet e tij ndaj Zotit njeriu duhet të sakrifikojë shumë sende, të cilat i përjeton dhe të cilat i ka në disponim, si kafshët, pasurinë etj. Por Zoti ka formuluar shariat ashtu që gjendet një ekuilibër dhe harmoni në të gjitha llojet e jetës ku sakrifikimi i të drejtave të të tjerëve është në minimum. Kjo është arritur duke u falënderuar kufijve, të cilët i ka përbashkuar All-llahu xh.sh.. Ai na ka lejuar të gjitha lehtësimet gjatë kryerjes së obligimit të

namazit. Nëse nuk kemi ujë për abdest, ose nëse jemi të sëmurë, mund të marrim tejjemmum. Nëse jemi në udhëtim mund ta shkurtojmë namazin. Nëse jemi të sëmurë dhe nëse nuk mundemi të falemi në këmbë, mund të falemi ulur ose të shtrirë. Nga ana tjetër, leximi i Kur'anit në namaz është i rregulluar ashtu që namazi mund të jetë më i shkurtër, ose më i gjatë, sipas dëshirës: gjatë pushimit dhe komoditetit- mund të lexojmë sure (kaptina) të gjata prej Kur'anit; në çastet kur jemi shumë të ngarkuar me punë, mund të lexojmë vetëm disa ajete. Ose, më saktë është dispozitë, që leximi në namaz me xhemat dhe në namazet gjatë kohës së punës të jetë i shkurtër. All-llahu xh.sh., pëlqen leximin e bërë jashtë obligimit (nafilë), por Ai është kundër asaj që ne mos të flejmë e mos të pushojmë, dhe mos të kryejmë obligimet tona ndaj fëmijëve dhe shtëpisë sonë. Islami dëshiron që ne gjithmonë të mbajmë baraspeshën në mes aktiviteteve të ndryshme jetësore.

Ngjashëm është me agjërimin; vetëm një muaj në vit i është kushtuar agjërimit të obligueshëm. Gjatë udhëtimit ose sëmurjes mund të mos agjëroni dhe ditët e lëshuara të agjërohen në një periudhë më të volitshme të vitit. Gratë mund të shtyjnë agjërimin për më vonë kur janë në gjendje të bekuar, kur u japin gji fëmijëve dhe kur kanë pastrim mujor. Agjërimin duhet ta ndërpresim në kohë të caktuar dhe çdo zgjatje gjykohe. Është e lejuar të hahet prej perëndimit të diellit e deri në agim. Agjërimi, i cili nuk është i obligueshëm, tek All-llahu çmohet shumë, por nuk dëshiron që të agjëroni shumë shpesh, të dobësoheni aq saqë mos të mundeni të kryeni si duhet punët tuaja të përditshme.

I njëjtë është rasti edhe ma zekatin; All-llahu xh.sh., vetë e caktoi taksën minimale dhe njeriu është i lirë që të shpenzojë mbi këtë përqindje sa të dëshirojë në rrugë të Zotit. Nëse jep zekat, e plotëson obligimin e vet, por nëse shpenzon ende në vepra të mira, vërteton edhe më shumë se

kërkon kënaqësinë e Zotit xh.sh.. Por All-llahu nuk dëshiron që ne të flijojmë të mirat tona si përdëllesë ose vetes dhe të afërmeve tanë t'ua ndërpresim ato të drejta dhe komoditete, të cilat ata duhet t'i gëzojnë. Ai nuk dëshiron që ne të varfërohemi. Na ka propozuar që të jemi modestë bile edhe në lëmin e përdëllimit.

Menjëherë të shqyrtojmë Haxhxhin. Ai është i obligueshëm vetëm për ata, të cilët kanë mjete për rrugë dhe të cilët janë të aftë fizikisht që të durojnë mundimet e udhëtimit. Haxhxhi është i obligueshëm një herë në jetë. Nëse shpërthen lufta, ose çfarëdo situatë e rrezikshme, Haxhxhi mund të shtyhet për më vonë. Përveç asaj, kusht i rëndësishëm është leja e prindërve, ashtu që prindërit e vjetër mos të ndjejnë moskënaqësi në mungesën tuaj. Tërë kjo tregon qartë se sa rëndësi i kushtoi vetë All-llahu xh.sh. të drejtave të të tjerëve, pos të drejtave të Tij personale.

Sakrificat më të madhe për Zotin është Xhîhadi, sepse njeriu aty flizon jo vetëm jetën dhe pasurinë, por shkatërron po ashtu edhe jetën dhe pasurinë e të tjerëve. Por, siç është thënë, njëri prej parimeve islamike është se do të durojmë më së vogël që të shpëtojmë prej dëmit më të madh. A mund të krahasohet humbja e disa jetëve të njerëzve- bile edhe një mijë e më tepër- me fatkeqësinë, e cila mund të kaplojë njerëzimin si rezultat i ngadhënjimit të së keqes ndaj të mirës dhe ateizmit agresiv prej fesë së Zotit. Kjo me të vërtetë është humbje më e madhe dhe fatkeqësi më e madhe, sepse do të kishim si rezultat jo vetëm atë që feja e Zotit do të nënçmohet, por edhe bota do të bëhet mbretëri e amoralitetit dhe degjenerimit dhe jeta do të ishte e çrregulluar si jashtë ashtu edhe brenda. Që t'i iket këtij dëmi të madh Zoti xh.sh. urdhëroi pra, të flijojmë jetën dhe pasurinë për kënaqësinë e Tij. Por Ai njëkohësisht na ndaloj që të derdhim gjak pa nevojë, të sulmojmë pleqtë, gratë, fëmijët, të sëmurët dhe të plagosurit. Urdhër i Tij është të luftojmë vetëm kundër sulmuesve. Ai neve na urdhëron të mos bëjmë shkatërime të panevojshme në territorin e

armikut dhe me të mundurit të veprojmë ndershëm dhe drejtë. Na ka dhënë udhëzime të nderojmë marrëveshjet e bëra me armikun dhe të ndërprejmë luftën kur edhe armiku e ndërpret, ose nëse largohet prej aktiviteteve të tij antiislamike. Pra Islami lejon vetëm minimum të flijimit të jetës, të pasurisë dhe të së drejtës së të tjerëve në kryerjen e obligimeve tona ndaj Zotit xh.sh.. Ai dëshiron të vendosë baraspeshim ndërmjet nevojave të ndryshme të njeriut dhe të adaptojë të drejtat dhe obligimet ashtu që jeta të jetë e pasuruar me vlera dhe arritje më të zgjedhura.

TË DREJTAT PERSONALE

Pastaj vijnë të drejtat personale të njeriut. Është fakt se njeriu shpeshherë është më i padrejtë dhe më mizor ndaj vetvetes se sa ndaj ndonjë qenieje tjetër njerëzore. Në shikim të parë kjo mund të duket mjaft i çuditshme: si mund njeriu të jetë i padrejtë ndaj vetvetes, kur dihet se ai vetveten e don më shumë se çdo gjë? Si mund ai të jetë armiku i vetvetes? Kjo duket mjaft e pakuptimtë. Por duke menduar më thellë për këtë do të shohim se është e vërtetë.

Dobësia më e madhe e njeriut është që kur ndjen një dëshirë të parëzistueshme në vete, në vend që të largohet prej saj ai i nënshtrohet dhe duke iu kushtuar asaj i shkakton dëm vetvetes.

Të marrim shembullin e njeriut, i cili jepet pas pijes: Atij i kanoset rreziku i çmendjes, por ai vazhdon të pijë në dëm të xhepit të tij, të shëndetit të tij, të autoritetit dhe të krejt asaj që posedon. I dyti është aq lakut saqë me pamaturinë e tij për bagëtinë e shkatërron shëndetin e tij dhe e rrezikon jetën e tij. I treti bëhet rob i instinkteve të tij seksuale. I katërti është i ngarkuar me

nevojën e ngritjes shpirtërore: ai frenon kërkesat e tij, refuzon të kënaq kërkesat dhe nevojat e tij fizike, e mbizotëron oreksin, largohet prej veshjes, braktisë shtëpinë e vet dhe tërhiqet në male ose pyje. Ai beson se bota nuk është e krijuar për te: ai skandalizon mbi të gjitha format dhe manifestimet e tij.

Ja pra, disa shembuj të prirjes së njeriut që të shkojë në ekstremitet. Mund të përmendim shumë shembuj të ngjashëm të tërheqjes dhe çekuilibrimit në jetën e përditshme, por kjo nuk është e nevojshme këtu.

Islami propagandon mirëqenien e njeriut dhe qëllimi i tij i qartë është të vendosë një baraspeshim në jetën e njeriut. Prandaj sheriatu deklaron qartë se edhe trupi juaj personal ka të drejta të caktuara në ju. Njëri prej parimeve themelore është: “Trupi juaj ka të drejta mbi ju”.

Sheriatu ndalon përdorimin e të gjitha gjërave, të cilat janë të dëmshme për ekzistencën fizike, shpirtërore dhe morale të njeriut. Ai ndalon gjakun, drogën, mishin e derrit, shpezët grabitqare, kafshët helmuese, cofëtinën sepse të gjitha këto kanë pasoja të padëshiruara në jetën fizike, morale, intelektuale dhe shpirtërore të njeriut. Derisa i ndalon këto gjëra e urdhëron të shfrytëzojë tërë atë që është e pastër dhe e shëndoshë, si dhe kërkon prej tij që mos ta largojë trupin e tij prej ushqimit të pastër, sepse trupi i tij po ashtu ka të drejtë për to. Ligji islamik ndalon zhveshurinë dhe urdhëron veshjen si ka hije. Ai e nxit të fitojë për jetë, kurse e gjykon papunësinë dhe përtacinë. Në shpirtin e sheriatit është që njeriu të shfrytëzojë për komoditetin e vet, aftësitë të cilat All-llahu xh.sh. ia dha dhe pasuritë të cilat Ai kudo i ka mbjellë.

Islami nuk predikon as ndalimin e kërkesave seksuale: vetëm ai urdhëron njeriun t'i kontrollojë dhe t'i realizojë vetëm në kurorë. E ndalon t'i struket vetëmohimit dhe e lejon të mbetet i

devotshëm dhe i fortë gjatë problemeve jetësore. Që të kërkojmë ngritje shpirtërore, pastërti morale, afërsinë e Zotit dhe shpëtim në botën tjetër, nuk ka nevojë të shmangemi prej kësaj bote. Përkundër, sprova e njeriut bëhet në këtë botë dhe ai këtu duhet të ndjekë rrugën e Zotit. Rruga e suksesit përbëhet në ndjekjen e ligjit të Zotit, në pajtim me jetën e jo jashtë saj.

Islami ndalon ashpër vetëvrastjen dhe e lajmëron njeriun se jeta e tij i takon Zotit; ajo është si emanet të cilin Zoti ia besoi për një kohë të caktuar që sa më mirë të jetë e mundur ta shfrytëzojë - ajo (jeta) nuk është i dhënë të shkatërrohet me mendjelehtësi.

Kështu Islami i tregon njeriut se personaliteti i tij, uni i tij posedon të drejta të posaçme dhe se obligim i tij është t'i plotësojë sa më mirë të mundet, në atë mënyrë që e ka sqaruar sheriati.

TË DREJTAT E TË TJERËVE

Nga njëra anë, sheriati e urdhëroi njeriun të plotësojë të drejtat e veta dhe të jetë i drejtë ndaj vetvetes, e thirrri që t'i plotësojë ashtu që mos të rrënojë në te të drejtat e të tjerëve; nga ana tjetër sheriati u mundua të vendosë ekuilibër ndërmjet të drejtave individuale dhe të drejtave shoqërore në atë mënyrë që të mos paraqitet përleshje në mes tyre dhe që çdo gjë të kontribuojë për vendosjen e ligjit të Zotit.

Islami ndaloi rreptësisht gënjeshtrenë në të gjitha format e saj, sepse ajo e poshtëron atë që gënjën, i dëmton të tjerët dhe paraqet pengesë për shoqërinë. Rreptësisht ndaloi vjedhjen, korrupsionin,

falsifikimin e të hollave, mashtrimin, kamatën, sepse tërë atë që njeriu fiton në këtë mënyrë, ai në realitet e ka fituar duke i shkaktuar humbje dhe dëm tjetrit. Përgojimi, shpifja janë të ndaluara. Bixhozi, lotoja, bursa e zezë dhe të gjitha lojërat e fatit të rrezikshëm (bixhozi, lotoja) etj., janë të ndaluara sepse në të gjitha këto gjëra, fituesi pasurohet në llogari të mijëra të tjerëve, të cilët humbin. Të gjitha format e tregtisë eksploatuese janë të ndaluara, ku mijëra palë tjera duhet të humbin. Monopoli, tezaurizacioni (grumbullimi i të hollave), bursa e zezë, spekulimi me tokë, dhe të gjitha format e pasurimit individual ose shoqëror jashtë ligjit janë të ndaluara. Vrasja, gjakderdhja, nxitja në shkatërrim dhe kaos konsiderohen si vepra të këqija, sepse askush nuk ka të drejtë të marrë jetën ose pasurinë e tjetrit vetëm për dobinë e tij personale ose për kënaqësinë e tij personale. Adulteria (shkelja e kurores), aventura dhe homoseksualizmi janë të ndaluara rreptësisht, sepse jo vetëm që prishin moralin dhe shkatërrojnë shëndetin e atij, i cili bën këto vepra të këqija, por edhe prishja dhe çoroditja e shoqërisë zgjerohet, lindin sëmundjet venerike, rrënohet shëndeti dhe morali i gjeneratave të ardhshme dhe strukturat shoqërore të bashkësisë.

Të gjithë këto përkufizime i përshkruan Islami që ta pengojnë njeriun të cenojë të drejtat e tjetrit. Islami nuk dëshiron që njeriu të bëhet egoist dhe egocentrik deri në atë masë që pa vetëdije të shkelë të drejtat e tjetrit dhe të shkelë parimet morale që të kënaqë shpirtin dhe trupin e tij. Islami nuk e lejon as që të përmbysë interesat e të tjerëve që të ruajë të drejtat e veta personale. Islami rregullon jetën ashtu që çdonjërit mund t'i garantohet mirëqenie.

Por për arritjen e mirëqenies njerëzore dhe për përparimin e civilizimit, vetëm disa përkufizime negative nuk janë të mjaftueshme. Në një shoqëri me të vërtetë paqedashëse dhe të përparuar, njerëzit jo vetëm që nuk do t'i shkurtojnë të drejtat dhe interesat e të tjerëve, por edhe do të bashkëpunojnë në mënyrë të pakushtëzuar njëra palë me tjetrën dhe do të ndërtojnë aso

marrëdhëniesh të ndërsjella dhe institucione shoqërore, të cilat do të kontribuojnë për mirëqenien e të gjithëve dhe për formimin e një shoqërie ideale njerëzore. Në këtë aspekt neve na udhëzon edhe sheriat. Pra, këtu kemi për qëllim që shkurtimisht të paraqesim rregullat islamike, të cilat ndriçojnë këtë lloj të jetës dhe të shoqërisë.

Familja është qeliza e parë e njeriut. Aty formohen pikat themelore të karakterit të tij. Në atë mënyrë familja është element themelor i çdo civilizimi. Prandaj të shikojmë së pari urdhrat e shariatit për sa i përket familjes.

Familja përbëhet prej burrit, gruas dhe fëmijëve të tyre. Porositë e Islamit për familjen, janë mjaft të përcaktuara. Ato përcaktojnë përgjegjësinë e njeriut për atë që fiton, t'u ofrojë atë që është e nevojshme gruas dhe fëmijëve dhe t'i mbrojë prej të gjitha fatkeqësive jetësore. Obligimi i gruas është të udhëheq amvisërinë, të ushqejë dhe të edukojë fëmijët sa më mirë, t'i përgatisë burrit dhe fëmijëve komoditet dhe kënaqësi sa më të madhe. Obligimi i fëmijëve është t'i respektojnë prindërit, të jenë të dëgjueshëm, kurse kur të rriten të kujdesen për ta. Që ta bëjë familjen të disiplinuar mirë dhe institucion të suksesshëm, Islami përvetësoi dy masat e theksuara më poshtë:

a) Burri ka pranuar pozitën e udhëheqësit të familjes. Asnjë institucion nuk mund të funksionojë në mënyrë harmonike nëse nuk ka udhëheqësin e tij. Nuk do të mund të paramendonim shkollën pa drejtor ose qytetin pa kryetar këshilli. Nëse nuk ka askush të udhëheqë me institucionin, aty do të mbretërojë kaosi. Nëse çdo person i familjes punon sipas dëshirës së vet, aty shkaktohet tollovi. Nëse burri tërheq në një anë e gruaja në anën tjetër, ardhmëria e fëmijëve do të jetë e shkatërruar. Dikush duhet të jetë koka e familjes që të mund të mbahet disiplinë dhe

që familja të bëhet institucion ideal i shoqërisë. Islami ia jep këtë pozitë burrit dhe ashtu e bën familjen e disiplinuar mirë, qelizë themelore të civilizimit: model për shoqërinë në përgjithësi.

b) Kryetari i familjes, përveç kësaj është i ngarkuar edhe me përgjegjësi tjera të posaçme. Obligimi i tij është që të fitojë për jetë dhe të kujdeset për të gjitha detyrat, të cilat kryhen jashtë shtëpisë. Kjo e liron gruan prej të gjitha aktiviteteve të jashtme, të cilat bien në barrë të burit. Gruaja është e liruar prej detyrave jashtështëpiake, ashtu që të mundet plotësisht t'u kushtohet detyrave të brendshme dhe të përdorë tërë energjinë e saj në mirëmbajtjen e shtëpisë dhe të edukimit të fëmijëve - mbrojtësve të ardhshëm të vendit. Grave u këshillohet të mbeten në shtëpitë e veta dhe të plotësojnë përgjegjësitë, të cilat u janë të besuara. Islami nuk dëshiron t'i ngarkojë në mënyrë të dyfishtë; edukimi i fëmijëve dhe mirëmbajtja e shtëpisë dhe kujdesi për fitimin për jetë, duke punuar edhe punë jashtë shtëpisë. Kjo do të ishte padrejtësi e qartë. Prandaj Islami bën ndarjen funksionale ndërmjet dy gjinive.

Profesor Cyril Joadi thotë: "Besoj se toka do të ishte vend më i lumtur nëse gratë do të kënaqeshin të kujdesen për zjarrin (shtëpinë) dhe fëmijët e tyre, bile edhe nëse ajo do të kishte si pasojë rënien e lehtë të standardit jetësor." (Variety, 1 dhjetor 1952)

Por kjo nuk do të thotë që gruas nuk i është e lejuar që të mos dalë aspak prej shtëpie. Larg asaj. Asaj i është e lejuar të dalë kur ka nevojë. Ligji e ka precizuar që shtëpia është fusha speciale e punës së saj dhe ka theksuar se gratë duhet të kontribuojnë për përmirësimin e jetës shtëpiake. Dhe çdoherë kur do të duhet të dalin, ato e bëjnë atë sepse kryejnë formalitete të nevojshme.

Rrethi familjar zgjerohet nëpërmjet të gjakut dhe kurorës, që të forcojë bashkimin në mes anëtarëve të familjes, që të mbajë marrëdhëniet e ndërsjella të freskëta dhe të shëndosha, që çdo

anëtar ta bëjë burim të përmbajtjes, të fuqisë dhe të lumturisë së të tjerëve. Islami formuloi rregulla të posaçme themelore të bazuara në përvojën dhe urtinë e së kaluarës. Ato mund të paraqiten shkurtimisht siç është shënuar më poshtë:

a) Kurora është e ndaluar në mes personave, të cilët kanë lidhje të ngushta familjare sipas lindjes ose nëpërmjet të ndërmjetësimit. Kurora është e ndaluar në mes nënës dhe birit, njerkut dhe thjeshtrës, njerkës dhe thjeshtrit, vëllait dhe motrës, vëllait dhe motrës prej qumështit, mixhës me vajzën e vëllait, ose dajës me vajzën e motrës, tezes ose hallës me djalin e vëllait ose të motrës së saj, vjehrrës me dhëndrin e saj, vjehrrit me të renë. Kjo ndalesë i forcon lidhjet familjare dhe i bën marrëdhëniet në mes këtyre ndërmjetësve apsolutisht të pastra dhe ata mund të jetojnë ashtu së bashku pa përkufizim dhe me dashuri të sinqertë.

b) Nëse nuk ekzistojnë kurrfarë pengesash të lartpërmendura, atëherë mund të lidhet kurorë në mes të familjeve fisnore ashtu që kjo lidhje t'i afrojë edhe më shumë. Kurora në mes dy familjeve, të cilat sinqerisht janë të lidhura dhe, të cilat i njohin traditat, shprehitë e njëra-tjetrës, është e lumtur. Prandaj sheriatu jo vetëm që ka lejuar, por edhe ka nxitur dhe u ka dhënë përparësi lidhjeve me familjet fisnore në krahasim me familjet e panjohura, edhe pse edhe me ato nuk është e ndaluar.

c) Në grupin e familjeve fisnore rëndom janë së bashku edhe të varfër edhe të pasur. Sipas parimeve islame farefisi i njeriut ka përparësi më të madhe në te. Pranimi i kësaj lidhjeje në mes të të afërmve quhet teknikisht thika-i-rahm. Muslimanit i urdhërohet të respektojë këtë lidhje në të gjitha mënyrat e mundshme. Të qenurit jolojal ndaj anëtarëve të familjes tënde, të shkelish të drejtat e tyre është mëkat i madh dhe All-llahu xh.sh. nuk e lejon atë. Nëse një i afërm varfërohet

ose është në fatkeqësi, është obligim i të gjithë të afërmve të tij të pasur t'i ndihmojnë. Në zekat dhe bamirësitë tjera urdhërohet që t'i jepet rëndësi e posaçme të drejtave të farefisit.

ç) Ligji i trashëgimisë ashtu është i formuluar në Islam që pasuria e mbetur prej të vdekurit nuk mund të koncentrohet në një vend. Ajo duhet të ndahet ashtu që i tërë farefisi i afërt të marrë pjesën e vet. Djali, vajza, gruaja, burri, vëllai, motra janë farefis më i afërt dhe ata kanë përparësi absolute në trashëgimi. Nëse nuk ekziston asnjë prej tyre, pasuria i ndahet farefisit tjetër më të afërm. Pra, pas vdekjes së njeriut, pasuria e tij ndahet në mes të të afërmve të tij dhe ky sistem shmang çdo mundësi të koncentrimit kapitalist të pasurisë. Ky ligj islamik është i vetëm dhe popujt tjerë tash entuziazmohen me te. Por e trishtueshme është ironia, vetë muslimanët nuk janë të vetëdijshëm për mundësitë e tij revolucionare dhe prej paditurisë disa nuk e zbatojnë këtë në praktikë. Në disa pjesë të nënkontinentit indo-pakistanez, vajzat nuk kanë pjesën e tyre në trashëgimi. Kjo është padrejtësi e qartë dhe shtrembërim i tmerrshëm i urdhrave të qarta të Kur'anit.

Përveç familjes, njeriu ka marrëdhënie edhe me shokët e vet, fqinjët, banorët e rajonit të tij, të fshatit ose të qytetit dhe me personat me të cilët gjithmonë është në kontakt. Islami i pranon këto lidhje dhe urdhëron muslimanin që t'i kultivojë me respekt, t'u largohet shprehjeve nënçmuese dhe që nuk i kanë hije, të ndihmohen në mes veti, të vizitojnë të sëmurët, të ndihmojnë të varfërit, t'u shkojnë në ndihmë të dobtëve dhe të pamundshmëve, t'i ngushëllojnë ata që janë në fatkeqësi, të kujdesen për vejushat dhe bonjakët, t'i ushqejnë të uriturit, t'i veshin të zhveshurit dhe t'u ndihmojnë të papunësuarve që të punësohen. Islami thotë që mos ta shpenzoni pasurinë në luks të cilën ua ka dhënë All-llahu xh.sh.. Ai ka ndaluar përdorimin e enëve të arta dhe të argjendta, veshjet prej mëndafshit të shtrenjtë. Ai gjykon ata, të cilët shpenzojnë të hollat e veta në ndërmarrje aventureske ose në dëfrime të tepërta. Kjo porosi e sheriatit bazohet në parimin që

për kënaqësinë e tij personale askujt nuk i është lejuar të prishë pasurinë prej të cilës mund të jetojnë mijëra qenie njerëzore. Mizori dhe e padrejtë është që të hollat, të cilat mund të shrytëzohen për të ushqyerit e numrit të madh të të uriturve, të shpenzohen në dekorime të pavlefshme dhe të tepërta. Islami nuk lejon që njeriu të humb pasurinë e tij. Ajo, të cilën njeriu e ka fituar ose e ka trashëguar, pa dyshim është pronë e tij personale. Islami pranon të drejtën e tij dhe i lejon që ta përjetojë dhe sa më mirë ta shfrytëzojë.

Ai sugjeron po ashtu që nëse ju jeni të pasur, të mund të keni veshjet më të mira, banesë dhe jetë të lumtur. Por Islami dëshiron që në të gjitha aktivitetet e njeriut asnjëherë mos të harrohet elementi human. Ajo që Islami plotësisht e gjykon është egocentrizmi jo i natyrshëm, i cili lë pas dore mirëqenien e të tjerëve dhe krijon individualizëm të tepruar. Ai don që tërë shoqëria njerëzore të përparojë e jo vetëm disa individë. Ai dëshiron të mbjell në shpirtin e ithtarëve të tij vetëdijen shoqërore dhe të ndikojë në ta që duke u ikur ekstremiteve të jetojnë një jetë modeste dhe të vetëdijshme. Kur të kënaqin nevojat e tyre, Islami i këshillon besimtarët që të kenë parasysh nevojat dhe kërkesat e fafesisit të vet, të afërmve të largët, të shokëve, të fqinjve dhe bashkëqytetarëve të vet.

Deri më tash shqyrtoam natyrën e marrëdhënieve të njeriut me rrethin e tij më të ngushtë. Të shohim tash në perspektivë më të gjerë dhe të kuptojmë çfarë lloj shoqërie dëshiron të vendosë Islami. Ai i cili pranon Islamit jo vetëm që hyn nën krahët e fesë, por bëhet edhe anëtar i bashkësisë islame. Sheriati ka formuluar rregulla të posaçme të sjelljes edhe për një vëllazërim më të gjerë. Këto rregulla i obligojnë muslimanët të ndihmohen në mes veti, të urdhërojnë në të mirë dhe të ndalojnë të keqen dhe të kenë llogari që asnjë padrejtësi të mos futet në shoqërinë e tyre.

Ja disa urdhra islamike në këtë aspekt:

a) Që të ruhet jeta morale e popullit dhe zhvillimi i shëndoshë i shoqërisë, është e ndaluar përzierja e lirë e personave të të dy gjinive. Islami bën ndarje funksionale në mes punëve dhe u përcakton lëmi të ndryshme të aktivitetit. Gratë në përgjithësi duhet t'u përkushtohen nevojave shtëpiake, ndërsa burrat punëve të tyre në sferat shoqërore-ekonomike. Përveç ndalimit të kurorës në mes të farefisit të afërm, kërkohet prej burrave dhe grave që mos të përzihen lirisht e nëse janë të detyruara, këtë ta bëjnë me vello (peçe). Kur gratë duhet domosdo të dalin prej shtëpive, atëherë do të mbajnë veshje modeste dhe do të jenë të mbuluara ashtu si u ka hije. Ato do të konsiderojnë normale të mbuluarit e fytyrës dhe të duarve. Mund ta heqin mbulesën vetëm në rast të nevojës, e kur nevoja ndërpritet prapë duhet të mbulohen. Njëkohësisht u propozohet burrave t'i ulin shikimet e tyre dhe mos t'i shikojnë gratë. E nëse dikush rastësisht shikon ndonjë grua duhet që shikimin sa më shpejtë ta ulë. Të përpiqemi t'i shikojmë nuk është mirë, ndërsa të njoftohemi është edhe më keq. Obligim është edhe i burrave edhe i grave të kujdesen për moralin personal dhe të pastrojnë shpirtin e tyre prej çdo papastërtie. Kurora është forma e vetme e përshtatshme për marrëdhënie seksuale dhe askush nuk duhet të mundohet ta tejkalojë këtë kufi, ose të paramendojë për ndonjë leje seksuale; edhe vetë mendimi dhe persiatja e njeriut duhet të jenë të pastra prej këtyre planeve të prishura.

b) Për të njëjtin qëllin, besimtarit i urdhërohet të mbajë veshje modeste; asnjë burrë nuk duhet të zbulojë trupin e tij prej gjunjve deri në kërthizë, kurse gruaja asnjë pjesë të trupit të saj, përveç fytyrës dhe duarve, askujt përveç se burrit të vet, as edhe fisit më të afërm nuk ka të drejtë t'ia zbulojë. Termi teknik i kësaj është setr (mbulim) si dhe mbulimi i këtyre pjesëve të trupit është obligim fetar i çdo muslimani dhe muslimaneje. Me këtë urdhër Islami dëshiron të kultivojë

ndjenjë të thellë të ndershmërisë dhe të pastërtisë dhe të pengojë të gjitha format dhe të gjitha manifestimet e paturpshmërisë dhe prishjes morale.

c) Islami nuk i lejon ato dëfrime dhe zbavitje, të cilat i nxisin epshet seksuale dhe i prishin ligjet morale. Dëfrimet e tilla janë humbje e kohës, të hollave, energjisë dhe ato rrënojnë natyrën morale të shoqërisë. Dëfrimi, pa dyshim, është nevojë për vetvete. Ai vepron si instinkt për aktivitet dhe gjallëron shpirtin e jetës dhe vendosmërisë. Ai në jetë është i nevojshëm si uji dhe ajri; posaçërisht pas punës së rëndë njeriut i nevojiten pushimi dhe rekreimi. Por pushimi duhet të freskojë shpirtin e jo të deprimojë dhe të prishë epshet. Zbavitjet e pakuptimta ku mijëra persona prezantojnë në skenat e prishura të së keqes dhe amoralitetit, janë në kundërshtim thelbësor me dëfrimin e shëndoshë. Edhe pse ato janë të volitshme për shqisat, efekti i tyre në shpirtin dhe moralin e njerëzve është i tmerrshëm. Ato i prishin shprehitë e tyre dhe vlerat morale, prandaj nuk mund të kenë vend në shoqërinë dhe kulturën islame.

ç) Që të sigurohet bashkësia dhe solidariteti i popullit dhe që të arrihet mirëqenia e bashkësisë islame, besimtarëve u është urdhëruar t'i largohen armiqësisë në mes veti, grindjeve dhe ndarjeve të të gjitha llojeve. Atyre u këshillohet t'i zgjidhin dallimet dhe përleshjet e tyre në pajtim me parimet e Kur'anit dhe Sunnetit. E nëse nuk mund të gjejnë gjuhë të përbashkët, në vend që të rrihen dhe të hidhërohen në mes veti, ata do t'i harrojnë grindjet në emër të All-llahut dhe Atij do t'ia lëshojnë vendimin. Në sendet, të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien nacionale, ata do të ndihmohen reciprokisht dhe nuk do të shpenzojnë energjinë në përleshjet e imta. Armiqësitë e tilla janë fatkeqësi për bashkësinë islame, burim potencial i dobësimit nacional dhe me çdo çmim duhet t'u ikim.

d) Islami e çmon shkencën dhe diturinë si e mirë e përbashkët dhe e përgjithshme e tërë njerëzimit. Muslimanët kanë liri të plotë të mësojnë shkencën dhe përdorimin e saj praktik prej cilitdo burim. Por përse i përket kulturës dhe civilizimit u është e ndaluar të sillen në mënyrën e sjelljes së popujve tjerë. Psikologjia e imitimit sugjeron se ajo rrjedh prej ndjenjës së inferioritetit, e cila më vonë gjithsesi do të prodhojë mentalitet defetist. Imitimi i kulturës së një populli ka pasoja shumë të tmerrshme në një komb; e shkatërron vitalitetin e tij të brendshëm, e mjegullon shpirtin e tij, e dobëson aftësinë e tij kritike, krijon komplekse të inferioritetit dhe gradualisht, por sigurisht, i rrënon të gjitha burimet e kulturës dhe paralajmëron shkatërrimin e saj. Prandaj Pejgamberi i Zotit (a.s.) ndaloi rreptësisht përvetësimin e kulturës dhe mënyrën e jetesës së jomuslimanëve. Fuqia e një populli nuk është në veshjen, etikën ose artin e tij; forca dhe zhvillimi i tij është në diturinë e vërtetë, në shkencën, disiplinën, organizimin dhe energjinë për aksion. Nëse dëshironi të mësoni diçka prej të tjerëve merrni mësim prej vendosmërisë së tyre për aksion dhe disiplinë shoqërore, shfrytëzoni diturinë dhe arritjet e tyre teknike, por ruajuni prej ndikimit të artit, i cili më në fund ju shpie deri në skllavëri kulturore dhe inferioritet (nënshtrim) nacional.

MARRËDHËNIET ME JOMUSLIMANËT

Tani të shqyrtojmë marrëdhëniet e muslimanëve me jomuslimanët. Lidhur me këtë çështje besimtarëve u këshillohet të jenë tolerantë e jo shpirtngushtë, të mos i nënçmojnë ose të mos i kritikojnë udhëheqësit e tyre fetarë ose të shenjtët e tyre, të mos flasin asgjë të nënçmuar për fetë të tyre, të mos bëjnë grindje të padobishme me ta, por të jetojnë në paqe dhe miqësi të mirë. Nëse

jomuslimanët kanë sjellje të mirë dhe njerëzore ndaj muslimanëve dhe nuk i nënçmojnë kufijtë e tyre ose të drejtat e tyre, atëherë muslimanët janë të detyruar që me ta t'i ruajnë lidhjet miqësore dhe ndaj tyre të veprojnë drejtë. Njëri prej parimeve të fesë islame është që muslimanët duhet të posedojnë kuptim më të gjerë dhe sjellje më të mirë se të tjerët, si dhe të sillen fisnikërisht e në mënyrë modeste. Veprat e këqija, torturimi, agresioni dhe shpirtngushtësia janë kundër shpirtit islam. Muslimani ka ardhur në botë të bëhet simbol i gjallë i mirësisë, fisnikërisë dhe humanitetit. Ai do të duhej të fitojë zemrat e njerëzve me karakterin dhe shembullin e tij.

Vetëm atëherë ai do të jetë ambasador i vërtetë i Islamit.

TË DREJTAT E TË GJITHA KRIJESAVE

Tash erdhëm deri në kategorinë e fundit të drejtësisë. All-llahu xh.sh. i dha njeriut pushtet mbi krijesat e Tij të panumërta, të cilat janë të krijuara që t'i shrytëzojë ai. I është dhënë fuqi t'i nënshtrojë dhe t'i shfrytëzojë për nevojat dhe qëllimet e tij. Kjo pozitë më e lartë i jep njeriut pushtet mbi to dhe ai ka të drejtë të shërbehet me to si të dojë. Por kjo nuk do të thotë që All-llahu xh.sh. i ka dhënë liri totale. Islami thotë që çdo krijesë ka të drejta të posaçme te njeriu. Nuk guxon t'u bëjë të keqe pa ndonjë nevojë absolute. Kur i shfrytëzon për nevojat e tij do të përdorë metodat më të mira dhe më pak të dëmshme.

Ligji i Islamit jep urdhra të hollësishme për këto të drejta. P.sh. neve na është e lejueshme të therim kafshët për të ushqyerit tonë, por na është e ndaluar t'i vrasim thjesht për dëfrim ose për

sport, dhe t'i fshimë prej jete pa nevojë. Që t'i them, zebh (therja) është metoda më e mirë për fitimin e mishit prej kafshës. Metodat tjera janë më të dhembshme, ose e prishin mishin dhe ia marrin disa cilësi të posaçme. Islami u ik të dy rreziqeve të tilla dhe propozon metodën, e cila është më pak e dhembshme për kafshën e nga ana tjetër mishi i përmban të gjitha cilësitë. Po ashtu vrasja e ngadalshme e kafshës, duke i shkaktuar dhembje të gjatë dhe lëndime të padobishme, sipas Islamit konsiderohet neveritje. Islami lejon vrasjen e kafshëve të rrezikshme, të helmueshme dhe gjakpirëse, sepse Islami e vë jetën e njeriut mbi to. Por nuk lejon vrasjen e tyre në mënyra tjera më të dhembshme.

Për sa u përket kafshëve ngarkuese dhe shaluese, Islami kategorikisht ndalon njeriun t'i mbajë të uritura, t'u japë punë të rëndë dhe të padurueshme dhe t'i rrah pa dhembje. Të zënurit e shpezëve dhe mbyllja në kavaz, pa ndonjë shkak të posaçëm, konsiderohet punë e shëmtuar. Ç'të flasim për bimët? Islami nuk lejon as prerjen e padobishme të drunjtve. Njeriu mund të shfrytëzojë frytet e tyre dhe prodhimet tjera, por nuk ka të drejtë t'i shkatërrojë. Bimët, së fundi, posedojnë jetë, por Islami nuk lejon as prishjen e sendeve pa jetë, nuk e lejon bile as prishjen e ujit. Qëllimi i tij është t'i ikë humbjes në çdo formë dhe t'i propozohet njeriut që sa është e mundur më mirë t'i shfrytëzojë të gjitha burimet e të ardhurave - të gjalla ose të vdekura.

SHERIATI: LIGJI UNIVERSAL DHE I PËRHERSHËM

Në faqet e mëparshme dhamë një pasqyrë të shkurtër të ligjit islamik - ligjit, të cilin Pejgamberi Muhammed (a.s.) ia dha njeriut për të gjitha kohët e ardhshme. Ky ligj nuk lejon dallimin në mes njeriut dhe njeriut tjetër, përveç se në besim dhe devotshmëri. Sistemi fetar dhe shoqëror, ideologjitë kulturore dhe politike të cilat bëjnë dallim në mes njerëzve sipas racës së tyre, nacionalitetit, nuk do të mundën asnjëherë të kalojnë në provimin e së drejtës universale për një shkak të thjeshtë se nuk mund të ndërrohen raca ose nacionaliteti, sepse e tërë bota nuk mund të rregullohet që të formohet në një vend dhe se raca e zezë, e verdhë ose e bardhë nuk mund të ndryshohen. Ideologjitë e tilla dhe sistemet shoqërore të tilla patjetër janë të kufizuara në një racë, në një vend ose në një bashkësi dhe asnjëherë nuk mundën të bëhen universale. Përkundër, Islami është ideologji universale. Çdo person, i cili deklaron se beson në La ilahe il-lallah Muhammed-ur-Resulull-llah (nuk ka zot tjetër, përveç All-llahut dhe se Muhammedi është Pejgamber i Tij) hyn nën krahët e Islamit dhe gëzon të njëjtat të drejta si edhe muslimanët tjerë. Islami nuk bën kurrfarë diskriminimi në bazë të racës, ngjyrës ose gjuhës. Thirrja e tij i drejtohet tërë njerëzimit dhe nuk lejon kurrfarë ndarjeje.

Më në fund, ky ligj është i përhershëm. Ai nuk bazohet në zakonet ose traditat e ndonjë populli të posaçëm dhe nuk është dedikuar për një periudhë specifike të historisë njerëzore. Ai bazohet në parimet e njëjta natyrore sipas të cilave është i krijuar edhe vetë njeriu. Dhe si kjo natyrë mbetet e njëjtë në të gjitha periudhat dhe në të gjitha rrethanat, ligji i cili bazohet në parimet e tij të pastra, patjetër duhet të jetë i pandryshueshëm në çdo epokë dhe në të gjitha rrethanat. Ndërsa ai religjion universal dhe i përhershëm është ISLAMI.